DILAVER R. GOXHAJ



DRAMA E UÇK

DHE E

ADEM DEMAÇIT

Analizë e politikës në UÇK
Për periudhën 7 Mars 1998-2 Mars 1999

Tiranë, 2014

Autori: Dilaver Rezo Goxhaj

Titulli: DRAMA e UÇK dhe e ADEM DEMAÇIT

Përkujdesja grafike: Edlira Kame

Botues: EDLORA

ISBN:..... ©: Autori

E-mail: lavergoxhai@yahoo.com
Cel: +355 (0) 68 22 01 446

Sponsorizoi:
"**JON**" sh.p.k

٢٢٢٢٢٢٢٢٢

"Të ndërpriten proceset, duke e vënë veten në krye pa ndonjë meritë të veçantë, pasi të jenë bërë akuza të tilla të rënda dhe shkelje të çoroditura të bartësve të këtyre proceseve, e pastaj të vraposh nëpër Evropë dhe Amerikë me shpresë se ata, faktorët e jashtëm, do ta bëjnë kompletimin e procesve në Kosovë, nuk është vetëm bajraktarizëm (kjo do të ishte e keqja më e vogël), por manipulim me interesat më vitale të

Kosovës, nëse jo vetëm injorancë e thellë politike."

Ukshin Hoti

٢٢٢٢٢٢٢٢٢

"E vërteta ka hipur në krahët e kohës dhe shkon përpara pandërprerje; me pishtarin që ajo ka në dorë largon errësirën dhe i djeg budallenjtë që i dalin përpara për ta shuar".

Sami Frashëri

٢٢٢٢٢٢٢٢٢

P R O L O G

Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë[1)] u organizua posaçërisht për vendosjen e një paqeje të përkohëshme trevjeçare në Kosovë, sikundër u deklarua. Rreth kësaj ngjarjeje janë bërë shkrime të shumta, madje janë mbrojtur edhe grada shkencore e janë dhënë edhe tituj shkencorë. E përbashkëta e gjithë këtyre trajtesave dhe e punimeve shkencore, historike apo studime të veçanta rreth asaj konference, është vlerësimi në superlativa i vendimit të Drejtorisë Politike (Dr.P) të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që pranoi të shkonte dhe ta nënshkruante atë Marrëveshje, edhe pse ajo

---

[1)] Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë i zhvilloi punimet në dy faza: 6-23 Shkurt dhe 14-19 Mars 1999. Delegacioni kosovar: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Azem Syla, Xhavit Halit (UÇK); Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Edita Tahiri,, Bujar Bukoshi, Idriz Ajeti (LDK); Rexhep Qose, Hydajet Hyseni, Bajram Kosumi, Mehmet Hajrizi (LBD); si dhe të pavarurit Blerim Shala, Veton Surroi. Serbia kompozoi delegacionin e saj duke futur: 2 shqiptarë kolaboracionistë,1 boshnjak, 1 goran, 2 turq, 1 rom, 1 egjyptas dhe serbët: Ratko Markoviç, Vladimir Shtambuk, Nikola Shahinoviç, Vlladan Kutleshiq. Marrëveshja e Rambujesë, për vendosjen e një paqeje të përkohëshme në Kosovë, u nënshkrua vetëm nga pala kosovare. Si rjedhojë e mosnënshkrimit nga serbët, u hap drita jeshile për ndërhyrjen e NATO-s, e cila i filloi bombardimet ajrore në 24 Mars 1999 dhe zgjatën 78 ditë .

sanksiononte autonominë e Kosovës në kuadër të Serbisë, si dhe e shkrinte UÇK-në.

Në anën tjetër, direkt e indirekt, është anatemuar zoti Adem Demaçi, Përfaqësuesi Politik i UÇK-së, ngaqë u pozicionua kundër nënshkrimit pa kushte të asaj Marrëveshjeje, duke e akuzuar deri edhe për puçist!

Të tilla pozicionime të diskutueshme ndodhin ngaqë në shumicën e rasteve natyra jonë njerëzore është e prirur për të "ditur" atë që na pëlqen ta dimë sesa atë që nuk na pëlqen ta dimë. "*Njeriu nganjëherë*, – shkruan Ukshin Hoti – *edhe pse mund të gjendet në një situatë specifike, mund të dojë të bëjë një gjë normale, e cila pikërisht sepse është normale, në një situatë të tillë specifike mund të duket si e çuditshme.*" Kështu ndodhi edhe me pozicionimin e z. Adem Demaçi.

Ngaqë ai pozicionim i Demaçit u duk i çuditshëm, ndaj dhe pjesa dërmuese e opinionit publik e ka të vështirë të përcaktojë se nga cila palë anon më së shumti e vërteta, e cila është një proces që ndryshon, zhvillohet e përsoset mbi bazën e thellimit të njohjes së problemit përkatës dhe s'është kurrë e dhënë një herë e përgjithmonë.

Dihet gjithashtu se, e vërteta është një e vetme, por, ama, ka tri pamje: dy anësore dhe një në thellësi. Në rastin tonë, dy alternativat anësore të së vërtetës, për pranimin ose jo të kushteve për të shkuar në Rambuje, janë: a) vendimi i Drejtorisë Politike dhe b) sugjerimet e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së, Adem Demaçit. Prezantimi i dy alternativave (pamjeve) anësore të së vërtetës, mendojmë se ende nuk është bërë i plotë për opinionin tonë publik. Përmes paraqitjes së argumentave të të dy palëve, ne do përpiqemi të ndërtojmë një pamje të tretë të së vërtetës, atë në thellësi, e cila të mund të përfshijë edhe dy pamjet e tjera të të dy alternativave. Vetëm atëherë do të mund të themi se e vërteta është inkuadruar në mënyrë harmonike në rjedhën e natyrshme të saj të plotë.

Meqenëse veprimtaria e Drejtorisë Politike dhe ajo e Adem Demaçit,

që ne trajtojmë në këtë analizë, shtrihet në një hapësirë kohore prej 7 Marsit 1998-2 Mars 1999, ku çdo ngjarje përfshin një zgjatje në kohë dhe një shtrirje në hapësirë, kuptohet që, duke i renditur sipas radhës dhe mënyrës se si ka ndodhur secila prej tyre, do të mundohemi të analizojmë se si ato kanë ndikuar tek njëra-tjetra; e cila është një përçapje thelbësore që të afron më shumë drejt njohjes të së vërtetës.

Kanë kaluar tashmë më shumë se 15 vjet nga ajo kohë dhe plot gjëra kanë ndryshuar në Kosovë. Nëse sot i kthehemi vendimit që u muar për të shkuar në atë kohë në Rambuje, duke pranuar apo jo kushtet e panegociueshme të parashikuara në projekt-marrëveshjen e asaj konference ndërkombëtare, këtë e bëjmë për të gjykuar veten tonë, me të vetmin qëllim që, nga ato ngjarje historike të nxirren mësime për të tashmen e të ardhmen e Kosovës.

Ndaj dhe analizën do ta bazojmë në filtrin e ngjarjeve që lidhen me këtë eveniment në terren dhe në Konferencë, në shkrimet dhe dokumentat e botuara gjatë asaj kohe e më pas, (nga autorë vendas e të huaj), si dhe në rezultatin përfundimtar të saj.

Lexuesi, duke u njohur me ngjarjet që kanë ndodhur në UÇK gjatë asaj periudhe kohore njëvjeçare, si dhe me akuzat dhe kundërakuzat që i janë bërë secilës palë, le ta shohë të vërtetën sipas konceptimit të tij, duke bërë gjykatësin. Ky është edhe qëllimi final i kësaj përpjekjeje.

Kthimi i herë-pas-hershëm në këto ngjarje nga autorë të ndryshëm tregon se vendimet e Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe të Adem Demaçit kanë ende elementë të pasqaruar. Me këtë punim ne nuk pretendojmë se do të flitet në mënyrë shterruese për ngjarjen në fjalë. E vërteta përherë bën rrugë të gjatë.

HYRJE

Adem Demaçi, kjo figurë emblematike e desidencës dhe e politikës kosovare prej viteve ‘60 të shekullit të kaluar e në vijim, në javën e

dytë të Gushtit 1998 është takuar me dy nga drejtuesit e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Azem Sylën e Xhavit Halitin, në Tiranë, ku, - siç thotë ai -, "arrijnë ujdinë që ata të bëjnë luftën e ky politikën." Si rjedhojë, më 13 Gusht 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përmes komunikatës nr.7 të tij, e shpall publikisht Adem Demaçin Përfaqësues të Përgjithshëm Politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prishtinë[2)].

Me këtë veprim, ata që ishin në krye të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës legjitimuan para opinionit publik shqiptar dhe masës së luftëtarëve të UÇK-së, ekzistencën dhe përbërjen aktuale të Drejtorisë Politike të saj, (Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Azem Syla, në të cilën kooptohet edhe Adem Demaçi), si dhe të Shtabit të Përgjithshëm, (i cili përbëhej atë kohë nga këta të pestë plus Rexhep Selimi, Sokol Bashota, Lahi Ibrahimi)[3)]. Askush nuk dinte se çfarë tentativash ishin bërë deri atëherë prej antarëve të Drejtorisë Politike, që kishin mundur të delnin në këto funksione të larta drejtuese të UÇK-së, duke shmangur nga drejtimi i Luftës për Çlirimin e Kosovës dhe i UÇK-së dy lëvizjet politike, (Lëvizja Popullore për Kosovën, LPK; Lëvizja Kombëtare Çlirimtare për Kosovën, LKÇK), të angazhuara shumë më herët.

Vendimi i Drejtorisë Politike (Dr.P) për t'i propozuar Adem Demaçit detyrën e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së ka qenë një nga veprimet dhe vendimet e saj më të studjuara dhe më të zgjuara. Në periudhën kur thirret Adem Demaçi në ndihmë, UÇK-ja, përveç që kish pësuar disfatë të ndjeshme në aspektin e veprimtarisë së saj ushtarake në terren, ajo ishte edhe e izoluar politikisht nga i gjithë spektri politik mbarë shqiptar, ashtu edhe nga diplomacia ndërkombëtare. Deri në ato momente nuk kemi asnjë takim politik publikisht midis Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe politikanëve shqiptarë si dhe me diplomatët

---

[2)] Shkëlzën Gashi: "Adem Demaçi", biografi, Prishtinë 2010, f.144.

[3)] Shih Jakup Krasniqi "Kthesa e madhe", Prishtinë, 2006, f. 90

ndërkombëtarë. Dhe që UÇK-ja të delte nga ai izolim, Drejtoria Politike thirri në ndihmë Adem Demaçin, "*Bacën, legjendën e gjallë të popullit shqiptar... Figura e tij e rëndomtë në mënyrë gati të padiskutueshme kaloi në legjendë; u tret në shpirtin e gjallë të popullit dhe u mishërua në ëndërrën e tij shekullore; Demaçi dhe populli u bënë një. Nuk ishte më tutje vetëm një bir i denjë i popullit, por gati vetë populli*"[4], sikundër e përcakton Ukshin Hoti. Këtë e kish më se të qartë edhe Drejtoria Politike e UÇK-së, dhe, për të dalë nga situata ku ajo e kish futur UÇK-në, e kuptoi se "*për politikën tani e tutje ishte i rrezikshëm vetëdijësimi politik i popullit shqiptar. Dhe këtë Demaçi e artikuloi me inteligjencën e tij të mprehtë; me shpjegimet e thjeshta, por definitive dhe të prera; me referencat e tij-shpatë që coptonin, por që nuk therrnin*."[5] Emërimi i Demaçit në atë pozicion politik e përligjte tendencën historike për bashkim kombëtar shqiptar në një situatë të mëvonshme më të përshtatshme, pavarësisht se ai deklaroi se hiqte dorë nga *Ballkania* e tij.

Demaçi, duke e pranuar **ta kryente legalisht** detyrën e përfaqësuesit politik të UÇK-së, në qëndër të kryeqytetit të vendit ku kryhet ajo luftë, duke lëvizur e vepruar haptas përmes forcave ushtarako-policore të pushtuesit, përbën një rast unikal në historinë e luftrave çlirimtare botërore, e cila ishte edhe një sfidë e drejtpërdrejtë që ai i bënte Serbisë. Pranimi i kësaj detyre nga Demaçi, ishte një guxim i marrë, pasi përbënte për të një rezikshmëri të jashtëzakonshme.

Deklarimi publikisht nga Demaçi, si kryesues i asaj detyre politiko-ushtarake, e vuri Serbinë në dilemën për t'u përcaktuar në njërën prej tre alternativave: ta pranonte, duke e lënë të lirë Demaçin; ta arrestonte; apo ta injoronte (të heshtte). Dhe ajo zgjodhi të tretën, heshtjen, sepse po ta pranonte, do të detyrohej të ulej menjëherë në bisedime me të; po ta arrestonte do të shtoheshin radhët e UÇK-së

---

[4] Ukshin Hoti"Filozofia politike e çështjes shqiptare", Prishtinë, 1997, f. 175

[5] Po aty

me luftëtarë, mbështetës dhe simpatizantë. Por edhe heshtja pati pasoja të paparashikueshme prej Serbisë, sikundër ishte përpjekja për krijimin e Asamblesë Kombëtare, e cila do të eleminonte Kuvendin e Kosovës i dalë nga zgjedhjet e diskutueshme të Marsit 1998, nën monitorimin e vetë Serbisë, gjë që nuk i interesento asaj.
Megjithatë, mungesa e reagimit serb ndaj atij emërimi të Demaçit si Përfaqësues Politik legal i UÇK-së do të thoshte leje e nënkuptuar (implicite) për veprimtari legale të tij në tërë territorin e Kosovës si Komisar Politik i UÇK-së. Kjo ishte edhe arsyeja pse Demaçi nuk pati pengesa prej Serbisë për krijimin e Asamblesë Kombëtare, i cili, me shumë zgjuarsi ftoi të merrnin pjesë në atë Asamble edhe pakicat kombëtare në Kosovë, për të mos i dhënë shkak Serbisë që ta pengonte funksionimin e asaj asambleje. Politikisht, Serbia prej asaj dite që nuk reagoi ndaj asaj detyre legale të Demaçit, dashje pa dashje nuk mund ta mohonte ekzistencën e një ushtrie çlirimtare në Kosovë dhe, njëkohësishtë, indirekt pranonte se UÇK-ja nuk ishte organizatë terroriste. Dhe faktet e treguan një gjë të tillë më pas. Si rrjedhojë, pretendimet e mëvonshme serbe se UÇK-ja ishte terroriste, e shoqëruar gjithmonë me mjete të dhunës për ngulfatjen e saj, u provuan si absurde.
Me një fjalë, emërimi i Demaçit në krye të politikës së asaj lufte çlirimtare ishte një hap avancues shumë i madh nga ana e Drejtorisë Politike, që vështirë se mund të tejkalohej nga ana e Serbisë. Për këtë shkak, leja e nënkuptuar serbe, do të thoshte edhe luftë për legalizimin e mëtejshëm të punës së Demaçit në këtë drejtim përmes të qenit Komisar Politik legal i UÇK-së. Merita në këtë drejtim i takon Drejtorisë Politike, e cila gjeti njeriun më të spikatur, në momentin më të spikatur dhe të vetmin personalitet të mundshëm në Kosovë që mund të përfaqësonte denjësisht gjininë e vet shqiptare.
Sikundër shihet, Drejtoria Politike i kish bërë saktë këto llogari. Duke vënë në krye të politikës së luftës këtë legjëndë të gjallë të shndërruar në popull, jo vetëm që ajo do ta thyente izolimin politik dhe diplomatik të UÇK-së, por do të shumonte edhe rradhët e formacioneve të saj. Njëkohësishtë, me atë veprim të zgjuar,

Drejtoria Politike i bëri Serbisë edhe një karshillëk të befasishëm e të paparashikuar prej saj, pasi, veç të tjerave, e përgënjeshtronte propagandën e Serbisë dhe mbështetësve të saj, e cila e akuzonte UÇK-në si një organizatë terroriste, pavarësishtë se vihej në rrezik jeta e Demaçit, e këtij politikani modern, të cilin "*Komuniteti politik evropian me gjest fisnik, i pat ndarë çmimin Saharov*"[6], dhe kjo ngaqë Demaçi, duke qenë i lirë në veprimtarinë e tij politike, "*ai nuk e luftoi në veçanti asnjë armik, por që të gjithë së bashku. E luftoi dhe e mundi çdokë dhe secilin që deshi ta pengonte emancipimin e popullit shqiptar në Kosovë. Për këtë shkak figura dhe personaliteti i tij u mishërua me progresin*"; si dhe me marrshimin përpara të forcave dhe të luftës së UÇK-së, ngaqë "*Demaçi u shndërrua në popull. Për këtë shkak, madhështia e tij nuk qëndron në të njohurit e tij nga populli, por edhe në të njohurit e popullit në veten e tij*"[7]; por edhe në të njohurit e UÇK-së nga i gjithë populli në Kosovë, nga kombi shqiptar dhe nga ndërkombëtarët.

Mirëpo Drejtoria Politike nuk deshi ose nuk diti ta shfrytëzonte sa më gjatë këtë progres politik që i dha Adem Demaçi UÇK-së në arenën kombëtare e ndërkombëtare, pasi me t'u kthyer nga raundi i parë i bisedimeve në Rambuje, jo vetëm që anëtarët e saj nuk pranuan as të përshëndeteshin me të, por e përzunë edhe nga detyra e Komisarit Politik, që i patën besuar para gjashtë muajve!

Adem Demaçi e pranoi ofertën e SHP të UÇK-së për të qenë Përfaqësuesi i Përgjithshëm Politik i saj në Kosovë, duke hequr dorë nga drejtimi i Partisë Parlamentare dhe vizioni i tij vetjak për konfederatën *Ballkania*. Sikundër ka treguar koha, zoti Demaçi, vendimin për të pranuar ofertën e bërë nga dy drejtues të lartë politikë të UÇK-së, nuk e mori aspak për interes vetjak, por është nisur nga ideja e çlirimit të Kosovës, si hap i parë drejt bashkimit të saj me shtetin amë, ide për të cilën ai pat luftuar pareshtur gjat gjithë jetës së tij, në luftë me shtetin Jugosllav e më pas me Serbinë.

---

[6] Po aty, f. 175-176
[7] Po aty

Hapi i parë që bëri Adem Demaçi, porsa pranoi detyrën politike të afruar nga Shtabi i Përgjithshëm, i sugjeroi këtij organizmi të lartë drejtues që ta ndryshonin strategjinë ushtarake të UÇK-së, "*nga lufta për territore, ku pësoi disfatë, por jo edhe humbje përfundimtare, dhe të kalohej në metodën e luftës guerile*"[8]. Gjë që rriti besimin në radhët e UÇK-së si dhe në popull, duke u bindur se kishin të bënin jo vetëm me një politikan të sprovuar, por edhe me një takticien ushtarak të zotin. Ajo direktivë e tij tregonte kushtrim, kërkesë, dhimbje dhe shpresë. Ai e dha këtë direktivë strategjike ushtarake ngaqë ia jepte atë të drejtë pozicioni politik. Si rrjedhojë, nënkuptohej se prej atij momenti, vetëm ai kish të drejtë të përcaktonte politikën e luftës për çlirim, si Përfaqësuesi i Përgjithshëm Politik i UÇK-së, duke e bindur popullin se lufta ishte nisur për t'u fituar dhe jo për të bërë pazare me përpjekjet e luftëtarëve të dalë prej gjirit të tij. "*Qeveria që formulon politikën e luftës dhe që duhet t'ia përshtasë atë kushteve që ndryshojnë shpesh gjatë konfliktit,* –udhëzon teoricieni ushtarak Lidëll Hart – *mund të ndërhyjë me të drejtë në strategjinë e një fushate…. Kur qeveria gjykon se kundërshtari ka epërsi ushtarake në tërësi, ose në një teatër të vaçantë operacionesh, ajo mund të vendosë të përdorë një strategji me qëllim të kufizuar*."[9]

Sikundër do ta shohim në vijim, nëse Demaçi do ta kishte de fakto atë fuqi urdhëruese ndaj Drejtorisë Politike dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, për t'i detyruar formacionet e saj luftarake të zbatonin në terren strategjinë e luftës guerile (partizane), atëherë mund të thuhet me siguri se ai ishte udhëheqësi kryesor politik i asaj ushtrie çlirimtare; dhe, e themi me bindje se, nëse UÇK-ja do të vinte në jetë strategjinë ushtarake që propozonte Demaçi, do të ishin serbët ata që do të kërkonin haptas rrugë të tjera jashtë Kosovës, për të fituar në tryeza ndërkombëtare atë që do të humbisnin praktikisht çdo ditë në terrenin e luftës. Por, bazuar në ngjarjet që do të

---

[8] Gazeta "Rilindja", 18 Gusht 1998.
[9] Lidëll Hart "Strategjia", SHBU, Tiranë, 1997, f. 399-400

analizojmë, del se Demaçit nuk iu bindën ata që duhej të bindeshin për të vënë në jetë atë strategji ushtarake, që ai kërkoi të aplikohej!

KUNDËRSHTITË DHE PRANIMI I KONFERENCËS SË RAMBUJESË

Zoti Jakup Krasniqi, në një përpjekje që ai bën, për të argumentuar vendimin e marrë nga Drejtoria Politike e UÇK-së, për pranimin pa kushte të projekt-marrëveshjes dhe shkuarjen në Rambuje, (më pas vendim i pranuar edhe nga Shtabi i Përgjithshëm), edhe pse parashihej eleminimi i UÇK-së, madje edhe pse e pranon që UÇK-ja ishte në kulmin e arritjeve të saj ushtarako-politike dhe e aftë për ta çliruar Kosovën, çuditërisht, më në fund ai jep edhe një arsye jo bindëse, (sipas gjykimit tonë), për të justifikuar se pse u lanë mënjanë ato arritje dhe u vendos të shkohej në Paris! Ai thotë: "*Bashkësia Ndërkombëtare kishte njohuri të mjaftueshme se ofensivat e njëpasnjëshme të ushtrisë e policisë serbe të vitit 1998, jo vetëm që nuk e kishin zhdukur UÇK-në, por nga ato luftime ajo kish dalë më e fortë. Tani, UÇK-ja veç organizimit më të mirë, kishte me veti dhe përvojën njëvjeçare të luftës. Zgjatja e luftës, për bashkësinë ndërkombëtare do të thoshte zgjerim i luftës edhe jashtë kufijve të Kosovës…… Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte faktor më i fuqishëm luftarak sesa kur kishte hyrë në luftë.* ***Por, duke parë se lufta kishte hyrë në një fazë të re, të përmasave të gjera operative, duke parë sabotimin që iu bë luftës nga një pjesë e faktorit politik shqiptar, duke parë sabotimin që po i bënte luftës qeveria Bukoshi si dhe mbylljen e rrugëve furnizuese, pranuam të shkojë në Rambuje.***"[10], *(korsivi është i imi, D.G)*.

Kur lexojmë këtë paragraf të zotit Jakup, natyrshëm na lind pyetja: Cilët ishin atëherë ato "shkaqe" aq të forta, që i detyruan anëtarët e Drejtorisë Politike të UÇK-së, të cilët, edhe pse kishin bindjen se:

---

[10] Jakup Krasniqi "Kthesa e madhe", Prishtinë 2006, f.157-158

"*Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte faktor më i fuqishëm luftarak sesa kur kishte hyrë në luftë"* dhe madje, në momentin *"kur ajo kishte hyrë në një fazë të përmasave të gjera operative",* të merrnin atë vendim të kontravers?! Përgjigjia është e thjeshtë: Procesi i riorganizimit të strategjisë së luftës, që këshillonte Demaçi, nuk i kishte lejuar ata ta kuptonin të vërtetën; ata nuk e ndjenin se mendimet i kishin sipërfaqësore, të pathelluara dhe as që mund t'i thellonin. Për këtë shkak, ata ishin të prirur t'i besonin tepër shumë argumentit të autoritetit të postit që mbanin dhe jo autoritetit të argumentave që shtronte Përfaqësuesi Politik UÇK-së.

Për këtë arsye ata harronin që populli nuk i kish të tepërt bijtë e vet. Populli shqiptar i Kosovës kishte një mal me arsye për të mos besuar që serbët e Millosheviçit do të lëshonin terren, do t'i jepnin popullit të Kosovës lirinë në një pjatë të argjentë pas bisedimeve në një tryezë të thirrur nga faktori ndërkombëtar. Kjo kontraditë e shprehur nga zoti Krasniqi, në gjykimin tonë tregon se ata, anëtarët e Drejtorisë Politike të UÇK-së, nuk flisnin e as flasin edhe sot politikisht. Mos vallë ngaqë nuk dinin, e mbase nuk dijnë as sot, të manovrojnë politikisht me ndershmëri? Ndoshta, pasi politika është shkollë ose përvojë. Anëtarëve të Drejtorisë Politike u mungonin të dyja. E kundërta ndodhte me Adem Demaçin: ai kishte edhe shkollën, edhe përvojën politike të luftës së tij 38 vjeçare, për ta parë Kosovën të lirë e të pavarur.

Demaçi, duke e kuptuar qëllimin e vërtetë pse thirrej me aq urgjencë konferenca ndërkombëtare, (kuptohet, për të mos u realizuar mbledhja e Asamblea Kombëtare e Kosovës), ai i bëri publike arsyet e mospranimit të 10 pikave denigruese për palën shqiptare të asaj projekt-marrëveshje. Me këtë veprim të Demaçit, faktori ndërkombëtar ishte i detyruar ta shtynte datën e konferencës ndërkombëtare, nëse do të bazohemi në praktikat diplomatike. Mirëpo nga ky detyrim, ndërkombëtarët i çliroi vendimi i Drejtorisë Politike, i shpallur befasisht nga Jakup Krasniqi.

Drejtoria Politike nuk duhej ta merrte atë vendim pa u ulur në bisedime me Demaçin, me Shtabin e Përgjithshëm dhe me kryetarët e partive që ishin dakorduar për Asamblenë Kombëtare, ku të

diskutonin për temat që ngjallnin shqetësime kapitale, sikundër ishte anullimi i Asamblesë Qytetare, e caktuar të realizohej brenda datës 10 Shkurt 1999, me pjesëmarrjen e të gjitha forcave politike dhe të pakicave kombëtare në Kosovë. Ai konsultim bëhej edhe më i domosdoshëm për faktin që Drejtoria Politike asnjëherë nuk kishte thënë deri në ato momente se mbledhja e Asamblesë ishte një zgjidhje e pamundur, dhe se UÇK-ja nuk kish më mundësi të vijonte luftën për shkak të *"sabotimit që po i bënte luftës qeveria Bukoshi si dhe mbylljes së rrugëve furnizuese"*. Por, pranimi i 10 kushteve të panegociueshme nga ana e Dr.P dhe SHP, me këtë lloj justifikimi që na jep z.Jakup, do të thoshte se ata pranonin idenë se UÇK-ja ishte mundur, gjë që nuk ishte aspak e vërtetë.

Pastaj, këto "shkaqe" janë thënë publikisht pasi mbaroi lufta! Pse z.Jakup u jep fjalëve të veta dy kuptime? "*Ai që u jep dy kuptime fjalëve të veta do që t'i mashtrojë njerëzit*."[11)], thotë Volteri. Prandaj Demaçi kërkonte që Dr.P dhe SHP të uleshin për të diskutuar me atë dhe me forcat politike në Kosovë, që kishin pranuar idenë e Asamblesë Qytetare. Ulja në diskutim e tyre, kuptohet që do të kërkonte kohë gjersa të arrihej në një konsesus për të dhënë përgjigjen për shkuarjen apo jo në Rambuje. Mirëpo kjo do të bënte të mundur që të shpejtohej mbledhjen e Asamblesë para datës 10 Shkurt, duke e vënë faktorin ndërkombëtar para një fakti të kryer. Si rrjedhojë, faktori ndërkombëtar do të ishte i detyruar jo vetën të shtynte afatin e konferencës ndërkombëtare, por do të siguronte edhe zhvillimin e Asamblesë në Prishtin dhe do të pranonte edhe vendimet që do të merreshin në atë Asamble. Më tej, pranimi ose jo i projekt-marrëveshjes do të varej nga vendimet që do të merrte Asamblea dhe jo me një telefonim të thjeshtë nga zotërinjtë H. Thaçi, Xh. Haliti, K. Veseli dhe A. Syla nga Tirana, dhe i shpallur nga zoti Jakup Krasniqi. Çfarëdo vendimi, për të cilin do të merreshin vesh, duhej të ishte rezultat i kompromisit dhe i lëshimeve reciproke brenda

---

[11)] Volteri "Letrat filozofike", Prishtinë, 1986, f.124

faktorit politik shqiptar dhe UÇK-së, kompromis, i cili nuk do të mund të arrihej në rast se, në radhë të parë, nuk do të kishte mirëkuptim midis Demaçit dhe Drejtorisë Politike e SHP.
Duke iu referuar ngjarjeve të asaj kohe, konstatojmë se ndër gjithë politikanët kosovarë vetëm Demaçi këmbëngulte për një diskutim të tillë mes UÇK-së dhe gjithë faktorit politik shqiptar, gjë që e lartëson shumë si politikan. Dhe, ajo që e dallon edhe më shumë nga të tjerët, këto mendime të tij nuk rridhnin nga ndonjë interes personal, por ngaqë kërkonte që të mos shkelej mbi gjakun dhe sakrificat e bëra gjatë një vit lufte. Përderisa Demaçit nuk iu mundësua konsultimi me Drejtorinë Politike, nuk kish se si të diskutonte ai me forcat e tjera politike për çështjen e Asamblesë Kombëtare (Qytetare), për arsyen e thjeshtë se ai nuk e kish atë të drejtë që të mblidhte apo ta anullonte vetë atë Asamble. Ai vendim i papritur i Dr.P dhe i SHP, i shpallur më 3 Shkurt 1999, përveç që anullonte marrëveshjen për bashkëveprim me gjithë faktorin politik shqiptar në Kosovë, përmes Asmablesë, binte ndesh edhe me komunikatën nr.71 të vetë Dr.P, lëshuar më 26 Janar 1999, ku theksohej: bazuar në kërkesat e komandave të zonave operative, si dhe në kërkesat që shtron koha, është marrë qëndrim që deri në 10 Shkurt 1999, të mblidhet Asamblja Qytetare[12)]. Kështu që Demaçin e nxuar në pozicion mat, duke e shmangur nga detyra kryesore që i patën besuar.
Natyrshëm na lind pyetja: Çfarë e detyroi Dr.P të anullonte arritjen më të madhe politike të popullit shqiptar në Kosovë, si kurrë ndonjëherë në historinë e tij, Asamblenë Kombëtare, e cila ishte në pragun e saj? Dhe përgjigjia më e drejtë mendojmë se do të ishte: Antarët e Drejtorisë Politike, duke bindur veten se po bënin shkëlqyeshëm udhëheqjen e një ushtrie çlirimtare në luftë për çlirimin e Kosovës, të cilëve luftëtarët e saj u besonin me fanatizëm të verbër, nuk po e kuptonin se me atë vendim kishin startuar shtrembër. Kjo vlen edhe për kryesitë e forcave politike legale të

[12)] Arkivi RKL, vëll.1, f. 122

Prishtinës bashkë me "intelektualët e pavarur", që e pranuan pa asnjë kusht projekt-marrëveshjen e Rambujesë, duke bërë anullimin e Asamblesë. Duke e përkrahur një praktikë përfundimisht amorale, ngaqë po i binin me top kompromisit historik për bashkim kombëtar, të gjithë ata ranë në provimin e etikës më elementare demokratike, gjë që i pengoi të shihnin lidhjen e saj me politikën; të gjithë ata ranë në ato pozita sepse e kishin bindur veten, se Adem Demaçi si individ nuk mund të loste ndonjë rol të madh në ecurinë e proceseve politike të luftës. Dhe kjo ngaqë i kishin hutuar emërtimet e funksioneve të larta që mbanin në UÇK dhe në partitë e tyre, pasi që tashmë e kishin harruar mënyrën e arritjes në ato funksione. Si rrjedhojë, ata dhe të "pavarurit" luftën që bënte populli shqiptar në Kosovë e barazonin me interest e veta të veçanta, të nxitur nga instikti i marrjes së pushtetit. "*Politikën e komandojnë interesat (kombëtare) dhe jo emocionet. Atë e udhëheq arsyeja dhe jo instikti… politika është raport midis revolucionit dhe institucionit*"[13], na mëson Ukshin Hoti. Dhe, duke e vënë interesin grupor mbi atë kombëtar, Drejtoria Politike, kryesuesit e forcave politike dhe të "pavarurit" eleminuan rastin më ideal për bashkimin gjithëpërfshirës shqiptar në Kosovë. Dhe këtë akt të tyre jo vetëm që e prezantonin si veprim të madh "patriotik", por fatkeqësisht edhe e besonin dhe e besojnë si të tillë. Gjë që edhe sot e gjithë ditën shprehen në atë mënyrë. Kjo tregon se ata e kishin përvetësuar mirë qasjen cinike dhe jo atë idealiste ndaj luftës çlirimtare, duke harruar se pikërisht prezantimi në popull si idealistë i kishte avancuar në ato pozicione politike dhe ushtarake. Politikën e kishin reduktuar në një mjeshtëri për pazarllëqe dhe nuk e ndjenin se fjala ishte për interesa themelore të një populli të tërë.
Kurse Demaçi e shihte të paarsyeshme shkuarjen me aq urgjencë në Rambuje, mbi të gjitha, ngaqë nuk po zbatoheshin as rregullat më elementare të një marrëveshjeje. Një marrëveshje quhet e ndershme

---

[13] Ukshin Hoti "Filozofia plitike e çështej shqiptare", Prishtinë, 1997, f. 161-162

në rastin kur përfitojnë të gjitha palët pjesmarrëse në të. Marrëveshjet ndërmjet palësh nuk mund të diktohen nga njëra palë; ato duhet të bëhen në bazë të parimit të barazisë dhe të aspiratës së përbashkët për paqe. Hapi i parë për hartimin e një marrëveshjeje midis dy a më shumë palësh është që fillimisht të bëhen të ditura pikëpamjet e të gjitha palëve që janë të interesuara; pastaj shihen se cilat janë divergjencat ndërmjet gjithë atyre palëve; dhe më tej, se si ato mund të pajtohen. Pastaj kalohet në hartimin e marrëveshjes. Në rastin tonë konkret, projekt-marrëveshja, që do të nënshkruhej në Rambuje, qe hartuar pa ia marrë mendimin aspak palës shqiptare në Kosovë; duke e vënë këtë para faktit të kryer, duke i thënë: "Merreni këtë tekst marrëveshjeje dhe shkoni në Rambuje, e atje nënshkruajeni, pa patur të drejtë që të negocioni!". Mbi të gjitha në asnjë rresht të asaj projekt-marrëveshjeje nuk tregohej se çfarë përfitonte Kosova prej saj. Pikërisht ato pika, për të cilat pala shqiptare në Kosovë nuk kishte të drejtë të negocionte, ato kundërshtonte Adem Demaçi, sepse ato e kthenin Kosovën në autonominë e vitit 1974, në kornizën e të drejtave të garantuara nga një kushtetutë të cilës tashmë nuk i kishte mbetur as nami e as nishani, sepse ish-Jugosllavia ishte shpërbërë dhe vetëm Serbia e Mali i Zi e përbënin atë tashmë. Përveç asaj, me atë projekt-marrëveshje eleminohej edhe UÇK-ja!

Me termat që përdorëm më lart, duket sikur ky është një përfundim disfatist. Por realiteti i tillë ishte.

Palës kosovare (shqiptare) nuk iu kërkua që të jepte qoftë edhe një mendim të thjeshtë për përmbajtjen e asaj marrëveshjeje që do të nënshkruante, por iu tha: Merreni dhe nënshkruajeni! Ky lloj trajtimi, përveç që ishte mospërfillje, ishte një fyerje e rendë, pasi ishte shprehje e qartë e mosnjohjes së luftës së armatosur të deriatëhershme dhe i mos respektimit të gjakut të derdhur nga shqiptarët për çlirimin e Kosovës!

Prandaj Adem Demaçi shtronte pyetjen: Çfarë fiton UÇK-ja dhe Kosova nga kjo marrëveshje?

Përgjigjia që Demaçi i jepte vetë asaj pyetje ishte: Asgjë!, veçse

shkrihej UÇK-ja dhe "*neve na afrohet një autonomi më e keqe sesa që e kemi pasur në vitin '74*"[14]. Për këto arsye Demaçi as që mund të pranonte nisjen në Rambuje dhe nënshkrimin e marrëveshjes me sy mbyllur, pasi "*Luftrat guerile bëhen për të pasur të fituar e të humbur e jo për kompromis*"[15], siç thotë me të drejtë Henri Kissinger.

Demaçi, ndryshe nga Rugova, ishte përfaqësues i "*Real politikës*"; ai ishte i bindur se nuk kish pse të falte në tavolinën e bisedimeve ato që mund të fitoheshin me pushkë e me gjak në fushën e betejës. Drejtësia morale e Demaçit nuk e pranonte (lejonte) diplomacinë elastike.

Zotërinjtë Kristofer Hill (ndërmjetësi kryesor i Grupit të Kontaktit për Kosovën), i ndihmuar nga Wolfgang Petriç (ambasadori i Austrisë në Beograd) dhe diplomatët e tjerë, duke e parë këmbënguljen dhe vendosmërinë e Demaçit për mospranimin e 10 kushteve poshtëruese për Kosovën dhe UÇK-në, në themel të gjithë u pajtuan në një pike: Të ndalohej forcimi i mëtejshëm i UÇK-së dhe të shpëtohej Rugova. Dhe kjo mund të arrihej me dy mënyra: para së gjithash të sabotohej mbledhja e Asamblesë Qytetare dhe, e dyta, të shkëputej Drejtoria Politike nga Adem Demaçi, duke i joshur antarët e saj me sigurinë e marrjes së pushtetit. Mirëpo, diplomacia publike që zbatonte Demaçi ndikonte mbi opinionin publik në Kosovë më shumë se mediat, duke formuar një imazh edhe më pozitiv për Demaçin, gjë që po e kthente në favor të tij shumicën e komunitetit shqiptar. Për këtë arsye diplomatët vendosën të shmangnin Demaçin dhe të lidheshin direkt me "*majën përgjegjëse politike të UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja*"[16]. Kjo donte të thoshte ta "vrisnin" Demaçin me një lloj arme të shenjtë, kundër së cilës hakmarrja e tij ishte e pafuqishme, të cilën e pohon vetë zoti Demaçi, kur thotë: "*Dhe, kur Petriç dhe të tjerët e kanë kuptuar se ne në zyrën*

---

[14] Shkëlzen Gashi: "Marrëveshja për paqe të përkohëshme", Prishtinë 2004, f. 23

[15] Henri Kissinger "Diplomacia", Tiranë, 1999, f. 684

[16] Blerim Shala "Vitet e Kosovës", f. 165

tonë nuk heqim dorë nga pavarësia e Kosovës, atëherë ata janë drejtuar dhe kanë shkuar në mal vetë dhe kanë ardhë e kanë bërë hajgare me ne në zyrë, e na kanë thënë: a po ju vjen keq juve që ne po shkojmë në mal?! Unë vet me vete kam thënë: me këtë shkuarjen tuaj në mal, ju na e kajtët nanën, se me këtë po prishet marrëveshja që unë kam bërë në Tiranë me ata që janë në mal, ku u patëm marrë vesh që unë të bëja politikën e ata luftën"[17)].

Çdo lloj ushtrie, e rregullt apo çlirimtare qoftë, është e varfër kur nuk ka në krye të saj intelektualë të mirëfilltë, vizionarë, të cilët duhet të shohin më tej se një arritje çfarëdo, sepse lufta nuk është as një betejë e vetme e as një çast, por një shumë betejash e ngjarjesh drejt një pikësynimi final – që, kur është në përputhje me vullnetin e popullit, të cilin e përfaqësojnë këta intelektualë, përbën një kurorë lavdie për ta.
Për fat të keq, duke mos qenë përgjithësisht të tillë, anëtarët e Drejtorisë Politike ndaj dhe morën atë vendim ku, përveç se anulluan rastin më ideal për bashkim gjithëpërfshirës në Kosovë, (së bashku me forcat e tjera politike legale dhe të "pavarurit"), i kthyen krahët politikanit të mirënjohur e me reputacion kombëtar e ndërkombëtar, që vetë e kishin ftuar t'i përfaqësonte deri në ato momente historike që po kalonte Kosova; njëkohësisht ata treguan se nuk kishin vizionin e duhur për të gjetur Nordin politik në ngjarjet që po zhvilloheshin si në terren ashtu edhe jashtë Kosovës. E pakta që mund të thuhet në këtë rast për ta është se u treguan naivë politikë.
Pas analizës që u bëmë këtyre zhvillimeve, jemi të detyruar të shtrojmë pyetjen: si është e mundur që të tillë persona, duke qenë se paten pranuar detyra politike me kaq përgjegjësi të madhe kombëtare, të arrijnë dhe të shmangin me kaq lehtësi e arrogancë shansin më fatlum të bashkimit kombëtar të shqiptarëve në Kosovë dhe simbolin shqiptar të rezistencës? Cila është ajo forcë apo organ

---

[17)] Shkëlzen Gashi: "Marrëveshja për paqen e përkohëshme", f. 18

politik që i zgjodhi ata në krye të Drejtorisë Politike e të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, për të bërë "politikë kaq të madhe"?

"*Më duket se ishte 7 Mars 1998, unë kam qenë në Shqipëri*". – e fillon tregimin e tij, zoti Ali Ahmeti, antari i Sektorit të Rëndësisë së Veçantë i zgjedhur nga Këshilli Përgjithshëm i LPK -. "*E gjithë kryesia e organizatës ishte në Tiranë. Selinë e kishim në Lidhjen e Shkrimtarëve... Erdhi Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi dhe u bë një debat i ashpër në Lidhjen e Shkrimtarëve, një orë debat i nxehtë ka qenë. Unë kam shkuar me vonesë, sepse isha me Bekim Berishën. Në fund ndarja ka qenë jo e pëlqyeshme nga Hashimi e Kadriu me Muhamet Kelmendin, (nënkryetar i LPK)… Kur ata hynë në Kosovë, dolën me një komunikatë se atje është Shtabi i Përgjithshëm, etj… U krijua një situatë jo normale*."[18)]

Këtë dëshmi na e plotëson më tej vetë nënkryetari i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm i LPK, Muhamet Kelmendi: "*Në Shoqatën e Shkrimtarëve të Shqipërisë, ku ishim duke mbajtur mbledhjen e Kryesisë, u futën Azem Syla, Xhavit Haliti, Hashim Thaçi me Kadri Veselin, si përfaqësues të Shtabit Qëndror të UÇK-së. Ne, këta (*Hashimin dhe Kadriun, D.G*), i njihnim si ndërlidhës midis LPK-së dhe UÇK-së, ndërsa tani na dalin si antarë të atij organi, i cili kurrë nuk ishte ndërtuar. Dhe për më tepër vinin për të thënë se UÇK-ja e ka bazën e vet politike, prandaj asaj nuk i duhet asnjë organizim tjetër, aq më pak Fronti*"[19)].

Plotësisht pas tre muajve këtë shmangie të LPK-së dhe të çdo force politike nga udhëheqja e luftës për çlirimin e Kosovës dhe të UÇK-së e konfirmoi publikisht z.Jakup Krasniqi përmes TVSH, në cilësinë e antarit të Dr.P dhe të zëdhënësit të SHP të UÇK-së, duke thënë: *"UÇK-ja nuk ka nevojë për të qenë nën kontrollin e çdo force politike, pasi ajo e di vetë se çka bën"*[20)]. Përmes kësaj deklarate anullohej

---

[18)] Bedri Islami: "I vërteti", Tetovë 2011, f. 181-182

[19)] Muhamet Kelmendi: "Pse nuk u ndërtua Fronti për çlirimin e Kosovës", "Iliria",Tiranë 1999, 87-88

[20)] Gazeta "Rilindja", 6 dhe 11 Korrik 1998

njëkohësishtë në mënyrë të njëanshme edhe marrëveshja e SHP të UÇK me Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), e nënshkruar në fillim të muajit Maj 1998, për të cilën do të flasim në vijim.

Më tej Muhamet Kelmendi na tregon edhe periudhën e fillimit të dramës për UÇK-në: "*Deri në Janar 1997 uniteti në kuadër të Degës për ndërtimin e UÇK-së ishte i padiskutueshëm. Si pasojë e vrasjeve dhe burgosjeve që ndodhën në Janar 1997, UÇK-ja mbeti pa udhëheqje ushtarake të vetën. Tash nuk kishte më Shtab Qëndror: ca u vranë, ca u burgosën dhe ca ikën jashtë vendit. Tërë udhëheqja kaloi në kuadër të Kryesisë së KP të LPK, Dega jashtë vendit. Me këtë filluan të duken edhe fërkimet e para, sepse dy antarë të sektorit (Xhavit Haliti dhe Azem Syla) kishin krijuar lidhje me disa forca brenda vendit (Kosovës), të cilat pretendonin të delnin në udhëheqje, edhe pse në asnjë sferë nuk kishin aftësi profesionale, as njohuri dhe nuk zotëronin as artin e luftës dhe të ushtrisë. Këta të dy, së bashku me disa brenda vendit, krijuan klanin që bëri grusht politik*"[21)].

"*Shtabi i Përgjithshëm ka qenë më shumë enigmatik, më shumë sekret, me përbërje jo aq shumë profesionale*", dëshmon komandanti i zonës së tretë operative e UÇK-së, Ramush Haradinaj, dhe vijon: "*E konsideroj periudhë krize se asnjë komandant zone nuk ishte anëtar i SHP të UÇK-së. Edhe kur mblidhej shtabi, aty mblidheshin Drejtoria Politike, zëdhënësit, shërbimet dhe ata diskutonin e merrnin vendime. Pse mendoj se ka qenë përbërje enigmatike? Sepse ne, komandantët e zonave, nuk i dinim përgjegjësitë e këtyre personave që mblidheshin në Shtab të Përgjithshëm. Kishte persona që deri dje figuronin dikund si emër dhe në momentin e caktuar bëhej zevendës komandant i ushtrisë, zëdhënës, përfaqësues për atje, përfaqësues për këtu, etj.*"[22)]

Por, cilat ishin kushtet që u shfrytëzuan për t'u shfaqur ajo dramë? "*E*

[21)] Muhamet Kelmendi: Po aty, f. 28

[22)] Bardh Hamzaj "Rrëfimi për luftën dhe lirinë", Prishtinë, 1999, f. 70

*meta themelore e tyre, (*e LPK-së, D.G*), do të thoja, ishte se për disa vite, nuk bënë të mundur që Këshilli i Përgjithshëm të konstituohej brenda në Kosovë, si organi më i lartë udhëheqës i Organizatës. Kur ata menduan se ishte koha për ta bërë, ishte tepër vonë, tashmë ishin të tjerë që i bënin regullat e lojës*"[23)], na e sqaron vetë Kryetari i LPK, prej 23 Majit 1998, zoti Bedri Islami.

Duke qenë se LPK-ja kish rënë në ato pozita dhe këta persona, që përbënin Drejtorinë Politike dhe SHP e shfrytëzuan atë pozitë të saj ngaqë kishin një bindje dhe mendësi të tillë, nuk kishin pse të konsultoheshin më me LPK-në, (jo dhe jo edhe me LKÇK-në), as minimalisht me zotin Demaçi. Besojmë se më vonë duhet ta kenë çmuar se me qëndrimin e tyre kanë nënshkruar një herë e përgjithmonë "vdekjen" e UÇK-së, një akt ky me pasoja seroize për të ardhmen politike të Kosovës.

Që të ishte sa më i ngushtë grupi i njerëzve që do të merrnin pushtetin të nesërmen e luftës, filloi lufta brenda tyre, të cilën na e bëjnë të qartë dy antarët e asaj Drejtorie Politike, të cilët janë edhe autorët që bënë marrëveshjen me zotin Adem Demaçi. Ja si na e tregon vetë z.Xhavit Haliti, në një mbledhje të kryesisë së LPK-së: "*Largimi i Abazit (Ali Ahmetit) nga Sektori i veçantë është kërkuar nga Shtabi Qëndror brenda vendit (*Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, D.G*), për shkak të gabimeve që i kanë konsideruar ata si gabime, për shkak se nuk ka respektuar vendimet dhe kërkesat e tyre*". Të njëjtën gjë na e pohon edhe zoti Azem Syla, po në atë mbledhje: "*Qëndrimi për largimin e Abazit është marë nga brenda".* Ndërsa zoti Bedri Islami e vijon shpjegimin edhe ai në po atë mbledhje: *"Le ta lëmë për një herë tjetër faktin se cilët nga "brenda" kishin të drejtë të ndëshkonin dikë që kërkonte të fuste grupin e Fehmi Lladrovcit në luftë në Kosovë, pas thirrjes së Adem Jasharit në Prill 1996… Grupi për të cilin flitet, nuk ishte një grup anarkist, por aty bënin pjesë disa*

[23)] Bedri Islami: "I vërteti", Tetovë 2011, f. 380

nga ajka e trimave të Kosovës"[24]).

Se cilët ishin këta personat nga "brenda", na e bën të qartë zoti Ali Ahmeti: "*Hashimi fliste në emër të shokëve nga brenda, por jo në emër të një institucioni*"[25])

Arsyen se pse këmbëngulnin personat "*nga brenda*" që të largohej Ali Ahmeti nga "Sektori i veçantë" e shpjegon zoti Ibrahim Kelmendi, antar i Kryesisë së LPK dhe një prej themeluesve të saj: "*Hashim Thaçi pat shpifur se gjoja Aliu ka qenë neglizhent… Hashimi nuk e pat ngritur akuzën në emër të asnjë institucioni, e pat ngritur në mbledhjen ku ishte vetëm mysafir (i ftuar)… Ajo akuzë u ngrit si tentativë për të bërë komplot kundër LPK-së dhe UÇK-së, mundësisht edhe puç. Ali Ahmeti ishte anëtar i Sektorit të Rëndësisë së Veçantë, i bërthamës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, i formuar nga Kryesia e LPK-së… Akuzat qenë ngritur sepse pothuajse vetëm Aliu i kishte lidhjet me zonat e UÇK-së në Kosovë e Maqedoni dhe prandaj duhej të sajoheshin akuza të paqëndrueshme, fiktive, që një grup njerëzish të fusnin nën kontrollin e tyre strukturat e LPK-së dhe të UÇK-së*"[26]).

Duke qenë se për të dalë në krye të udhëheqjes së luftës u ndoq kjo praktikë, ndaj dhe "*UÇK-ja nuk kishte as vijë të vetën politike, ndonjë subjekt politik që ta mbronte politikisht apo që të përcaktonte vijën dhe të paraqeste kërkesat politike para atyre ushtarake, ndërsa që ishte organizuar një "bërthamë alla-Hashimçe", e cila as që e dinte situatën aktuale*."[27]), pohon nënkryetari i LPK-së, M. Kelmendi.

Por se si do të quhej ky grup që po konturohej si udhëheqja e ardhëshme e UÇK-së, këtë na e bën të qartë antari i Këshillit të Përgjithshëm i LPK-së, Sadri Ramabaja, i cili thotë: "*Duke e parë mungesën e përfaqësimit politik të shkallës që kërkonte koha, në njërën prej mbledhjeve të Shtabit Mobilizues, pata propozuar që*

---

[24]) Bedri Islami: Po aty, f. 219-220
[25]) Po aty, f. 176
[26]) Shih Bedri Islami, "I vërteti", f.301-302
[27]) Muhamet Kelmendi, Po aty, f. 86

Shtabi i UÇK-së ose do të duhej që ta prananonte publikisht LPK-në si krah politik, ose këtë punë t`ia ngarkonte Lëvizjes për Bashkim Demokratik në Kosovë. Nëse nuk e bënte as njërën e as tjetrën, atëherë le ta themelojë një Drejtori Politike dhe ta bëjë publik emrin e drejtorit dhe të përfaqësuesve të saj jashtë. Ndërkaq anëtarët e Shtabit kishim shprehur gatishmërinë për të hyrë në Kosovë dhe për t`u vënë në shërbim të UÇK-së. Këtë ide e kishte përvetësuar shpejt përfaqësuesi i LPK-së në këtë mbledhje të Shtabit, Ramadan Avdiu, dhe e kishte përcjellë tutje tek klani i tij. Natyrisht as atëherë e as sot, nuk kam diçka kundër pse u përvetësua ideja. Përkundrazi, jam ndjerë i nderuar. Por, duke lexuar librin "Lëvizja - Lindja e përgjakur"... disi u ndjeva keq, meqë kisha ndjesinë që përmes kësaj ideje, mund të kem kontribuar në shmangien e Kryesisë së LPK-së si organi më i lartë politik dhe marrjen nën kontroll të plotë të UÇK-së nga katërshja e famshme (*Azem Syla, Xhavit Haliti, Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi), për të cilën Ibrahim Kelmendi flet gjerësisht në këtë libër"*[28)].

Sikundër shihet, si nga përgjigja kontradiktore (e dykuptimshme) e sipërcituar e zotit Jakup Krasniqi, ashtu edhe nga dëshmitë e zotërinjve Bedri Islami, Muhamet Kelmendi, Ali Ahmeti, Ibrahim Kelmendi, Xhavit Haliti, Azem Syla e Sadri Ramabaja, (të gjithë me funksione të larta në udhëheqjen politike të LPK-së, e cila punoi 17 vjet për përgatitjen dhe shpërthimin e asaj lufte çlirimtare, si dhe krijimin e furnizimin e UÇK-së me kuadro, luftëtarë dhe mjete), ata që morën vendimin për të shkuar në Rambuje dhe që përbënin edhe delegacionin e UÇK-së në atë Konferencë, ishin po ata që përbënin "*Shtabin Qëndror brenda vendit",* Drejtorinë Politike si dhe pjesën kryesore të Shtabit të Përgjithshëm të asaj ushtrie. Të vetemëruar në ato dy struktura drejtuese politiko-ushtarake të UÇK-së, ata u bënë përfaqësues të saj në Rambuje dhe shkuan atje duke pyetur vetëm njëri-tjetrin dhe duke e marrë vetë atë vendim dhe përgjegjësi.

[28)] www. pashtriku. org, 15.04.2012

Ky veprim i këtyre personave të dalë në krye të UÇK-së bëri të mundur marrjen nën kontroll të saj, struktura ushtarake e krijuar dhe e financuar nga LPK-ja, duke e shmangur përfundimisht këtë të fundit, e cila, nëse do të vijonte të ishte në krye të UÇK-së gjatë procesit të Rambujesë, (siç dihet, deri atëherë e pa kompromentuar), mund të supozohet që do të pranonte të bënte negociata, por me të tjera kushte e, për pasojë, edhe me të tjerë rezultate. E themi këtë duke patur parasysh përbërjen e udhëheqjes së saj, përvojën e tyre dhe parimin e kolegjalitetit në të cilin ata bazoheshin për marrjen e çdo vendimi.

Pas këtyre zhvillimeve duket qartë se prej atëherë UÇK-ja kontrollohej nga një grup i vetmuar. Mirëpo, lufta e vetmuar është e pashpresë, sado që të kesh me vete qoftë edhe një çetë të tërë me njerëz të aftë e besnikë, pasi nuk ke mundësi ta tërheqësh të gjithë popullin me vete. Përveç kësaj, ai grup nuk ishte i strukturuar siç duhej politikisht, prandaj edhe nuk kishte se si të përdorte metodat politike luajale për të marrë drejtimin e luftës dhe të organizmave të saj, veçse me metoda jo demokratike. Duke qenë se UÇK-ja udhëhiqej politikishtë vetëm nga një grup i vetmuar, të cilët me vetëdije e shmangën Asamblenë Qytetare, natyrishtë që ajo do të përfundonte në vetvrasje. Kjo është arsyeja kryesore, e cila bëri të mundur që UÇK-ja të bëhej "*kurbani*" i Marrëveshjes së Rambujesë, pavarësishtë se ai grup, të cilët ishin edhe delegatët e UÇK-së gjatë atyre bisedimeve, pamë se atje bënë përpjekje për ta shpëtuar atë. Por ishte vonë; atëherë e kish marrë me kohë “ferra uratën” dhe ato përpjekje i ngjanin më shumë një spektakli.
Lufta çlirimtare, që të jetë e tillë, duhet të ketë gjithmonë një bazë të gjerë shoqërore. Kjo e bën atë të domosdoshme për të bashkuar shumicën e popullit në luftë. Dhe për ta udhëhequr atë luftë nuk mund të ishin më të vendosur dhe më të aftë një grup prej 5-6 personash sesa dy lëvizjet politike, LPK-ja dhe LKÇK-ja, pasi ky grup njerëzish, edhe sikur të ishin gjeni në vetëvete as që mund të njihte mirë mentalitetin e gjithë masave në Kosovë. Kur ata e kuptuan këtë gjë, thirrën në ndihmë Adem Demaçin ngaqë ishte bërë sinonimi i

popullit, të cilit, mes të tjerave, i vunë për detyrë të organizonte Asamblenë Qytetare (Kombëtare), nga e cila do të delte Qeveria e Koalicionit, organi që do të bënte udhëheqjen politike të asaj lufte. Por…, sikundër e pamë më lartë, edhe ajo u sabotua më pas.

Me këtë rast po hedhim edhe një mendim, sipas të cilit, supozojmë që ndërkombëtarët e kanë inicuar më herët këtë mënjanim të LPK-së, (por edhe të LKÇK-së dhe më pas Asamblenë Kombëtare), nga udhëheqja e luftës dhe UÇK-së, me qëllim që qysh të nesërmen e një konference të tillë, si ajo e Rambujesë, ata të mos e njihnin e të mos përballeshin me një apo më shumë struktura të organizuara politike. Ndoshta. Dhe ja përse e hedhim këtë mendim: Duke njohur aspiratën e shumicës së shqiptarëve në Kosovë, ku valonte ideja që me shpërberjen e ish-Jugosllavisë mund të arrihej bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, (një ëndërr e vjetër kjo dhe e pashuar asnjëherë prej Lidhjes së Prizërenit), s'kemi arsye të besojmë që nuk janë ndikuar edhe nga ky qendrim. Por, duke qenë se ka shumë shqiptarë edhe në Mal të Zi e në Maqedoni, një bashkim i Kosovës me Shqipërinë, për Bashkimin Europian do të quhej destabilizim i rajonit, jo ngaqë detyrimisht i jepej faktorit shqiptar në Ballkan një rol përcaktues në zhvillimet e tij, por nga druajtja që vendet e këtij rajoni ishin dhe janë ende në raporte kontradiktore, e në disa raste edhe armiqësore, mes veti.

Ndërkohë, faktori ndërkombëtar europian, - gjithnjë e nënvizojmë për efekt të analizës, - nuk mund të merret si një i vetëm, unik, sikur të gjithë fuqitë që e përbëjnë atë kishin të njëjtin mendim për një zgjidhje afatgjatë të së ardhmes së Kosovës. Obsione të ndryshme, me sa dimë deri në 13 sosh, janë hedhur nëpër tryeza, në shtyp e forume të ndryshme për këtë problem, shumica e të cilave, siç kanë rezultuar nga koha, më së shumti kanë patur për qëllim të ngatërrojnë se sa të zgjidhin drejt e përfundimisht çështjen e së ardhshmes së Kosovës, deri në pavarësinë e saj të plotë.

Ndoshta mjaft qëndrime të panjohura, sa politike aq dhe diplomatike, sa të ndikuar nga faktorë ekonomikë e sa të tjera si pasojë e lidhjeve historike të disa prej këtyre vendeve me ish-Jugosllavinë, kanë

përcaktuar jo pak edhe të ardhshmen e Kosovës, sipas vizionit që shpalosi Rambujeja. "*Evropa ishte e ndarë. Franca historikisht ishte në favor të Serbisë. Madje Franca edhe pse ishte zgjedhur si vendi për bisedime për paqen, në vend që gjatë konferencës të qendronte asnjëanëse, u tregua shumë aktive në mbështetje të Serbisë, gjë që bie ndesh me parimet e doplomacisë për të tilla raste. Britania e John Majorit nguronte dhe po ashtu favorizonte Serbinë në disa aspekte*"[29], theksonte një prej analisëvet anglezë, i cili e ndiqte nga afër çështejn e Kosovës. Prandaj "*Shqiptarët ishin të alarmuar nga lëshimet që Rambujeja po i bënte Millosheviçit, se trupat e NATO-s do të quheshin si një forcë antiterroriste; ato ngjanin se do të përmirësonin misionin e serbëve.*"[30], theksojnë publicistët anglezë James Pettifer dhe Miranda Vickers.

Diçka më konkretisht për këtë temë mund të gjendet në një fakt që u bë i njohur nga shtypi amerikan ditët e fundit të muajit Prill 2014, sipas të cilit, Karl Bild, ish kryeministër i Suedisë gjatë asaj kohe dhe më pas Ministër i Jashtëm i saj, jo pak i angazhuar në zhvillimet në Kosovë, njihej mirë për qëndrimet e tij proserbe.

Duke u kthyer më konkretisht në temën tonë, themi që udhëheqja politike e një lufte çlirimtare është mendja e saj, dhe pa mendje nuk ke ku vete, bëhesh copë e thërrime. Por udhëheqja politike e një lufte nuk mund të përbëhet kurrë nga pesë-gjashtë veta, por nga një armatë e tërë njerëzish dhe strukturash. Ndaj dhe Demaçi këmbëngulte që të mblidhte Asamblenë Qytetare.

Luftrat çlirimtare e kanë si objektiv strategjik marrjen e pushtetit, por kjo gjë bëhet përmes armëve, duke delegjitimuar pushtetin e pushtuesit hap pas hapi, dhe në të njëjtën kohë, duke krijuar strukturat e reja të pushtetit të ardhshëm. Por, pa një forcë të organizuar politike, në krye të ushtrisë çlirimtare, nuk mund të

---

[29] Shih Henry H.Perrit Jr.,Pristine,2008,f.190).

[30] James Pettifer&Miranda Vickers:"Çështja shqiptare",Tiranë-New York,2007, f.333

krijohen strukturat e pushtetit të ardhshëm. Jeta nuk zhvillohet sipas disa recetave të gatshme, por fjala është që me eleminimin e LPK-së si strukturë politike, u eleminua mundësia e krijimit të pushtetit të ardhshëm, pasi, sikundër thamë, një grup i vetmuar politik i pastrukturuar e madje si i improvizuar, nuk mundet të krijojë një strukturë pushteti të tillë në të gjithë territorin e vendit. Mos krijimi i këtij pushteti paralel u shfrytëzua mjeshtërisht nga ndërkombëtarët menjëherë pasi mbaroi lufta, ndaj dhe Qeveria e Përkohëshme nuk funksionoi sikundër e lypte nevoja.

Besohet që drejtuesit e Dr.P kur e panë se nuk e kishin këtë mundësi, thirrën Adem Demaçin, i cili, si politikan i mirëfilltë që është, menjëherë kërkoi të thirrte një Asamble Kombëtare (Qytetare) për këto qëllime.

Siç del nga dokumentet e kohës, gabimi i tyre thellohet edhe më shumë për faktin se këta delegatë të pakët në numur nuk u konsultuan as edhe me LKÇK-në, me të cilën kishin një marrëveshje për krijimin e Frontit Politik të Luftës[31)], që do të hartonte rrugët dhe format e bërjes së politikës së saj.

Mbi analizën e këtyre zhvillimeve në prag e në vazhdim të Konferencës së Rambujesë, mund të shprehemi se nëse për marrjen e vendimit për shkuarjen apo jo në Rambuje dhe përzgjedhjen e delegatëve nuk do të ishte shmangur Asamblea Qytetare nga udhëheqja politike e luftës, (ose më herët LPK-ja dhe LKÇK-ja), këtë gjë do ta kishin bërë forumet e këtyre formacioneve politike dhe, midis të tjerëve, në përbërje të asaj liste do të ishin jo vetëm kryetarët e LPK-së, LKÇK-së dhe kryetari i Qeverisë të dalë nga Asambleja, por edhe ndonjë aktivist i shkathët politik i LPK-së apo LKÇK-së në Perëndimin, që mund të njihej me shumë personalitete të larta politike e shtetërore të vendeve të BE-së.

Edhe një vogëlsirë tjetër ka vlerë të nënvizohet: nëse ndodhte ajo përzgjedhje do të ishte shmangur fakti që 60 % e delegatëve të UÇK-

---

[31)] Shukri Klinaku: "Vendimi fatal", Çlirimi, Prishtinë, 2000, f. 82

së në atë Konferencë të ishin nga i njëjti lokalitet i Kosovës, që sot mund të shihet si shfaqja e parë e krahinorizmit në përcaktimin e të ardhmes së shtetit të ri, qëndrim ky që i bie ndesh standarteve demokratike që përcaktohen sot në Kushtetutën e Kosovës.

Kush e propozoi Konferencën e Rambujesë dhe kur?

Përgjigjen e kësaj pyetje na e jep vetë ambasadori amerikan i asaj periudhe në Shkup, dhe i ngarkuari nga Departamenti i Shtetit për bisedimet me përfaqësuesin politik të UÇK-së, zoti Kristofer Hill: "*Francezët ishin tejet të interesuar që të ishin nikoqirë të takimit dhe ne, në anën tjetër, nuk ishim aspak të interesuar. Organizimi i bisedimeve paqësore kurrë nuk ka qenë inisiativë e SHBA-ve*"[32]. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, pasi historikisht dihet se çfarëdo plani që mund të ketë dëshirë ta propozoi Rusia, duhet së pari të shqyrtohet nga Franca dhe Anglia, -*shkruan ish ministri i jashtëm i Anglisë Eduard Grey*-, dhe, në rast se ata pajtohen, atëherë u paraqitet nga këto të tria Fuqive të tjera[33].

Dhe kjo nismë franceze u nxit ngaqë ngjarjet e Dhetorit 1998 dhe të fillim-Janarit 1999 në Kosovë ishin të tilla, që ia rritën shumë prestigjin UÇK-së e në mënyrë të veçantë Adem Demaçit, i cili po shkonte drejt bashkimit të të gjithë faktorit politik në Kosovë. Prandaj, duhej bërë diçka urgjente që t'i ulej rejtingu Adem Demaçit, duke mos e lënë të arrinte atë objektiv, i cili do të bëhej i mundur përmes Asamblesë Qytetare, pasi ishin bindur se Demaçi ishte i aftë të vinte në lëvizje shtresa të gjera të shoqërisë. Dhe për këtë zgjodhën metodën e përdorimit të mjeteve të zakonshme: Realizimin e Konferencës së Rambujesë para se të mblidhej Asamblea Qytetare e Kosovës.

Mirëpo, francezëve u duhej edhe mbështetja e amerikanëve. Prandaj ata qysh herët kishin marrë masa që të bënin për vete Anglinë, një

---

[32] Blerim Shala, "Lufta diplomatike për Kosovën", Zëri, Prishtinë 2003, f. 98

[33] "Dokumentet Britanike për Çështjen Shqiptare 1912-1913", Tiranë, 2012, f. 80, marrë nga dorëshkrimet e Eduard Grey-it, vëll. 14.

nga shtetet partnerë të përhershëm të SHBA. Për këtë qëllim diplomacia franceze pat afruar Veton Surroin, të katapultuarin e Anglisë prej studios së BBC në Londër drejt e në Prishtinë, me ndihmën e së cilës arriti të prezantohej si intelektuali më me zë në Prishtinë dhe poligloti më i preferuar nga diplomatët e huaj. Paralel me këtë, Franca afroi edhe Austrinë, përmes ambasadorit Petriç.

Dhe qëllimit iu arrit. G-8, porsa u njoh me atë projekt-marrëveshje e paraqiti planin me një shpëjtësi marramendëse, si kurrë më parë, duke e rrethuar të ardhmen e Kosovës me një aureolë, në sajë të së cilës edhe përbërja e delegacionit të Kosovës u duk me të vërtetë si thelbi i vullnetit të mirë dhe i arsyes së shëndoshë. Të gjithë argumentat e asaj projekt–marrëveshjeje kishin një logjikë aq të thellë, saqë dukej sikur po të mos i pranoje, do të bëje një gjë të paarsyeshme.

Lind pyetja: Përderisa amerikanët edhe pse "nuk ishin aspak të interesuar për organizimin e bisedimeve paqësore" në ato monente, atëherë përsëri e pranuan atë propozim frances?

Kosova, në ato momente ishte një pikë gjeografike sa e rrezikshme aq dhe e lakmueshme, jo vetëm prej rusëve e sllavët në tërësi, por edhe prej amerikanëve, pse jo edhe për vendet e fuqishme islamike, por sidomos prej gjermanve, të cilët ishin i vetmi shtet që e kish ndihmuar dhe po e ndihmonte materialisht UÇK-në, duke i siguruar gjithë mjetet e nevojshme të komunikimit modern (ndërlidhjen) të papërgjueshëm, por edhe shpenzimet që bëheshin me ato mjete, ku vetëm këto të fundit arrinin në 1 (një) milionë e 200 mijë marka gjermane[34]. Amerika e kuptoi se po të vonohej do ta merrnin atë çështje në dorë ose gjermanët ose rusët, ndaj ajo ishte e detyruar të kapej me thonj. Megjithatë, nëse amerikanët do të formulonin rezervat e tyre në ato momente, për atë konferencë, atëherë do të ishte një prishje e asnjëanësisë dhe një ndërhyrje në të drejtat e

---

[34] Bedri Islami "Lëvizja-lindje e përgjakur", Tetovë 2012, f. 445-446 dhe 478-480

palëve. Vetëm kur të bisedohej për kushtet e paqes, atëherë Amerika do të formulonte kërkesat e saj. Kjo duhet të jetë arsyeja që amerikanët pranuan të ishin dakort për pavarësinë e Kosovës, por jo për bashkimin e saj me Shqipërinë, sikundër ishte programi politik i UÇK-së. Ndërsa mosbashkimi i Kosovës me Shqipërinë është një program politik e diplomatik ndërkombëtar i caktuar.

Demaçi ishte i vetmi që e kuptoi se në ato momente çështja e Kosovës kishte rëndësi jo vetëm për amerikanët dhe Ballkanin, por për të gjitha fuqitë e tjera europiane. Ndaj dhe ai ato ditë Janari 1999, pas shkëmbimit të robërve midis UÇK-së dhe Ushtrisë Serbe, (e cila u shoqërua me masakrën e Reçakut), mori urgjentisht rrugën drejt Tiranës, duke e vlerësuar si momentin më deçiziv që të mund të hynte në lojë Tirana, me qëllim që diskutimi të bëhej midis përfaqësuesve të Shqipërisë dhe Serbisë. Ky hap diplomatik i Demaçit kërkonte t'i thoshte diplomacisë botërore se Kosova është Shqipëri dhe, si e tillë, vetëm asaj i takon të bisedojë për bijën e saj. Dhe, nëse nuk pranohej ky kusht, Shqipëria të ishte pa tjetër e pranishme në bisedime. Mirëpo faktet treguan se Tirana nuk i kishte ato lloj mendësi, aftësi dhe ato këllqe. Si rrjedhojë, Demaçi u kthye nga Tirana ashtu si Skëndërbeu 532 vite më herët nga Papa Pali II i Vatikanit, në Janarin e vitit 1467. Një koinçidencë interesante: të dy shkuan për të kërkuar ndihmë në të njëjtin muaj e në të njëjtën moshë gjashtëdhjetëvjeçare tek të vetmit ku kishin shpresë se do të ndihmoheshin dhe, çuditërishtë, të dy u kthyen po njësoj, të zhgënjyer!

Kur e pa se ky varjant ishte i pamundur për Tiranën, atëherë Adem Demaçi kërkoi që problemi i Kosovës të shtrohej me ndërkombëtarët më vete, i shkëputur nga çështja serbe, pasi vetëm kështu kishte të ngjarë që çështja e bashkimit me Shqipërinë mund të zgjidhej përfundimisht. Ai e bëri këtë propozim ngaqë zgjidhja që jepte projekt-marrëveshja e Rambujesë ishte një zgjidhje që i imponohej Kosovës, duke e lënë në dorën e politikanëve kosovarë të joshur për pushtet, përderisa ata i pranuan ato kushte.

Edhe në këtë pikë dështuan bisedimet e Demaçit me diplomatët amerikanë dhe kjo për shkak të mosmirëkuptimit midis tyre. Por Demaçi përsëri nuk dekurajohet. Ai, duke shfrytëzuar faktin që UÇK-ja ***"ishte faktor më i fuqishëm luftarak sesa kur kishte hyrë në luftë",*** e që kulmoi me shkëmbimin e robërve midis asaj dhe ushtrisë serbe, si dhe i entusiazmuar edhe në ecurinë për realizimin e Asamblesë Qytetare, e ndjente veten më të sigurtë, ndaj dhe po bënte të pamundurën që të shtyhej në kohë ajo konferencë ndërkombëtare dhe nuk bëri të kundërtën: të afronte mbledhjen e Asamblesë Qytetare dhe të mos e linte atë për në afatin e fundit, në 10 Shkurt. Duke qenë se Demaçi nuk e kish atë forcë që të shtynte Mbledhjen e Rambujesë, ai nuk duhej të harxhonte kohë duke shkuar në Tiranë, pasi e njihte politikën e saj, por të shkonte në SHP dhe tek Rexhep Qose, dhe më pas tek forcat e tjera politike në Prishtinë, për të realizuar sa më shpejtë mbledhjen e Asamblesë Qytetare.

Edhe në këtë pikë francezët u treguan më të shkathët se Demaçi. Ishin ata që kishin menduar që t'ia hiqnin Demaçit mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm, pasi vetëm në këtë mënyrë realizohej plotësishtë ideja e sabotimit të Asamblesë Qytetare. Dhe kjo u bë e mundur prej tyre, duke bërë për vete zëdhënësin e atij shtabi, Jakup Krasniqin. Nëse shkëputej Jakup Krasniqi nga Demaçi, shkëputej edhe Shtabi i Përgjithshëm, pasi Jakupi ishte figura më autoritare e UÇK-së, si për UÇK-në edhe për Demaçin. Nëse nuk shkëputej Jakupi nga Demaçi, realizohej Asamblea Qytetare.

Bazuar në ecurinë e ngjarjeve, kuptohet se kjo detyrë duhet t'u jetë ngarkuar z.z.Hashim Thaçit, Xhavit Halitit dhe Kadri Veselit, të cilët ato ditë ndodheshin në Tiranë[35)]. Bindja e Jakupit nga Hashimi dhe kthesa prej 180 gradësh e Jakupit, lidhur me Asamblenë Qytetare, duhet të jetë rrjedhojë e ndonjë premtimi tepër tundues, duke shfrytëzuar paqartësinë e programit politik të UÇK-së, të cilin nuk pati kohë ta korigjonte as Adem Demaçi. Mirëpo edhe Jakupit i duhej një

[35)] Pr.Dr Paskal Milo "Ditari i një ministri të jashtëm", Tiranë, 2009, f. 180

"arsye" e fortë për ta bërë atë kthesë që të mund të ishte i besueshëm për masën e UÇK-së dhe për publikun. Dhe ajo u gjet: Anullojmë Asamblenë, pasi "*me potencialin dhe organizimin e tashëm ushtarak, UÇK-ja nuk mundet të ngadhënjei në luftë*"[36], sikundër i janë shprehur z.Jakup e z.Ramë Buja në Rambue z.Blerim Shala. Jo më kot ekziston parimi: Nëse lufton, duhet të kesh besim në fitore; në të kundërt…, kapitullon shpejt.

Lind pyetja tjetër:

Pse nuk i pranuan amerikanët kërkesat e Demaçit?

Së pari, ngaqë amerikanët kishin dhe kanë opsione krejt të ndryshme për çështjen e Kosovës. Amerikanët janë për statukuonë e tashme të pozitës së shqiptarëve në Ballkan, sepse interesi dhe nevoja e tyre është që në këtë pjesë të Evropës të kenë një popullsi që të ushqejë ndjenja sa më të larta miqësore ndaj SHBA; për një popullsi që të mos bjerë as nën ndikimmin rus (sllav), as nën ndikimin grek, as atë Italian apo turk, as frances dhe sidomos as nën atë gjerman. Dhe rasti më i mirë për ta realizuar këtë qëllim ishte duke angazhuar NATO-n në luftë kundër Serbisë, por jo të thellohej më tej, me vetvendosjen e shqiptarëve. Largimin e Serbisë nga Kosova, propaganda pan-shqiptare ia njeh për faleminderit vetëm SHBA. Kështu që i gjithë kombi shqiptar në Ballkan, edhe pse i ndarë në 6 shtete, kanë të njëjtën ndjenjë: pro amerikan, në lërtësinë më të madhe, si asnjë popull tjetër në Evropë. Nëse qëndrojmë kështu, të ndarë në 6 shtete, ndjenja pro-amerikane do të vijë gjithnjë duke u forcuar. Në të kundërt, po qe se lejohet vetvendosja dhe bashkimi i trojeve shqiptare në një shtet të vetëm, atëherë për amerikanët nuk është më e sigurtë që të jetë e përjetshme ndjenja e fuqishme proamerikane e shtetit të fuqishëm shqiptar të ardhshëm, pasi ai do të ishte i aftë t'i përballoi vetë fqinjët edhe sikur ata të veprojnë së bashku. Kështu që, bashkimi i gjithë shqiptarëve në Ballkan në një shtet të vetëm do të thotë rënie graduale e ndjenjës së fuqishme pro-

---

[36] B. Shala "Vitet e Kosovës", f. 281

amerikane edhe tek shqiptarët. Kjo është edhe njëra nga arsyet pse amerikanët pranuan që të çarmatosej UÇK-ja dhe po përpiqen të zgjasi pa mbarim konsolidimi i pavarësisë së Kosovës. Kjo është edhe arsyeja kryesore që i vetmi popull që është çarmatosur e çarmatoset në Ballkan janë shqiptarët, ndërkohë që shtetet e tjera fqinje armatosen.

Ka gjasa që amerikanët ua shpjeguan politikanëve shqiptarë të Kosovës, pjesmarrës në Rambuje, me mënyra të tjera këtë strategji të tyre, sikundër ishte, p.sh., afati trevjeçar për referendum, si dhe ajo e një konference tjetër ndërkombëtare për Kosovën, (qëllimisht u dhanë dy varjante), si dhe duke u premtuar garanci në marrjen dhe mbajtjen bashkarisht të pushtetit, UÇK dhe LDK. Dhe, nuk është rastësi që Hashim Thaçi pranoi qysh në zgjedhjet e para parlamentare, pas lufte, të bënte koalicion me LDK-në, si dhe pse është shumë i bindur ndaj ambasadorëve të tyre në Prishtinë. Kush nuk e beson këtë lloj strategjie le të lexoi dokumentat e kabllogrameve amerikane të Uikilix-it për Kosovën, të ekspozuara nga mediat gjatë muajve Korrik - Gusht – Shtator 2011.

Vendet e Evropës Perëndimore, kur u bindën për këtë pozicionim të amerikanëve, duke mos pranuar që shqiptarët të bashkohen në një shtet të vetëm, gjë që u konvenonte, e pranuan vendimin e SHBA për ndëshkimin e Serbisë.

Një arsye tjetër, pse amerikanët ishin për çmobilizimin e UÇK-së, që parashihej në atë projekt-marrëveshje, është nga që ata druheshin se mos vallë fitorja e UÇK-së trajtohej si një fitore islamike kundër një force jo-islamike, sikundër ishte ushtria e Sërbisë. E themi këtë pasi edhe humbja e ish-Bashkimit Sovjetik në Afganistan në vitet ’80 të shekullit të XX, nga historianët ushtarakë perëndimorë nuk është konsideruar si fitore afgane, por si një fitore islamike kundër një supërfuqie jo-islamike, e për më tepër kundër një ushtrie ateiste, për mos të thënë si fitore islamike kundër krishtërimit. Ja se si e komenton historiani amerikan i luftrave dhe konflikteve të ndryshme ushtarake, Xhorxh Fridman: “*Eksperienca në Afganistan do të shihej*

si një ngjarje kyçe në historinë e Islamit... Lufta e Afganistanit ishte e para luftë në shekuj, ku një forcë islamike kish mundur një forcë jo-islamike. Forca sovjetike nuk ishte vetëm jo-islamike por edhe ateiste… Më e rëndësishmja është se kjo u pa si një fitore islamike më tepër se një fitore afgane. Ushtarët që mundën Bashkimin Sovjetik ishin forca multinacionale të luftëtarëve islamikë, të paktën pjesërishtë, dhe sigurisht u bë një legjendë islamike. Paratë që u paguan për luftën ishin tërhequr prej vendeve islamike. Ideja u shndërrua se luftëtarët islamikë i dhanë fitoren e tyre Amerikës kundër Sovjetikëve"[37)], pavarësishtë se amerikanët nuk ishin pjesmarrës të drejtëpërdrejtë në atë luftë.

Por edhe "*aksioni në Ballkan* – vijon më tej Xhorxh Fridman - *u përceptua si një ndërhyrje në një luftë midis Islamit dhe Kristianizmit Ortodoks. Kristianët në Bosnjë dhe në Kosovë i panë SHBA-të duke vepruar në emër të Muslimanëve*"[38)]. Të gjitha këto e trembën Evropën, por edhe Amerikën, se mos edhe lufta e jonë në Kosovë merrte ngjyrimet e një fitoreje të islamikve kundër të krishterëve, edhe pse Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së qysh në fillim të luftës nuk i kish pranuar një grup luftëtarësh vullnetarë nga vendet islamike, të cilët patën marrë pjesë në luftën e Bosnjës, dhe këtë NATO-ja e dinte shumë mirë. Kësaj imagjinate të pabazë i vinte në ndihmë edhe propaganda e Rugovës dhe e partisë së tij, me qëllimin e vetëm që bota demokratike të mos e përkrahte UÇK-në, duke botuar madje në gazetën e tyre "Rilindja" edhe një emblemë të rreme të UÇK-së me betim ndaj Allahut.

Këto janë arsyet që "*Për Uashingtonin, pranimi i marrëveshjes nga ana e UÇK-së duhej ta theksonte izolimin e Millosheviçit; ata ishin të bindur se do të tërhiqej vetëm "duke i treguar muskujt". Kurse Evropa u përpoq deri në fund që serbët ta nënshkruanin marrëveshjen. Pra, midis dy brigjeve të Atlantikut, kishte një qëndrim jo gjithmonë*

[37)] George Friedman "America's Secret Wars", USA, 2007, f. 16

[38)] George Friedman, Po aty, f. 52

homogjen"[39], sqaron Kryeministri i atëhershëm i Italisë Massimo D'Alema.

Cila ishte arsyeja tjetër që diplomacia ndërkombëtare u ngut që Konferenca e Rambujesë të realizohej para se shqiptarët të mblidhnin Asamblenë Qytetare?

Së pari, amerikanët, duke e njohur nga afër Demaçin, duhet të kenë mbritur në përfundimin se po të arrinte Demaçi të mblidhte Asamblenë Qytetare, nga e cila do të delte Qeveria e Koalicionit, natyrisht që në krye të saj do të vendosej "nacionalisti kokfortë Adem Demaçi". Mirëpo amerikanët s'para i kanë qejf nacionalistët e tillë që shprehen si Demaçi: Unë e dua Amerikën, por më shumë dua Kosovën. Këtë e bazojmë në deklaratën e ish Presidenti Xhorxh Bush (i vjetri) në vitin 1991 në Ukrainë, i cili tha: **"Liria nuk është e njëjta gjë si pavarësia. Amerikanët nuk do të mbështesin ata që kërkojnë pavarësi, …amerikanët nuk do të mbështesin ata që kërkojnë njënacionalizëm…".** Kjo është një arsye më shumë që shpjegon pse amerikanët e pranuan propozimin frances.

Një arsye tjetër është se ndërkombëtarët nuk i linte paragjykimi që kishin krijuar për UÇK-në si ushtri "komunistësh" e "enveristësh", i ushqyer ai paragjykim edhe nga LDK-ja, me qëllim që amerikanët të mos e pranimin UÇK-në as si ushtri, as si luftë, si dhe të mos e njihnin Demaçin si përfaqësues të saj politik. Dhe kjo vihej re në faktin që Rugova nuk e thirri asnjëherë Demaçin edhe pse e quante veten President të Kosovës dhe Komandant të Forcave të saj të Armatosura! As Serbia dhe as Rugova nuk donin ta njihnin Demaçin si Komisar Politik i UÇK-së!

Dhe këto përfundime logjike na i përforcon edhe këshilltari kryesor i atëhershëm i Ibrahim Rugovës, Xhemail Mustafa: "*ndërmjetësit Hill dhe Petriç, ndërkaq, kishin informacione se shqiptarët do të mund të bashkoheshin pikërisht rreth Asamblesë Qytetare. Duket se kjo ishte arsyeja pse ata e shpejtuan fuqishëm idenë e Konferencës së*

---

[39] Massimo D'Alema, "Kosova, Italianët dhe lufta", Tiranë, 2004, f. 20

Rambujesë, në një situatë kur kishte angazhime serioze për krijimin e kësaj asambleje."[40]. Gjithashtu, për ndërkombëtarët nuk dihej se cilat do të ishin vendimet e asaj Asmableje të drejtuar nga i paparashikueshmi Adem Demaçi.

SHBA e pranuan propozimin frances për Rambujenë edhe për faktin që të mos e linin Francën të kishte monopolin në ato bisedime. Dhe këtë na e shpreh qartë sekretarja amerikane e shtetit, zonja Medlin Ollbrajt kur thotë: "*Unë rashë dakord, dhe shkova të merrja pjesë në bisedime për dy qëllime kryesore*: *së pari, të bindja serbët se marrëveshja do të ishte në interesin e tyre, çka e besoja edhe vetë; së dyti, të bindja shqiptarët të pranonin marrëveshjen-kornizë që kishte propozuar Grupi i Kontaktit*"[41], (i cili përbëhej nga SHBA, Anglija, Franca, Kanadaja, Rusia, Gjermania, dhe Italia. Amerikanët e pranuan atë propozim), pasi "*pa mbështetjen e Evropës nuk mund t'i realizonim qëllimet tona në Kosovë*."[42]

Njëkohësisht amerikanët pranuan të ishin të pranishëm në atë konferencë, edhe për faktin tjetër se ata e patën "*zbuluar planin e përgjithshëm strategjik të Millosheviçit për të "zgjidhur" problemin shqiptar, i njohur si Operacioni Patkoi i Kalit*"[43], për të dhënë një shembull kuptimplotë sesi duhej dhe si mbroheshin parimet e tyre humane. Dhe, për realizimin në ato momente të Operacionit "Patkoi", serbëve u erdhi në takim jo vetëm vendimi i Dr.P, për të shkuar në Rambuje, por edhe urdhëri i H. Thaçit për ndalimin e luftimeve dhe zgjerimin e mëtejshëm të UÇK-së. Po të ishte zgjeruar UÇK-ja sipas strategjisë së Demaçit, për kalimin e saj në sulme të shpeshta në tërë territorin e Kosovës, "Patkoi" nuk do të kishte sjellë aq masakra dhe përdhunime sa solli në kushtet e "strategjisë" së Drejtorisë Politike.

Duke ndjekur rrugën deri te Konferenca, mund të thuhet se thirrja me

---

[40] Xhemail Mustafa "Një lutje për Prishtinën", Prishtinë, 2000, f. 200-201
[41] Madeleine Albright, "Zonja sekretare", Dudaj, Tiranë, 2003, f. 464
[42] Po aty, f.449
[43] Pr.Dr John G. Stoessinger "Pse kombet shkojnë në luftë", Tiranë 2009, f. 154

urgjencë e saj plotësoi atë që shumë diplomatë europianë nuk e arritën dot përmes bisedimeve që bënë paraprakisht me Adem Demaçin në Prishtinë. Dhe këtë na e tregon vetë ambasadori britanik në Beograd, Brajan O'Donel, në datë 4 Shkurt 1999, kur doli në TV Beograd: "*Bashkësia ndërkombëtare respekton sovranitetin territorial të RFJ-së. Kërkesat për pavarësinë e Kosovës ose, siç e quajnë disa, Republika e Kosovës, as që mund të vijnë në konsiderim*"[44]. Por edhe "*Franca dhe Gjermania thuajse nuk ishin kurrë të gatshëm të përballeshin me Moskën. Italianët bënin mjaft biznes me serbët dhe nuk i donin sanksionet*"[45], na e plotëson përgjigjen e pyetjes zonja Medlin Ollbrajt.

Parë në këtë kontekst, në gjykimkin tonë, amerikanët, sikundër treguan edhe ngjarjet, ishin mbështetësit më të mëdhej të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, duke e përligjur pranimin e thirrjes së Konferencës së Rambujesë me justifikimin *për të ndërprerë sa më shpejt vrasjet dhe masakrat në Kosovë*[46], por kjo më së shumti ngaqë insistonin francezët dhe anglezët.

Edhe sot qëndrimi angles ka ngelur i pandryshuar. Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jan Klif, në datën 5 Maj 2014 shprehu frikë nëse në zgjedhjet e përgjithshme Lëvizja Vetëvendosje do të fitonte shumicën në Kuvendin e Kosovës, (ngaqë këmbëngul në bashkimin e Kosovës më Shqipërinë dhe trajtohet si pasuese e UÇK), ndërkohë që nuk ka reaguar me rastin e fitores së radikalëve apo socialistëve të Millosheviçit në Serbi, si dhe ka përkrahur themelimin e Gjykatës së Veçantë Njëetnike kundër luftës[47], e cila ka për t'i sjellë dëme Kosovës në imazhin ndërkombëtar.

Pavarësisht se Adem Demaçi nuk u bë pjesë e asaj Konference Ndërkombëtare, (rasti i parë ku përfaqësohej Kosova në një forum të

---

[44] Fehmi Baftiu: "Kosova krizë ndërkombëtare", Prishtine, 2004, f.320

[45] Madelein Olbright: "Zonja sekretare", f. 446

[46] Noam Chomsky "Failed States", Pinguin Books, London, England, 2006, f.95

[47] Shih www.radiokosovaelire.com, datë 5 Maj 2014

tillë ndërkombëtar), ai porsa e lexoi projekt-marrëveshjen desh ta shfrytëzonte atë angazhim ndërkombëtar si rastin më të volitshëm për të njohur ndërkombtarisht UÇK-në dhe luftën e saj të drejtë, prandaj, qysh të nesërmen këmbënguli që çështja e UÇK-së dhe 9 (nëntë) çështjet e tjera të panegociueshme, të ishin të negociueshme, ndryshe...(!)

Kurse Drejtoria Politike, (dhe më pas një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së), e pranuan propozimin e Francës! Kur Dr.P e pranoi propozimin frances, atëherë Demaçi pyeste dhe përgjigjej po vetë: "*Përse u angazhuan, pikërisht, francezët? Sepse francezët ishin të parët që "nuhatën" se forcat serbe nuk do të ishin të zonjat ta shuanin kryengritjen shqiptare pa rënë në kurthin e pafalshëm të gjenocidit mbi popullin shqiptar. Dhe në atë rast mekanizmat ndërkombëtare nuk do të kishin qare pa reaguar dhe Serbia për pasojë do të humbte çdo atu për të mënjanur më tutje Kosovën*"[48)].

Përsa i përket Kryetarit të LBD, akademikut poliedrik të kulturës shqiptare, zotit Rexhep Qose, edhe dy vjet pas asaj konference, ai nuk është ende i qartë se pse kish shkuar në Rambuje. Dhe këtë e shohim tek përgjigjia e tij dykuptimshe (ambiguitive) ndaj një pyetjeje që i është bërë në Vlorë, në 21 Maj 2001, nëse kosovarët ishin detyruar apo jo diplomatikisht për ta nënshkruar Rambujenë, ku thotë: *"Ajo konferencë është bërë për të ndëruar fatin e Kosovës, jo për ta lënë ashtu siç ishte. Natyrisht në Marrëveshjen e Rambujesë, Kosovës i parashikohej statusi i autonomsë, si e quajnë ndërkombëtarët "substanciale". Këtë autonomi substanciale ata nuk e kanë shpjeguar asnjëherë. Asnjëherë nuk kanë thënë dhe s'kanë arritur të na thonë edhe sot e kësaj dite se çfarë nënkupton "substanciale."*[49)]"!

Ndërsa, për atë "ngutje të francezëve", Ibrahim Kelmendi na jep të dhëna se ka pasur bashkpunim të më hershëm midis zbulimit

---

[48)] Adem Demaçi*:* "Liria dhe joliria", Prishtinë, Tetor 2002, f. 38

[49)] Servet Tartari "Labëria në kuvende", Tiranë 2014, f. 74-75

ushtarak frances dhe Hashim Thaçit, qysh prej viteve 1994-1998. Ai shpjegon se në ato vite Thaçi dhe Kadri Veseli, edhe pse ishin në Zvicër, nuk qenë aktivizuar në LPK, por shfaqen papritmas në mbledhjen e përgjithshme të jashtëzakonshme të saj, në Tiranë, në Maj 1998, edhe pse nuk ishin delegatë të asnjë nëndege të LPK-së.[50)]

Madje Ibrahim Kelmendi jep edhe të dhëna të tjera, ku përforcon lidhjet e Hashim Thaçit me zbulimet franceze, kur thotë: *"Po atë ditë (23 Shkurt 1999, D.G) më takon një bashkpuntor i stafit të ministrit të jashtëm gjerman, Joshka Fisher. M'u lut të shkoja në konferencën e shtypit që do të mbante ai, "meqë do të bisedojë me ju." Shkova. Sapo mbaroi konferencën e shtypit, ju afrova Fisherit: "Je ti Ibrahim Kelmendi?", më pyeti. M'u drejtua kështu për të dëshmuar se më njihte si koleg të të njëjtës parti, meqë unë isha i angazhuar në partinë e tij, "Të Gjelbërtit"…. "Situata është serioze. Këshilltarët më thonë se ti je pengesa kryesore që Zoti Thaçi nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen. Ma bëj këtë nder, dhe i thuaj zotit Thaçi të nënshkruajë"…. I zënë ngushtë, i thashë: Nuk jam unë penguesi, për më tepër nuk kam as si të jem, megjithatë po ua them dyshimin tim se kush në të vërtetë po pengon. Jo unë, as komandantët e zonave të Ushtrisë sonë, por po e pengon Shërbimi Informativ Ushtarak Francez. Këtu në Konferencë ndodhet edhe një oficer i atij Shërbimi, të cilin zotëri Thaçi e paraqet si "shok personal". Kam drojën se Zotëri Thaçi ndikohet nga ai, ose ai ka gjetur mënyrën për të bërë presion ndaj tij. Duhet të intervenoni permes Qeverisë Franceze, që "shoku personal" të mos bëjë presion ndaj Thaçit dhe më pas, besoj unë, edhe Thaçi do pranojë*".[51)]

Dhe më pas Ibrahim Kelmendi vijon: *"Hashimi erdhi në Aeroport të Këln/Bonit… Me Hashimin ishte Bilall Sherifi… Hashimi dhe Bilalli u*

[50)] Bedri Islami: "Lëvizja-lindje e përgjakur", Tetovë 2012, f.245-246 dhe 464-465

[51)] Bedri Islami"Lëvizja", f.464-465).

*ngjitën në dhomë, në hotel, për të lënë valixhet, unë po prisja te holli. Duke qenë aty m'u afrua një zotëri dhe më përshëndeti me një gjermanishte, në të cilën dallohej aksenti francez: "Mirëdita, Zotëri Kelmendi. Jam shoku i Hashim Thaçit..". U ulëm dhe deri sa prisnim po bisedonim. E pyeta, që kur ishte shok me Hashimin dhe ku ishin takuar për herë të parë. Më tha se e kishte takuar në kursin e gjermanishtes në Cyrih, ku e kishte dërguar Shtabi i Ushtrisë së tij për të mësuar gjermanishten. Me atë rast ma zgjati kartvizitën. E pyeta paksa me nëntekst: "Nuk kishte Shtabi juaj një kurs të gjuhës gjermane në Paris, ose në Gjermani, diku më afër se sa në Cyrih? Përse pikërisht në Cyrih, ku qytetarët nuk e flasin gjermanishten standarte?" Pyetja ia thartoi ca paraqitjen e fytyrës dhe zuri të arsyetohej se në Cyrih ai kishte pasur dëshirë të mësonte gjermanishten, se ishte koinçidencë që aty e njohu dhe u shoqërua me Hashimin… Disa muaj pas Çlirimit të Kosovës, në Hotel Grand në Prishtinë, më rastisi të asistoja në një fjalosje të rreptë midis Bardhylit (Mahmudi) dhe "shokut personal" të Hashimit. Ndërhyra që Bardhyli të përmbahej. "Mos ndërhyj, ky nuk është mik, por një spiun i fëlliqur proserb…" – më foli Bardhyli"**[52]**.

Dhe ky "shoku personal" erdhi pas Rambujesë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK!

Ardhjen e oficerave të zbulimit frances pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së është vetë Hashim Thaçi që ia ka pohuar Bernard Kushnerit, Përfaqësuesit Special të OKB në Kosovë, (shefi i UNMIK-ut), duke i thënë: "Në *Shtabin tonë të Përgjithshëm erdhën disa punonjës të shërbimeve të fshehta franceze*"**[53]**; ndërkohë që oficerat zbulues amerikanë u refuzuan të vinin pranë SHP të UÇK-së!

Këto të dhëna prej Ibrahim Kelmendit i përforcon edhe ish-Shefi i Shërbimit Inteligjent Frances në vitet '90**,** Pjer Sirami, si dhe informatori specialist për Ballkanin i atij shërbimi, Arno Donzhou,

---

[52] B. Islami "Lëvizja-lindje e përgjakur", f. 466-468

[53] Bernard Kushner*: "Luftëtarët e paqes", Mësonjëtoria", 2004, f.119*

treguar në emisionin televiziv *"Zonë e ndaluar", në "Vizion Plus",* datë 10 Tetor 2011, me temën: "*Hije mbi Hashim Thaçin*", i drejtuar nga gazetari Paskal Henri, në përgjigje të pyetjes: "A ka qenë Hashim Thaçi person i shërbimeve sekrete franceze?". Të dy zbuluesit francezë e pohuan se "*ai është kontaktuar nga njeriu ynë në Kosovë për pranimin e shkuarjes në Rambuje. Deri atëherë,* - theksuan ata, - *Franca përkrahte Rugovën, ngaqë ishte frankofon. Gjithçka luhej në prapaskenë. Thaçi, është njeriu ynë edhe si kryeministër, ai është një këmbëz e Francës për Ballkanin, ndaj dhe e quanim një sukses lidhjen me Thaçin*"[54)].

Për Adem Demaçin nuk ishte argument bindës pretendimi i zotit Jakup Krasniqi se UÇK-ja "*po sabotohej nga qeveria Bukoshi si dhe po mbylleshin rrugët e furnizimit*", si dhe "*me potencialin dhe organizimin e tashëm ushtarak, UÇK-ja nuk mundet të ngadhënjei në luftë*", argumenta që u përdorën praktikisht për të ndërprerë luftën dhe për të shkuar në Rambuje. Këto "argumenta" delegatët e UÇK-së i shprehën edhe para diplomatëve të huaj, me të mbërritur në Rambuje. Ndërkohë Adem Demaçi këmbëngulte në vendimin e tij të kthjellët, pasi, përveç fakteve optimistë që numëronte zoti Jakup Krasniqi, shihte se në radhët e UÇK-së kishte mbi 400 vajza luftëtare. "*Në cilën anë të luftës sheh se gratë kanë rrokur armët, mos dysho në të drejtën që ka ajo anë, sepse gruaja nuk i kap armët pa qenë gjendja e padurueshme*", thotë Sami Frashëri. Duke patur parasysh Kosovën patriarkale, ky fakt vlen të nënvizohet sepse është shprehja më e plotë që tregon se masivisht populli ishte me trimat, me rrugën e luftës që ata kishin zgjedhur, dhe për pasojë, zemërimi për shtypjen dhe urrejtja e tij ndaj armikut kish gjetur rrugëdaljen e drejtë, por priste që dikush t'i thoshte: Merr armën dhe dil!

Bazuar në këto fakte, Adem Demaçi e ndjente se delegatët e UÇK-së jo vetëm që e braktisën ëndërrën e UÇK-së, por ishin ata që çonin në Paris "fermanin", edhe pse ajo ishte faktori kryesor për ndërtimin e

---

[54)] TV "Vizion Plus",emisioni "Zonë e ndaluar", 10 Tetor 2011

Kosovës së re, por që me atë ferman ata do të sillnin çarmatosjen pa kushte të saj. Këtë e kuptoi shumë shpejt edhe Veton Surroi ndaj dhe shpejtonte dhe bënte çmos të nënshkruhej sa më shpejt Marrëveshja, duke u shprehur: "*dorëzimi i armëve është njëri prej më simbolikave për konstatimin, se UÇK-ja nuk ka qenë çlirimtare*."[55)]

Është me interes të analizohet, me aq sa kemi mundësi, edhe ky fakt: këto parakushte të projekt-marrëveshjes ishin refuzuar disa ditë më herët edhe prej vetë Shtabit të Përgjithshëm, përmes zëdhënësit të tij politik, z.Jakup Krasniqi, para se ai shtab të deklaronte të kundërtën[56)].

Kur Jakup Krasniqi, me deklaratën e 3 Shkurtit 1999 komunikoi vendimin se antarët e Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe të Shtabit të Pergjithshëm do të shkonin në Rambuje[57)], deklaratë e cila binte ndesh me atë të 30 Janarit 1999, ai u shndërrua nga sulltan në skllav.

Delegatët e UÇK-së shkuan vullnetarisht në këtë rrugë, duke vendosur me veton e tyre pjesëmarrjen, pa u konsultuar aspak me Demaçin, të cilin e kishin zgjedhur vetë në krye të politikës së luftës dhe të UÇK-së! Konsultimi i Dr.P me Demaçin ishte i detyrueshëm, detyrim, i cili buronte nga marrëveshja e tyre me Demaçin në 13 Gusht 1998. Madje, të paktën, dy antarët e asaj drejtorie politike, Xh. Haliti dhe A. Sylla, të cilët e thirrën dhe i propozuan atë funksion Demaçit në emër të Dr.P, ishin të detyruar të kontaktonin me të dhe ta sqaronin pse ata po e shkarkonin de fakto nga ajo detyrë që ia patën propozuar vetë; por, për fat të keq, deri sot ata nuk e kanë marrë mundimin të japin qoftë edhe një spjegim sado formal, apo t'i kërkojnë falje! Për këto arsye e themi me bindje se ai vendim i Drejtorisë Politike s'ishte gjë tjetër, veçse për t'u vetëlidhur me

---

[55)] Veton Surroi "Këmbët e gjarpërit", Prishtinë, Qershor 2014, f. 79

[56)] Shih Deklaratën e z. Jakup Krasniqi, në cilësinë e zëdhënësit dhe përfaqësuesit politik i UÇK-së, dhënë Radios Kosova e Lirë, datë 30 Janar 1999. (Ar*kivi i RKL, vëll.1, f.135-136)*

[57)] Shih Arkivi RKL, v.1, f.164

zinxhirët e Serbisë dhe të aleatëve të saj.
Adem Demaçi, nga këto zhvillime thuajse krejtësisht të papritura, bluante në mendje të njëjtat dyshime që ka në kokë një luan i tmerruar, kur gjendet mes një mizërie njerëzish, që e rrethojnë dinakërisht, ndaj dhe do t'i jenë shtruar përpara një varg pyetjesh pa përgjigje, por mbi të gjitha: Mos vallë çështja e luftës u tradhëtua?
Deri në ato momente, fundi i Janarit 1999, kishin dështuar të gjitha përpjekjet e diplomacisë së huaj për ndërprerjen e luftës çlirimtare nga ana e UÇK-së. Me propozimin urgjent për çeljen e një konference në Paris dhe pranimi i beftë i saj prej Dr.P, u hap një hendek midis asaj dhe Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së, por edhe një perspektivë e zymtë për UÇK-në.
Kthesa e papritur që morën antarët e Dr.P dhe SHP në ato katër ditë, (fundi i Janarit dhe fillimi i Shkurtit 1999), nuk është krejtësisht e papritur. Ajo e ka bazën që në marrjen e vendimit e atyre pak përfaqesuesve të UÇK-së, pa autorizimet përkatëse e pa miratim sa më të gjerë prej atyre që po bënin luftën, që ata të shkonin në atë Konferencë.
Duke e shtruar kështu problemin, kjo nuk do të thotë se Adem Demaçi ishte kundër çdo lloj tryeze bisedimesh, për të arritur në përfundimin që Rambujenë ta quajmë apo ta vleresojmë si një "aksident të rëndë" në rrugën e Kosovës për liri e pavarësi. Kur Demaçi është pyetur për këtë problem nga gazetari Shkëlzen Gashi, në vitin 2004, ai është shprehur: "*Të gjithë draftet e Hillit ne i kemi pranuar, duke përjashtuar sovranitetin dhe integritetin e Jugosllavisë. Kjo ka qenë pika në të cilën ne kemi insistuar dhe nga e cila nuk kemi hequr dorë kurrë*"[58]).
Mbi këtë bazë gjykojmë që për një varg interesash komplekse, kryesisht të huaja, grupi i delegatëve shqiptarë në Konferencë ka qenë nën presion, e në mënyrë të vaçantë përfaqësuesit e njohur e të vetëzgjedhur të UÇK-së.

---

[58]) Shkëlzen Gashi: "Marrëveshja për paqe të përkohëshme", f. 18

Nga ana tjetër, ata u gjendën në këtë Konferencë pa përvojën e duhur politike që të angazhohen në bisedime të vështira ndërkombëtare, ku diskutohej e ardhmja e Kosovës, ku "luftohet" edhe për një fjalë e për një rrjesht në dokumentat që nënshkruhen. Ata nuk kishin as njohuritë fillestare se si vepron "diplomacia", të cilën po e quajmë në këtë rast - pse jo! – diplomaci e "rrahjes së shpatullave", e "buzëqeshjeve lajkatuese", për të mos folur për premtime ndaj të cilave janë joshur, (si p.sh. ai i referendumit), fatkeqësisht të pushtuar nga etja për pushtet. Ja, në këtë terren gjeti kushte dhe u mboll ajo farë që zhbëri faktikisht UÇK-në.

Ky vendim i befasishëm i Shtabit të Përgjithshëm, shpallur përmes Jakup Krasniqit, kishte si rrjedhojë logjike mosnjohjen më tej të Adem Demaçit si Përfaqësues i Përgjithshëm Politik i UÇK-së, duke na detyruar të mendojmë se jemi në konturet e një puçi të mirëfilltë ushtarak, pasi SHP i UÇK-së, me të tilla hapa që u hodhën për shkuarjen në Rambuje, vihej mbi politikën, dhe kjo ndodhte në udhëheqjen më të lartë të UÇK-së! "*Puçi nuk është një sulm nga jashtë. Puçi është një fenomen i kohës së luftës që bëhet nga një pjesë e trupës së forcave të armatosura nën udhëheqjen e lidershipit të vet*"[59].

Për Adem Demaçin, ai vendim i Drejtorisë Politike dhe i SHP, e thënë më ashpër: *a cope*, tregonte "*gatishmëri për ta pranuar sovranitetin dhe integritetin territorial të RFJ*"[60]; dhe, për pasojë, nënkuptonte shndërrimin e UÇK-së në një qengj i bërë kurban dhe që më pas ajo ushtri nuk do t'i shërbente popullit që e lindi, që e mbështeti dhe që e mbajti në këmbë, pasi nuk zgjidhi asgjë nga synimi kryesor që e kish deklaruar publikisht më herët. Si rrjedhojë, ajo ushtri nuk duhej të ekzistonte më pas mbarimit të luftës, ndaj dhe nuk ia përmendën as emërin në atë Marrëveshje, ashtu edhe në Rezolutën 1244; të paktën delegatët e UÇK-së të insistonin që t'i shkruhej emëri UÇK në atë

---

[59] Edward Luttwak "Coup d'Etat",USA, N.Y., October 1969, f. 10

[60] Arkivi i RKL, v.1, f.158

marrëveshje, por as atë nuk mundën. Ja se ç'do të thotë të nënshtrohesh e të nënshkruash pa kushte. Dhe kjo nuk u bë pa qëllim nga ndërkombëtarët: UÇK-së nuk duhej t'i jepej mundësia të merrte pushtetin në Kosovë, as edhe mundësia të ekzistonte qoftë edhe si një ushtri e çarmatosur (si TMK-ja[61]).

Për ta vënë në jetë këtë vendim të parashikuar qysh në projekt-marrëveshjen e Rambujesë, pra "vdekjen klinike" të UÇK-së, menjëherë pas nënshkrimit të asaj Marrëveshjeje, së bashku me delegacionin e UÇK-së, u nis nga Parisi dhe erdhi në Kosovë edhe njeriu i posaçëm, që do ta zbatonte pikë për pikë atë vendim fatal, Agim Çeku. Dhe ai e nisi misionin e tij qysh në pamfletin e KFOR-it, të emërtuar *"Ndërmarrja e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së*", i shpërndarë nga ajri dhe toka nëpër të gjitha qendrat e banuara të Kosovës, gjatë muajve Korrik e Gusht 1999. Në pikën nr.2 të atij pamfleti-trakt shkruhet: "*Sipas kësaj ndërmarrjeje duhet që të gjithë ata që s'janë nga Kosova të largohen: e sidomos duhet të largohen këshilltarët, luftëtarët e lirisë, ekspertët, vullnetarët dhe antarët e tjerë të ardhur nga vendet fqinjë*". Ndërsa në pikën nr.3 të saj thuhet: "*Demilitarizimin dhe integrimin e UÇK-së në jetën e përditshme të Kosovës e ka nënshkruar dhe verifikuar komandanti i UÇK-së, Agim Çeku, dhe është aprovuar nga komandanti i KFOR-it*".
Këto dy pika, edhe pse u hoqën nga Marrëveshja gjat bisedimeve në malet e Berishës, (Katundi i Ri), midis UÇK-së dhe Komandantit të KFOR-it, Gjeneralit Xhekson, (në datat 18-20 Qershor 1999), përsëri del se janë pranuar nga zotërinjtë Thaçi e Çeku, pas shpinës së SHP, kur shkuan me helikopter në Prishtinë për ta nënshkruar atë, në pasditen e datës 21 Qershor!

---

[61] TMK: në origjinalin anglisht thuhet: Kosovo Protect Corps, (dhe jo Defence Corps), por qëllimisht është përkthyer "Trupat Mbrojtëse të Kosovës", që populli të mos dyshonte se UÇK-ja ishte eleminuarr totalisht.

NDËRMARRJA

Më 21 Qërshor, Hashim Thaqi, përfaqësuesi legjitim i UÇK-së

Nënshkroi "Ndërmarrjen për Demilitarizimin dhe Transformimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Nënshkrimi I kësaj ndërmarrje ka të bëjë me armëpushimin dhe demilitarizimin edhe të ushtarëve të UÇK-së. Me anën e kësaj ndërmarrje parashihet që UÇK-ja aktivitetin e vet do ta zhvilloje, duke u inkuadruar në jetën shoqërore dhe civile të Kosovës. Marrëveshja parasheh kohën deri ku duhet të bëhet demilitarizimi.

Çështje kyçe del se ndërmarrja duhet të ptotësohet para 19 shtatorit.

1. Sipas kësaj ndërmarrje të gjitha armë e kalibrit prej 12.7 mm dhe të gjitha llojet e armëve:, antitankë , armët kundërajrore, granatat , minat dhe mjetet eksplozive janë të ndaluara.

Të gjitha këto lloje të armëve do të vëndosën në ve ndet që më parë janë regjistruar dhe janë verifikuar nga të dy palët: KFOR-i, dhe UÇK-ja. Këto depo të armatimit dhe të deponimit të municionit do të jenë nën kontrollin e UÇK-së dhe të KFOR-it.

2. Sipas kësaj ndërmarrje duhet që të gjithë ata që s'janë nga Kosova të largohen: e sidomos duhet të largohen këshilltarët, luftëtarët e huaj, ekspertët, vullnetarët dhe anëtarët e tjerë të ardhur nga vendet fqinje.

3. Demilitarizimin dhe integrimin e UÇK-së në jetën e përditëshme të Kosovës, e ka nënshkruar dhe verifikuar komandanti I UÇk-së, Agim Çeku, dhe është aprovuar nga komandantii KFOR-it.

"Ndërmarrja e demilitarizimit dhe transformimitt të UÇK-së" është një demonstrim dhe devotshmëri e angaizhimit të UÇK-së më dëshirë që ta përtërijë paqën në Kosovë

TASK FORCE FALCON

KFOR

E Ndihmon Kosovën Në Krugë Të Paqes

Një kopje të protokollit të këtyre bisedimeve dhe të marrëveshjes që u pranua në ato bisedime nga të dy palët, i posedon autori i këtij libri, i cili ishte edhe personi që mbajti atë protokoll. Dhe, çuditërisht, edhe pse në atë pamflet-trakt thuhej se "*të gjithë ata luftëtarë që s'janë nga Kosova të largohen",* pasi u larguan të gjithë luftëtarët vullnetarë jo banorë të Kosovës, në radhët e TMK-së u pranuan oficerë nga shteti amë, edhe pse nuk kishin marrë pjesë në luftë! Dhe sot ata marrin pension me mbi 300 Euro në muaj, ndërsa ndaj ish-luftëtarëve vijohet të mbahet qëndrim armiqësor nga të gjitha institucionet e Kosovës.

Për ta bërë edhe më bindës këtë diskreditim që u bëhet atyre që ikën nga liria dhe shkuan të jepnin edhe jetën për Kosovën, boll të krahasohet madhësia e pensionit që parashikohet prej Parlamentit të Kosovës për veteranët e luftës, i cili është 120 Euro, tre herë më pak se i atyre që nuk guxuan të rrëmbenin armërt dhe të rreshtoheshin në radhët e formacioneve të UÇK-së apo që e anatemuan këtë të fundit ose që u mjaftuan me veshjn e uniformës së saj duke u kapardisur në Shqipëri, dhe pas lufte u rreshtuan në radhët e TMK-së. Kush nuk e sheh këtë diskriminim në trajtimin e ish-luftëtarëve, të propozuar nga PDK-ja, (e cila pretendon se ka dalë nga radhët e UÇK-së, ku gjatë këtyre 15 viteve i ka braktisur totalisht këta luftëtarë), ose është qorr ose është injorant. Gjeneral Agim Çeku kaloi në politikë dhe u bë ministër i qeverisë së PDK-së pasi largoi nga radhët e TMK-së e të FSK-së edhe ish-luftëtarin e fundit të UÇK-së.

Për marrjen përsipër nga Çeku të atyre detyrave, i dërguari Special i OKB, të nesërmen e çarmatosjes së plotë të UÇK-së e shpërbleu atë me gradën e Gjeneralit, edhe pse TMK-ja nuk ishte asnjë lloj ushtrie, por thjeshtë një lloj shërbimi komunal me uniformë, e cila shprehet qartë në marrëveshjen midis zotërinjve Hashim Thaçi e Agim Çeku me KFOR-in, më 18 Shtator 1999, si dhe në regulloren e UNMIK-ut: "*Trupat Mbrojtëse të Kosovës themelohen si agjensi civile e shërbimit emërgjent, detyra e të cilave do të jetë: (a).Të sigurojnë shërbime në raste të fatkeqësive natyrore; (b). Të bëjnë kërkimin dhe shpëtimin e të rrezikuarve; (c). Të ofrojnë mundësitë e veta për ndihma humanitare në zonat e izoluara; (d). Të ndihmojnë për çminimin e zonave të minuara; dhe (e). Të kontribojnë në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve*".[62)].

Paradoksalisht antarët e Drejtorisë Politike dhe mbështetësit e verbër të saj, duke pranuar 10 pikat e panegociueshme të projekt-marrëveshjes, të cilat ishin në dëm të Kosovës, e shndërruan UÇK-

---

62) Shpëtim Golemi:"Romantika e luftës së UÇK" Tiranë-Prishtinë, 2012, f. 168-169

në në "një të mallkuar"; ndërsa vetë, duke e braktisur UÇK-në dhe idealet e saj, u bënë interpretë në potencë të të gjithë epiteteve denigruese e deri kriminale që u ishin vënë mbi kurriz luftëtarëve shqiptarë të rrjeshtuar në të parin formacion ushtarak serioz në Kosovë, siç ishte UÇK-ja, e cila iu imponua si armikut që kishte përballë – Serbisë, ashtu edhe faktorit ndërkombetar me luftën e drejtë që bëri.

Nën këtë vështrim përgjegjësia historike e atyre që nënshkruan zhbërjen e UÇK-së është e madhe. Të tillë njerëz u leverdisnin (dhe mbase u leverdisin akoma) disa qarqeve të caktuara, sidomos në Evropë, në emër gjoja të ruajtjes se "*ekuilibrave në Ballkan*". Për pasojë, dashje apo pa dashje, ata u bënë të përkëdhelurit e qarqeve politike proserbe në rradhët e ndërkombëtarëve, jo se duan që të mos i burgosin, sikundër po veprohet me të "pabindurit" e tjerë drejtues apo luftëtarë të thjeshtë të UÇK-së, por, sepse vepra e tyre që u kurorëzua me nënshkrimet që bënë në Rambuje fatkeqësisht u hyn në punë atyre që nuk ia duan të mirën Kosovës për të vërtetuar se "*UÇK-ja ishte një krijesë bandash të armatosura*"[63] dhe se *"rasti i saj është një lojë e fëlliqur marksiste-leniniste"[64],* si dhe *"grup terrorist islamik"[65].* Gabimi më i rëndë i politikës shqiptare dhe i

---

[63] Massimo D'Alema, "Kosova, italianët dhe lufta", f. 64, 139. 165

[64] Ylli Polovina, *"Ditari i Romës" , Mësonjëtorja, 2000, f.205*: "4 Tetor 1998. Partia Demokratike kish shpërndarë një deklaratë për shtyp, ku thuhej: Zhvillimet e fundit në Kosovë janë një ndeshje mes shqiptarësh e antishqiptarësh. Dy shërbimet informative, ai shqiptar e ai serb, bëjnë lojën më të fëlliqur në historinë e kombit shqiptar në kuriz të dymilionë shqiptarëve të pambrojtur në Kosovë. Ata ia dolën të vendosin në krye të UÇK-së element të Millosheviçit, bashkpuntorë të tij, me damkën e marksist-leninistave.". Ndërkohë që në krye të UÇK ishte Adem Demaçi dhe ishte njohur nga ndërkombëtarët, të cilët kishin pranuar edhe armëpushimin e njëanshëm të saj!

[65] Ylli Polovina, Po aty, *f.220*: "Fatos Nano dëgjoi amerikanët, dëgjoi çfarë u tha nëpër zyrat e Brukselit, mori vesh se çfarë mendonte Ibrahim Rugova, bëri vemendien se çfarë qëmtoi për t'ia zbrazur rrethit të ngushtë

diplomacisë ndërkombëtare, si atëherë edhe tashti, vijon të jetë se e gjykojnë UÇK-në sipas tregimeve serbe dhe intelektualëve filojugosllavë, si Veton Surroi, që thotë: *"jam i gatshëm të marrë përsipër edhe konsekuencat e herezisë dhe të them se nuk ka ekzistuar ndonjëherë Ushtria Çlirimtare e Kosovës."*[66], gjë që tregon se edhe në Rambuje ai ka bërë këtë politikë, ndaj dhe e zgjodhën ndërkombëtarët bashkëkryetar të delegacionit kosovar. I "pavaruri" Veton dhe gjithë bashkëmendimtarët e tij vendas e të huaj i trajtojnë luftëtarët e UÇK-së si kriminelë, ngaqë nuk e kuptojnë, se tek pragu i paragjykimeve të tyre për atë ushtri çlirimtare qëndron një realitet krejt ndryshe.

Sot, pas 15 vjetësh, ngjarjet e këtij fillimviti, ku Evropa po përgatitet të ngrejë në Kosovë ose jashtë saj Tribunalin e posaçëm ndërkombëtar[67], që pritet të gjykojë "krimet e luftës", të cilat pretendohet se jenë kryer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, tregojnë se largpamësia e Demaçit ishte e jashtëzakonshme!; ai e shihte qysh

---

të tij Sali Berisha dhe u bashkua me të gjithë ata: në Dhjetor 1997, fare pak muaj pas Kretës, në gazetën e partisë së tij, "Zeri i Popullit", ai e quajti UÇK-në një grup terrorist islamik".

[66] Veton Surroi "Këmbët e gjarpërit", Prishtinë, 2014, f. 76

[67] Në datën 23 Prill 2014 Kuvendi i Kosovës me 89 vota pro, 22 kundër dhe 3 abstenime e miratoi atë Tribunal, që do të funksionalizohet pas datës 14 qershor 2014, (i cili që do të merret me hetimin e raportit të senatorit zviceran, Dik Marti), ku të gjithë delegatët e UÇK-së në Rambuje qenë dakort, përfshi edhe Agim Çeku, i cili është antar i Qeverisë që e propozoi në Parlament këtë Tribunal! Edhe ish-kryeprokuroja e Tribunait të Hagës, **Karla del Ponte,** e cila kishte sajuar lajmin virtual për gjoja trafikimin e organeve nga UÇK-ja, duke folur për radion zvicerane SFR, është shprehur kundër këtij Tribunali, duke thënë se "nuk ka nevojë të ketë Gjykatë të re për të gjykuar krimet e pretenduara të luftës në Kosovë. Ka një Tribunal që trajton krimet e kryera në hapësirën e ish Jugosllavisë dhe se ky është Tribunali ndërkombëtar i OKB-së në Hagë. Të gjitha hetimet që janë bërë për krimet e mundshme në Kosovë, kanë qenë pjesë e këtij Tribunali. Të gjitha hetimet, të cilat janë kryer për krimet e supozuara në Kosovë, për të cilat planifikohet të themelohet Gjykata, deri më tani nuk kanë sjellë asgjë në dritë."(www.radiokosovaelire.com, 24.4.2014).

atëherë se, qëllimi final i disa shteteve të fuqishme të Evropës ishte kriminalizimi i UÇK-së!

Dhe, për t'i bërë bindës ato lloj epitetesh ndaj UÇK-së, diplomatët europianë bënë zhurmë për orekse gjoja shqiptaromadhe, duke shfrytëzuar emërtimet që pat bërë LPK-ja për zonat e hershme operative në të gjitha trojet shqiptare nën ish-Jugosllavi: "*Si zonë të parë operative kishim Kosovën, si zonë të dytë Maqedoninë, si zonë të tretë Preshevën, si zonë të katërt Malin e Zi dhe si zonë të pestë kishim emigracionin*"**68)**, sikundrër shpjegon Ali Ahmeti; si dhe deklaratën e zotit Jakup Krasniqi, në verën e vitit 1998, i cili, në një dalje të tij në TVSH, pat deklaruar se "*qëllimi i luftës së UÇK-së është bashkimi i trojeve shqiptare në Ballkan*"69), (sipas programit të UÇK)**70)**, gjë që përmendej edhe në tekstin e Betimit Ushtarak të saj.

Amerikanët, duke qenë nën presionin e diplomatëve europianë, ndoshta e besuan mendimin e hedhur prej tyre se mund të ndodhte edhe një reagim masiv dhe i menjëhershëm në mbështetje të UÇK-së, në të gjitha trojet shqiptare nën ish-Jugosllavi, gjë që do të vihej në rrezik jo vetëm siguria në Ballkan, por edhe stabiliteti në Evropë. Këtë supozim të europianëve e përforconte fakti që, pavarësisht se Shqipëria sapo kishte dalë nga kriza e rëndë e piramidave financiare, ajo gjeti forca që në përkrahje të Kosovës të formulonte thirrjen "Një komb, një qëndrim!".

Njëkohësishtë, amerikanët, duke pranuar nismën franceze për konferencën urgjente, e cila nuk i linte asnjë hapësirë për diskutim përfaqësisë kosovare, menduan se mos vallë në radhët e UÇK-së dhe të popullit shqiptar në Kosovë lindte pakënaqësi ndaj tyre, gjë që nuk u interesonte, pasi kjo pakënaqësi gradualisht mund të shtrihej edhe në tërë kombin shqiptar, si kombi më pro amerikan në Ballkan. Ndoshta janë të gjitha këto zhvillime që e nxitën

---

68) Shih Bedri Islami "I vërteti", Tetovë 2011, f. 210

69) Zekeria Cana "Ditari i Robërisë", v.2, Prishtinë, 2000, f. 35

70) Shih J.Krasniqi, "Kthesa e Madhe", f. 83

Departamentin Amerikan të Shtetit të deklaronte në 3 Shkurt, duke thënë se, "*plani amerikan po shqyrton mundësinë e dërgimit të trupave tokësore*" dhe se autonomia për Kosovën *do të ishte për një periudhë tre vjeçare e pastaj do të aplikohej referendumi* (vetvendosja)[71]. Hedhja nga amerikanët e varjantit për vetëvendosje pas një periudhe tre vjeçare, ndoshta ishte edhe për të thyer rezistencën e Adem Demaçit, që ai të pranonte të kryesonte delegacionin në Rambuje; njëkohësisht edhe një lloj "karremi" që masa e gjerë e luftëtarëve të UÇK-së ta pranonte atë projekt-marrëveshje.

Këtë gjë na e pohon edhe një ndër drejtuesit e njohur të rezistencës kosovare, Ibrahim Kelmendi, kur thotë, se madje "*edhe ne të Lëvizjes ishim pro nënshkrimit, me që në marrëveshje u miratua faza kalimtare 3-vjeçare dhe referendumi i popullit të Kosovës për pavarësi.*"[72].

A do të thotë kjo, se të gjithë u mikluan nga ky qëndrim, përveç A. Demaçit!? Një përgjigje shterruese është e vështirë të jepet për këtë pikë. Veç dimë që Demaçi këtë gjë e ka ritheksuar edhe 5 vite pas luftës, apo 10 vite më herët se u shpall ky Tribunal i Posaçëm i këtij viti, duke thënë: "*Nga luftëtarë e kryengritës të lirisë, jemi shpallur "terroristë". E "terroristëve", si "shpërblim", iu rezervohen burgjet e dënimit*"[73].

Ajo deklaratë e amerikanëve, për vetëvendosje pas tre vjetësh, i erdhi në takim Drejtorisë Politike, pasi miratohej nga masa e gjerë vendimi i saj. Dhe ashtu ndodhi. Masa e gjerë shqiptare e miratoi

---

[71] Shih Ramë Buja,"Konferenca e Rambujesë", Prishtinë, 2006, f. 124 & Jakup Krasniqi,"Kthesa e Madhe", f.181 dhe Madeleine Albright, "Zonja sekretare", f.470

[72] Bedri Islami: "Lëvizja-lindje e përgjakur", Tetovë, 2012, f. 469

[73] Gazeta "Epoka e Re", e Premte, 12 Mars 2004

vendimin e Drejtorisë Politike dhe filloi ftohja graduale ndaj Demaçit.
Fakti që tre vjet më pas, në vitin 2002, jo vetëm që nuk pati asnjë lloj përpjekje a diskutim për atë "*referendum për vetëvendosje*", por as që u përmend fare prej asnjerit nga ish-delegatët kosovarë në atë konferencë!, edhe pse tashmë ishin të gjithë me funksione të larta në organe politike vendimmarrëse të Kosovës, flet qartë që: *ai premtim ishte një hile e propozuar nga delegatët e UÇK-së!* Ndryshe ata do të kërkonin, qoftë si Qeveri e Përkohëshme, qoftë si Qeveria Bukoshi, qoftë si Parlament i Kosovës i zgjedhur në 1998 dhe që funksionoi deri në krijimin e Këshillit të Përkohshëm Administrativ, qoftë si Qeveri koalicioni PDK-LDK, që u krijua më pas. Madje ata nuk organizuan menjëherë pas lufte as zgjedhjet parlamentare, sikundër kishin vendosur dhe ishin dakorduar së bashku në Rambuje![74)]
Po ashtu, përderisa zoti Jakup Krasniqi doli e deklaroi në emër të Shtabit të Përgjithshëm për shkuarjen në Rambuje, disa orë pasi kish folur zëdhënësi i qeverisë amerikane[75)], bindesh edhe më shumë që janë këta tanët, ata që e kanë sugjeruar atë shprehje në deklaratën amerikane për *referendum*, premtim që as nuk përmendet ende pas 15 vjetësh, por përkundrazi, tash deklarohen tërë mburrje, duke e sanksionuar edhe në Kushtetutë, se janë kosovarë dhe jo shqiptarë! Madje edhe në ditët paszgjedhore të 8 Qershorit 2014 sllloganet partiake të tyre i trajtojnë si "interesa kombëtare", duke nënkuptuar "kombin kosovar"! *"Njeriu mund të zgjedhë cilëndo fé që ka trashëguar prej stërgjyshërve dhe që i pëlqen*, - na thotë erudite ynë Fan Noli,- *por s'mund të zgjedhë një tjetër kombësi dhe të luftojë të tijën, pa vënë në ballë një vulë të madhe prej "tradhëtari*"."
Prandaj, me të drejtë Demaçi dhe populli dyshonin në atë premtim, ku edhe sot shtrohet pyetja: pse me u pyet Kosova se me cilin shtet don të shkoi, kur dihet se ajo është popullsi shqiptare? Si mund të vihet në diskutim që Kosova duhet me u pyet nëse do apo jo me

---

[74)] Shih "Arkivi i Radio Kosova e Lirë", v.1, f. 387
[75)] Po aty, f. 164

qenë me Serbinë? Edhe nga këto pyetje retorike kuptohet që premtimi për referendum ishte me hile. Dhe këtë na e pohon njëri ndër këshilltarët e delegacionit kosovar në Rambuje, Marc Weller, i cili shkruan: "*Letra e sekretares amerikane për të mbajtur referendum për statusin final të Kosovës pas tre vjetësh, nuk do të kishte asnjë vlerë detyruese juridike*."[76]. Ai "premtim" ishte i ngjashëm me atë anglo-sovjeto-amerikan i Luftës së Dytë Botërore dhe i Konferencës së Bujanit, për referendumin pas mbarimit të asaj lufte. I njëjti premtim, i njëjti përfundim! Pas luftës së Dytë Botërore askush nuk i pyeti e nuk i detyroi hebrenjtë të jetonin së bashku me gjemanët në të njëjtin shtet, pse shqiptarëve në Kosovë do t'u kërkohej dhe u kërkohet një detyrim i tillë?! Çudia është se politikanët dhe qeveritarët aktualë shqiptarë, sidomos ata të dalë nga radhët e UÇK-së, nuk e kanë as kurajon civile të ish-komunistave gjakovarë e prishtinas të vitit 1968, të cilët jo vetëm në aktivet e Lidhjes Komuniste të Kosovës, por edhe në shtypin e kohës kërkuan me forcë: "*shqiptarëve t'u njihet e drejta e vetëvendosjes*"[77], kur dihet që "*Tashmë një përfundim është i qartë, Kosova multietnike për të cilën luftoi NATO-ja ka vdekur ndofta përgjithmonë*"[78], sikundër shprehet sot Pr.Dr.John G. Stoessinger.

Njëkohësishtë, ai lloj premtimi për vetëvendosje tregon se vendimin për të shkuar pa kushte në Rambuje e kanë marrë dhe deklaruar zotërinjtë H. Thaçi, Xh. Haliti, A. Syla dhe K. Veseli, që ishin de fakto edhe Drejtoria Politike edhe SHP i UÇK-së, e që ato ditë ndodheshin në Tiranë, të cilën na e vërteton Ministri i Jashtëm i saj, Pr.Dr.Paskal Milo: "*2 Shkurt 1999. Me ndihmën e Fatos Klosit, prita dy herë në zyrë tre përfaqësues të Shtabit të UÇK-së, Hashim Thaçin, Xhavit*

---

[76] Marc Weller,"The Ramboulliet Conference in Kosovo*"*.(Shih Shkëlzen Gashi "Marrëveshja për paqe të përkohëshme", Prishtinë, 2004, f. 261)

[77] Rexhep Qosja: "Ditari", v.1, Tiranë, 2014, f. 120-121

[78] Pr.Dr.John G. Stoessinger "Përse kombet shkojnë në luftë", Tiranë 2009, f. 165

Halitin (Zeka) dhe Kadri Veselin."[79)]. E themi këtë, pasi nuk disponohet as edhe një vendim i dokumentuar, i çfarëdo forumi politik a ushtarak i UÇK-së apo dhe i Lëvizjes Popullore së Kosovës (LPK), që të ketë një vendim kolegjal, ndryshe do të ishte dokumenti më i botuar prej tyre pas lufte. Kështu që zoti Jakup dhe Shtabi i Përgjithshëm, të bindur verbërisht ndaj katër zotërinjve që ndodheshin në Tiranë, nuk kishin ç'vendim të merrnin, veçse bënë magnetofonin.

Ai vendim i Drejtorisë Politike, duke pranuar kushtet në dëm të Kosovës dhe UÇK-së, tregoi edhe faktin tjetër se antarët e saj nuk ishin gjë tjetër, veçse thjeshtë disa radikalë etikë, të pleksur me mosnjohjen e strukturave shoqërore, të prirur për revolucionarizëm gojor (deklarativ), të cilët ishin të fortë falë të drejtës së fituar për të drejtuar luftën dhe UÇK-në, por kurrë revolucionarë. Në thelb, duke qenë intelektualisht të pakompletuar, doemos që do të shfaqeshin me një lloj karjerizmi të tepëruar, i cili ndodhej në raport të zhdrejtë me nivelin e kompletimit intelektual dhe të identitetit personal të tyre. Për këtë shkak, ishte frika nga rreziku për humbjen e karjerës që i drejtonte të gjitha veprimet e tjera të tyre, si në raport me veten, ashtu dhe në raport me të tjerët. Andaj është e kuptueshme pse ishin tejet të pandjeshëm për problemet që nuk i rrezikonin pozitat e tyre dhe tejet të ndjeshëm për çdo synim të kundërt. Ky kishte qenë dhe kishte mbetur i vetmi kriter i sjelljes së tyre.

Mirëpo, ai vendim i Drejtorisë Politike, për momentin ishte një futje e luftës në qorrsokak, pasi e theu në një masë të konsiderueshme dëshirën e popullit për t'u angazhuar totalisht në luftën për çlirimin e Kosovës. Dhe këtë politikë të pamenduar e shfrytëzuan me mjeshtëri Rugova dhe udhëheqja e LDK-së, me gjithë satelitët e saj, të cilët dolën "trimërisht" kundër vijimit të luftës çlirimtare si dhe kundër UÇK-së, pasi ai vendim ishte një dhuratë për ta. Kjo u duk qartë edhe në "*përbërjen e delegacionit kosovar, ku shumica përbëhej nga LDK-ja,*

[79)] Pr.Dr.Paskal Milo:"Ditari i një ministri të jashtëm", Tiranë 2009, f. 140.

ku isha edhe unë"[80], sikundër mburej më pas Rugova në Gjyqin e Hagës. Pranimi për të shkuar në Rambuje me ato kushte dhe me atë përbërje të delagacionit, tregon mosnjohjen e politikës nga antarësia që përbënte delegacionin e UÇK-së, gjë që të bind se, ata kishin paqartësi politike për drejtimin e luftës; ajo tregon se atyre u interesonte më së shumti pushteti se çdo gjë tjetër. Kjo i përplaste ata me Demaçin.

Madje, gjatë kohës që diskutohej shkuarja në Rambuje, Shtabit të Përgjithshëm, (për mos të thënë Drejtorisë Politike), i vjen në ndihmë edhe një vendim i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, duke e zevendësuar këtë të fundit përfundimisht me Drejtorinë Politike: "*Në Janar 1999 Këshilli i Përgjithshëm mori vendimin që administrimi i Fondit t'i kalojë Shtabit të Përgjithshëm*", thotë Kryetari i atëhershëm i LPK, shkrimtari Bedri Islami. Dhe antari i Kryesisë së LPK-së, Ibrahim Kelmendi i përgjigjet: "*Të dy e dinim se ai vendim ishte një si komplot ndaj Fondit…. Ky vendim erdhi menjëherë pas vendimit tonë për përqëndrimin e Fondit në zyrën që kishim ngritur, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm… Kam qenë në zyrë, në Fond, kur erdhi letra që e kishit shkruar ju, së bashku me Vendimin e Këshillit të Përgjithshëm dhe e pashë se si u ngrysën disa. Lëvizja e kish themeluar UÇK-në dhe Fondin "Vendlindja Thërret". Pse "fëmija" duhej t'u imponone tani prindërve parimet?!... Lëvizja për UÇK-në ishte parlamenti, qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes. Vetëm militaristët që mendojnë se ushtria duhet të jetë mbi të gjitha institucionet, mundohen ta "pavarësojnë" ushtrinë, që do të thotë ta vënë mbi institucionet që e kanë formuar dhe financuar*"[81].

Pse u organizua me aq urgjencë Rambujeja?

Thirrja me urgjencë e Konferencës së Rambujesë diktohej më tepër nga një llogari e menduar mirë, sesa nga zemërgjerësia. Kjo rezulton nga fakti që dihet se UÇK-ja prej 20 Dhjetorit 1998 e në vijim kish

---

[80] Shih LDK: "Dr. Rugova në Hagë", Prizëren, 2002, f. 49

[81] Bedri Islami, "Lëvizja-lindje e përgjakur", Tetovë 2012, f. 448-449

pasur disa suksese të njëpasnjëshme në luftimet me ushtrinë serbe, e cila rezultoi edhe me kapjen dhe shkëmbimin e robërve midis Ushtrisë së Serbisë dhe UÇK-së, në 13 Janar 1999. Kapja rob prej UÇK-së e 8 (tetë) ushtarëve serbë dhe shkëmbimi i tyre me 9 (nëntë) ushtarë robër të UÇK-së (të kapur më 17 Dhjetor 1998 nga Serbia), ishte një ngjarje që as shqiptarët më optimistë nuk e kishin marrë me mend që të arrinte UÇK-ja në një stad të tillë ekuilibrimi me ushtrinë e rregullt serbe. Me këto suksese UÇK-ja po e përforconte besimin ndaj saj në gjithë popullsinë e Kosovës, (edhe në atë të qyteteve). Ky sukses i UÇK-së sillte një rend tërësisht të ri të gjërave. Kurorëzimi i atyre arritjeve të saj me shkëmbimin e robërve duket se ngjalli dyshime në mendjet e shumë politikanëve europianë e serbë lidhur me fuqinë e UÇK-së, të cilët nisën të mendonin se nuk kish më asnjë pengesë për UÇK-në për arritjen e ambicjeve të saj.

Në këto kushte edhe Serbia e kuptoi plotësishtë pafuqinë e saj, ndaj dhe ajo u kërkoi ndihmë miqve të saj në Evropë. Këto arritje të UÇK-së i vunë miqtë e saj në Evropë përpara një dileme: ose Evropa duhej t'i thoshte Serbisë të largohej nga Kosova, duke e ndërprerë luftën, ngaqë qenë praktikisht të sigurtë se SHBA do të ndërhynin ushtarakisht me anë të NATO-s, ose ta nxisnin Serbinë të kryente ndonjë masakër dhe, nëpërnjet intrigave dhe propagandës panserbe ta përdornin atë për një mbledhje ndërkombëtare urgjente, ku të imponoheshin të merrnin pjesë edhe amerikanët, me të vetmin qëllim që Kosova të qëndronte përsëri pjesë e Serbisë.

Ndaj dhe u organizua kryerja e masakrës së Reçakut, të cilës mediat ndërkombëtare i dhanë shumë publicitet, (pavarësisht se disa muaj më herët serbët kishin kryer masakra edhe më të mëdha në Kosovë), dhe kjo për të eklipsuar arritjet e UÇK-së, të kurorëzuara me shkëmbimin e robërve, duke e ngritur UÇK-në në nivelin e një ushtrie guerile të rregullt. Sikundër dihet, ajo masakër u krye 40 orë pas shkëmbimit të robërve midis dy ushtrive ndërluftuese. Franca dhe mbështetësit e tjerë të Serbisë, e shfrytëzuan bukur fort këtë masakër, për ta nxjerrë Serbinë nga situata diskriminuese ku kish

rënë me shkëmbimin e robërve me UÇK-në. Masakra e Reçakut u shfrytëzua me urgjencë për të organizuar Rambujenë, ku *"Qëllimi ishte i qartë: procesi politik i zhbllokimit të situates në Kosovë të shkonte përpara atij ushtarak dhe… UÇK-ja të izolohej e t'i ngushtohej hapësira e veprimit."*[82], sikundër e pat vlerësuar edhe shkrimtari Mehmet Kraja.

Propozimi i Rambujesë nxori në pah, por jo në mënyrë të dukshme, konfliktin e përgjithshëm që ziente nën rrogoz midis BE-së dhe Amerikës. Shtetet propozuese të Rambujesë ftuan për atje edhe LDK-në, me synim që të thellohej edhe më shumë armiqësia midis asaj dhe UÇK-së dhe se, me riaktivizimin e LDK-së shpresonin që Kosova të mos i shkëputej kurrë Serbisë. Politika përça e sundo.

Në kurthin e masakrës së Reçakut, ndoshta edhe nga interest e ngushtë personalë (?), ra edhe Drejtoria Politike, duke u justifikuar se "*këtu filloi vlerësimi i luftës çlirimtare të shqiptarëve"*[83], ndërkohë që Adem Demaçi e kuptoi që ajo masakër ishte thjesht një kurth, ndaj dhe e anashkaloi, duke mos iu referuar fare, pasi nuk dëshironte të largohej vemendia nga Asamblea Kombëtare.

Mirëpo, miqtë e Serbisë e të Rusisë, për ta thelluar më tej përçarjen brenda UÇK-së, bënë të pamundurën për të sabotuar Asamblenë Qytetare (Kombëtare). Dhe ky qëllim arrihej duke organizuar urgjentisht një konferencë ndërkombëtare. Nëse ajo konferencë nuk mblidhej, por mblidhej Asambleja Qytetare e Kosovës, UÇK-ja do të arrinte të inkurajonte ndikimin e vet edhe në trojet e tjera shqiptare, dhe atëherë do të ngrihej gjithë kombi shqiptar në përkrahje dhe mbështetje të saj, me të gjitha format. "*Konflikti në Kosovë rriti frikën se ai mund të përhapej në Shqipëri, Maqedoni dhe pastaj edhe në Greqi, Bullgari e Turqi, duke e shkatërruar paqen e brishtë të arritur nga marrëveshjet e Dejtonit*."[84], theksonte analisti anglez Henry

---

[82] Mehmet Kraja "Mirupafshim në një luftë tjetër", f. 170.
[83] Jakup Krasniqi, "Kthesa e madhe", f. 131
[84] Henry H.Perritt Jr. "Rrëfim prej brenda për një kryengritje", Koha, Prishtinë, 2008, f. 194

H.Perritt Jr. Pa vepra të mëdha, lufta s'fitohet dot dhe kombi që s'është i zoti për vepra të tilla ka për të humbur në shekullin e luftës.
Madje 4 ditë më herët se Dr.P dhe ShP të merrnin vendimin për të shkuar në Rambuje, lëshuan komunikatën nr.71, datë 26 Janar 1999, ku theksohej: "*Shtabi i Përgjithshëm, në bazë të kërkesave të komandave të zonave operative, si dhe kërkesave që shtron koha, ka marrë qëndrim që deri në 10 Shkurt 1999, të bëhen konsultime me subjektet politike rreth krijimit të Asamblesë Qytetare dhe të Qeverisë së Kosovës.*"[85)]
Mirëpo, anullimi i Asamblesë prej Dr.P e SHP dhe pranimi prej tyre i dhjetë pikave të panegociueshme të asaj projekt-marrëveshjeje, duke mos u marrë parasysh pasojat e atij pranimi, të cilat i theksonte me forcë Demaçi, ishin baraz me një kapitullim, pasi, sikundër konkludon edhe diplomati i mirënjohur amerikan H. Kissinger: "*kushtet që nuk do të mbrohen përbëjnë dorëzim*". Dhe kjo ndodhte ngaqë anëtarët e Drejtorisë Politike, duke mos patur përvojën e nevojshme, si dhe të prirë nga interesa meskine, shihnin në atë projekt-marrëveshje vetëm makjazhin politik të saj, ndërsa Demaçi shikonte fytyrën e vërtetë të saj. Vetëm naivët mendojnë se politika e të fortëve udhëhiqet nga humanizmi.
Drejtoria Politike, me marrjen e kësaj përgjegjësie historike, duke u konsultuar vetëm me veten e saj, e shkëputi përfundimisht drejtimin e UÇK-së nga Lëvizja Popullore për Kosovën (LPK), pavarësisht se sot pas 15 vjetësh zoti Bedri Islami kërkon të mbuloi Diellin me shoshë, duke na thënë të kundërtën: *LPK-ja udhëhoqi edhe luftën*[86)], gjë që nuk është e vërtetë, pasi ai bie ndesh me atë çka ka shkruar vetë para tre vjetësh[87)]. "*UÇK-ja nuk ishte LPK dhe ajo asnjëherë nuk u bë krah politik i këtij formacioni*"[88)], shprehet edhe shkrimtari dhe analisti kosovar Mehmet Kraja, por që e pat vënë re edhe gjithë inteligjenca

---

[85)] Arkivi RKL, v.1, f. 122
[86)] Gazeta "Dita", Tiranë, datë 18 Prill 2014
[87)] Bedri Islami "Lëvizja-lindje e përgjakur", f. 374-378
[88)] Mehmet. Kraja "Mirupafshim në një luftë tjetër", Prishtinë, 2003, f. 163

në Kosovë. Duke u shkëputur nga LPK-ja si dhe nga LKÇK-ja, por edhe nga Demaçi, ajo Drejtori krijoi një sistem mosdhënie llogarie dhe moskontrolli të veprimtarisë së saj. Kjo ishte dhe pika më e fortë e asaj Drejtorije: vetë vendoste, vetë vuloste; "*vetë Ali, e vetë Kadi*".
Për t'ia arritur këtij qëllimi, ajo Drejtori shfrytëzoi dobësitë e udhëheqjes së LPK-së, ku difekti kryesor i saj ishte se ajo vijonte të qëndronte jashtë atdheut dhe, përveç kësaj, në vend që të merrej drejtpërdrejt me çështjet e organizmit dhe zhvillimit të luftës në Kosovë, merrej me emra të përveçëm, se kush duhet të hyjë në Kosovë, e kush jo, sikundër u veprua me Fehmi Lladrovcin e disa të tjerë[89]. Një organizëm politik e luftarak si LPK-ja, që i kishte vënë vetes detyrën e rëndësishme historike: çlirimin e Kosovës, - nuk duhej të qëndronte përgjithënjë jashtë atdheut, sido që të ishin rrethanat e luftës. Ajo duhej të futej në terren, të drejtonte në luftë, dhe të bënte gjithçka për rregullimin e gjëndjes ku puna nuk ecte, dhe jo të merrej se cili person mund të ishte më i përshtatshëm për kryetar i LPK-së, si shteg jo për forcimin e unitetit në udhëheqjen e saj, sesa me qëllimin që të mos i prishej qejfi asnjë klani ambicios. Duke qëndruar jashtë Kosove, anëtarët e udhëheqjes së LPK-së nuk do të bëheshin as luftëtarë më të mirë dhe aq më pak politikanë të mirë e të vërtetë të luftës çlirimtare.
Sikur të bazohemi vetëm në deklaratën e fundit të zotit Hashim Thaçi, se *nuk ka qenë kurrë në frontet e luftës* [90], vetëm me kaq kuptohet pse ajo Drejtori nuk ishte në gjendje të gjykonte kushtet në të cilat ndodhej UÇK-ja në periudhën e Janarit të vitit 1999; ndaj ajo Drejtori nuk ishte në gjendje të gjykonte reagimin e atyre që luftonin nëpër frontet e luftës. Edhe nëse e pranojmë se Drejtoria Politike përbënte udhëheqjen e vërtetë politike të UÇK-së, de fakto, antarët e paktë të

---

[89] Bedri Islami "Lëvizja-lindje e përgjakur", f.353-355.
[90] Më 14 Shkurt 2014, në intervistën dhënë "Global Conversation", e transmetuar në Euronews.

saj nuk mund ta njihnin gjendjen e vërtetë të saj ushtrie[91)], përveç

91) "..... Disa prej tyre, shkonin e vinin në Shqipëri e në zona të luftës, disa të tjerë i shihnim shumë rrallë, meqë ata kishin "punë të thella" dhe disa kurrë nuk pranuan të futen në Kosovë, derisa mbaroi lufta, jo mbase, sepse u frikësuan mos po i godet ndonjë plumb qorr, por sepse "kishin" aq shumë punë në Tiranë, sa nuk mund të largoheshin, as edhe për një apo dy ditë. Ç' është e vërteta, jo pak prej tyre nga Tirana shkonin e vinin pandërprerë deri në Kukës, në Bajram Curr e në pikat e kufirit, kuptohet "gjithnjë me punë", por hyrja në frontet e luftës dhe në kufirin e vdekjes, ishte e rrezikshme për ta, sepse ata mendonin për veten e tyre se po të vriteshin, do të vihej në pikëpyetje fati i luftës dhe i Atdheut.(!)Andaj, tutje kufirit mrizuan të gjithë ata që prisnin pa durim të mbaronte lufta dhe t'i qepeshin institucioneve. Atje mrizonin edhe "FARK"-istët, "mërgimtarët" e ikanakët e Tahir Zemës, oficerët "me nam" të APJ-së, apo disa të Republikës së Shqipërisë, që luanin shah e domino në zonat e kufirit, në kohën kur këndej kufirit luftohej për jetë a vdekje..... Ky lloj i këmbë-fortëve të luftës, i rrugëtarëve të rrugëve të gjata të atdheut, ky lloj i të vetë-vlerësuarve gjithnjë në lëvizje, që nuk më hiqet dot nga mendja, ky taraf special njerëzish me kohë ishte pozicionuar në kreun e luftës, në Shtab, në Operativë, në krye të shtabeve lokale të brigadave e batalioneve. Disa syresh, meqë nuk kishin punë tjetër, po i ndanin postet e ministritë, madje duke iu premtuar poste edhe shokëve të tyre, që ditët e netët i kalonin nëpër hotelet e Prishtinës dhe në shtëpitë e tyre të ngrohta e të rehatuara. Disa syresh, mrizonin në ambientet e Shtabit në Kleçkë, e në Divjakë ndërsa nga telefonat satelitorë na raportonin se ata sapo kishin krijuar zonën NN dhe po luftonin në ballë të frontit kundër forcave ushtarake e policore serbe.

Disa prej tyre, së bashku me familjet, ia kishin mbathur për në Shqipëri, meqë konsideronin se ishin "kuadro" me influencë dhe duhej doemos të kurseheshin, për ta qeverisur Kosovën pas luftës, sepse ky ishte dhe mbeti qëllimi i tyre kryesor. Disa, edhe pse nuk ishin parë kurrë në zonat e luftës, nga shokët e tyre në shtab ishin caktuar në poste me rëndësi, disa kishin lënë familjet në Kosovë, dhe sapo kishin arritur në Tiranë kishin ndarë poste ministrash e zëvendësministrash, drejtorësh e zëvendës-drejtorësh, etj. Disa nga ata konsideronin për veten e tyre se ishin të zgjedhur e të përzgjedhur, dhe nuk duhej lejuar kurrsesi që të vriteshin, nga arma armike qoftë edhe fare rastësisht, jo për tjetër, por sepse nuk kishte kush i zëvendësonte pas luftës, sepse po të vriteshin ata, vaj halli për Kosovën.....

Të tillët që qëndruan në Shqipëri, të cilët, gjatë luftës ia mbathën për ta shpëtuar prapanicën, për "meritat" e tyre, pas luftës u postuan dhe u vetë-postuan në vende të ndryshme udhëheqëse, nëpër institucione dhe sapo mbaroi lufta, u turrën drejt Prishtinës. Nuk pati forcë që ta ndalojë marshimin e tyre ngadhënjimtar në Kosovë. Ata gjetën njëri tjetrin, u riorganizuan, u pasuruan qoftë nga paratë e fondit "Vendlindja thërret", nga

Jakup Krasniqit. Kjo ishte edhe arsyeja pse zoti Jakup ishte më aktivi në bisedimet në Rambuje.

Gjersa 4 nga 5 antarët e delegacionit të UÇK-së, që u vetëpërzgjodhën për në Rambuje, nuk kishin qenë në frontet e luftës, nuk mund të pranohej nga Demaçi vendimi i tyre, pasi ata gjykonin jashtë kufijve të Kosovës, ndërkohë që drejtimi duhej bërë nga brenda, sikundër Demaçi. Madje ata nuk e njihnin edhe gjendjen politike në Prishtinë. Vetëm Demaçi i njihte të dy anët e gjendjes në Kosovë, si atë ushtarake, ashtu edhe atë politike.

Me t'u shpallur ai vendim i Drejtorisë Politike prej zëdhënësit të Shtabit të Përgjithshëm, (J. Krasniqi, njëkohësisht ai edhe antar i Dr.P), Demaçin filluan ta sulmonin të gjitha forcat politike mbarë shqiptare, të qiellit e të tokës. Edhe kjo luftë bënte pjesë në strategjinë e thirrjes me urgjencë të asaj Konference dhe thyerjen morale të Demaçit.

Ne edhe mund ta qortojmë Adem Demaçin për atë durim të tij, por ai nuk kish fuqi që ta anullonte atë vendim, pasi edhe pjesa e mbetur e Shtabit të Përgjithshëm po robërohej vullnetshëm ndaj dhunimit që i bëri Drejtoria Politike. Njëkohësishtë Demaçi e ndërpreu sulmin ndaj Dr.P, pasi u nis nga mendimi që të paqëtonte kryengritjen e UÇK-së, duke u përshtatur më shumë me rrethanat se sa me të vërtetën. Ai vendosi ta duronte me vendosmëri fatkeqësinë që po pësonte UÇK-ja dhe u vu në pritje për rastin që mund të sillte një çast më i mirë, sikundër u përpoq në 1 Mars 1999.

Antarët e SHP të UÇK-së zgjodhën të bënin rrugën e kthesës që mori Drejtoria Politike, edhe pse fuqia e saj nuk kish pse t'i frikësonte.

"Fondi i 3-përqindëshit", qoftë nga "haraçi" apo trafiqet, qoftë nga pasuria që kishin trashëguar ku di nga ku e nga kush. Ata nuk e krijuan "lobin"për ta ndërtuar Kosovën, por "Lozhën e masonëve" për ta qeverisur atë, për ta zhvatur dhe për ta katandisur ashtu sikur e kanë katandisur"., analizon Ahmet Qeriqi, shkrimtar, analist, përkthyes, ish i përndjekur politik, drejor i Radio Kosova e Lirë gajtë dhe pas lufte; 23.10.2013: "Ikanakët gjatë luftës, matrapaqzë e profiterë pas lufte*", (www.radiokosovaelire.com, 23.10.2013)*

Shtabi u tut nga ajo Drejtori edhe pse ajo nuk kishte asnjë lloj force për t'i frikësuar ata. Por, e tillë qënka dobësia e shoqërisë sonë njerëzore: e shtrënguar që të bindet ngaqë është e përçarë mes veti. Si e tillë, nuk gabojmë të themi se, ndër ne, asnjëherë nuk mundet me qënë masa më e fortë se individi apo një grupi njerëzish, edhe pse ai individ apo ai grup njerëzish nuk kanë asnjë lloj mjeti dhune për të na nënshtruar.

Mirëpo, kur dhe si i dha kjo Drejtori Politike provat e përsëritura se ishte e pajisur me largpamësi të madhe, që të imponohej e t'i zihej kaq besë nga SHP dhe tërë UÇK-ja? Ku i dha ajo Drejtori provat e guximit të madh intelektual e qytetar për mbrojtjen e UÇK-së, apo mos vallë kur kryesori i saj, zoti Xhavit Haliti, shtatë muaj më herët pat deklaruar botërisht se UÇK-ja nuk mundet me e fitue luftën? Si dhe kur e fitoi Drejtoria Politike atë lloj epërsie intelektuale, morale dhe guximi ndaj SHP dhe tërë UÇK-së, apo kur përcaktoi strategjinë e luftës mbrojtëse frontale dhe atë të mbrojtjes së "territoreve të lira"? Si dhe kur e fitoi Drejtoria Politike atë lloj epërsie politike e intelektuale dhe largpamëse ndaj simbolit të rezistencës sonë, Adem Demaçit? Nuk e marr guximin të them se në këtë rast Shtabi i Përgjithshëm ka vepruar me urtësi.

Por, ja që ka edhe nga ata persona që kanë më shumë dhunti se të tjerët, që e ndjejnë peshën e zgjedhës, që nuk mësohen dot me robërinë e paraardhësve të tyre. Një i tillë mëndjekthjellët e largpamës ishte Adem Demaçi, si dhe ajo pjesë e popullsisë që rrëmbeu armët dhe mbushi radhët e UÇK-së, duke mos e dëgjuar më LDK-në pacifiste 800 mijë anëtarëshe (!), e cila e mallkonte luftën çlirimtare. Ndaj dhe nuk duhet të habitemi pse në këtë kryengritje, në luftën çlirimtare të viteve 1997-1999, vetëm 1% e popullsisë rrëmbeu armët, ndryshe nga çdo kryengritje tjetër e këtij populli, ku gjithherë pjesmarrja më e ulët me armë në dorë ka qenë mbi 5% e popullsisë. Por, duke qenë se 82% e UÇK-së ishin me arsim të mesëm e të lartë, bindemi se ata ishin ajo pjesë e popullit shqiptar në Kosovë që e kish ushtruar veten me mësime dhe dije për mënyrën e fitimit të

lirisë dhe rëndësinë e saj, sado që robëria e LDK-së së Rugovës ishte stolisur e maskuar mirë. Ky 82 përqindëshi i mirëarsimuar i UÇK-së tregon forcën e edukimit, e cila e mohon zakonin tradicional të nështrimit. Jo më kot Serbia dhe LDK-ja ua mbyllën shkollat shqiptarëve e i futën nëpër bodrume, atë që kërkonte dikur shpesh e me ngulm nëpër kongreset e LKJ akademiku Dobrica Qosiç[92)].

Kur antarët e delegacionit të UÇK-së u nisën për në Francë, Demaçit nuk i mbeti rrugë tjetër veç të bënte sqarimin politik të popullit me anë të shtypit, rreth vendimit të Dr.P e SHP, duke bërë dallimin midis asaj që ishte e regullt dhe jo e regullt, duke shprehur pikëpamjet e tij mbi rezultatet e pritshme të Konferencës së Rambujesë, me bindjen se argumentat e tij do t'i detyronin delegatët e UÇK-së të ndryshonin qëndrimin.

Shpesh herë është hedhur pyetja: pse u vendos mos ekzistenca e mëtejshme e UÇK-së para se të fillonte mbledhja e Rambujesë?

Përgjigjia është shumë e thjeshtë: sepse UÇK-ja nuk ishte aleate me askënd; ngaqë e kishin anatemuar jo vetem të hujat por edhe vetë shqiptarët dhe, së treti, qarqet sunduese serbe dhe ato LDK-iste në Prishtinë përhapnin pikpamjen e gënjeshtërt se gjoja UÇK-ja ishte organizatë marksiste terroriste, e shprehur kjo edhe nga ministri i jashtëm i Italisë, Lamberto Dini, dhënë agjensisë ANSA në 15 Janar 1999[93)], etj. E gjithë kjo propagandë anti UÇK edhe prej forcave politike dhe shtypit shqip, bëhej për të mashtruar jo vetëm opinionin publik mbarë shqiptar, por edhe atë botëror. Prandaj UÇK-në nuk pranonin ta njihnin si ushtri çlirimtare as gazetarët, as diplomatët, as pushtetarët dhe as politikanët e Tiranës dhe të Prishtinës. Si rrjedhojë, ajo askujt nuk i jepte shkas për mëshirë ose keqardhje, përderisa eleminimi i saj nuk i sillte dëm personal askujt prej tyre, veç popullit të thjeshtë, luftëtarëve të UÇK-së, Kosovës dhe vetë

---

92) Rexhep Qosja: "Ditari", v.1, Tiranë 2014, f. 110

93) Fehmi Baftiu, vepër e cituar, f. 295

emërtimit UÇK. Propaganda kundër UÇK-së ishte aq e madhe sa që në një pjesë të konsiderueshme të popullit shqiptar në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe në shumicën e diplomatëve shqiptarë e të huaj, kur flitej për UÇK-në kish diçka që i bënte ata të kishin mendime të gabuara për të. Dhe, për të qenë realistë, duhet të pranojmë se njoftimet që kishin diplomatët e huaj rreth UÇK-së mbështeteshin kryesishtë në ato që thoshte propaganda dhe shtypi i LDK-së e ai "i pavarur" i Prishtinës, ("Koha Ditore", "Kosova sot", etj.), i cili në verën e vitit 1999 i quajti fashistë shqiptarët që luftuan; por edhe në shkrimet e gazetave "RD", "Rilindja", "Tema" dhe satelitët e tyre në Tiranë.

Për këto dhe të tjerë "argumeta" të ngjashëm, diplomacia europiane dhe ajo e Rusisë kishin vendosur t'i jepnin fund luftës që bënte UÇK-ja në Kosovë. Si rjedhojë, askush prej atyre që ishin mbledhur në Kështjellën e Rambujesë nuk donte t'i dëgjonte emërin UÇK-së dhe luftës që ajo bënte, përjashtuar zonjën Medlin Ollbrajt, të cilën na e tregon vetë Komandanti i NATO-s, Uesli Klark: "*Medlin Ollbrajt, e cila gjat një takimi në katër sy, duke ngrënë mëngjes, pak më shumë se katër javë para fillimit të luftës, më tha: "Pra, Ues, e tëra varet nga ti", tha ajo, në momentin kur u ul. "Kam bërë çdo gjë që ishte e mundur, por ata e kanë cilësuar këtë si luftën time dhe janë kthyer kundër meje. Tash ata do të kthehen në drejtimin tënd!". Nuk dëshiroja të pyesja se kush ishin "ata"; kjo ishte gjë tejet e dhimbshme*."[94)] Kjo vërteton atë që zonja Ollbrajt e përkrahu Kosovën dhe UÇK-në për

---

[94)] Uesli Klark: "Të bësh luftë modern", f. 295. Shtojmë se, ajo çka thotë zonja Ollbrajt për gjithë Departamentin e Shtetit, (përjashtuar atë dhe z.Klinton), vërtetohet edhe pas 15 vjetësh nga ish zevendësi i saj, prej 1993-2001, Strobe Talbott, i cili në 22 Mars 2014 ka botuar një shkrim tek gazeta "Ëashington Post ", (ndërsa tek "Evropa e lirë" u botua më 24. 3. 2014), ku gjat komentimit të analogjisë së Putinit mes Krimesë dhe Kosovës, ai shprehet se, "për serbët Kosova është tokë e shenjtë, e krijuar nga gjaku i paraardhësve të tyre, që kishin pësuar disfatë nga invaduesit otomanë, derisa pasardhësit e tyre myslimanë, që flasin sot shqip, përbëjnë shumicën në Kosovën moderne".

shkak të vullnetit të saj të lirë dhe jo për shkak të ndonjë trysnie. Për të tjerët ishte e pamundur t'i kuptonin si ajo vuajtjet dhe psikologjinë e popullit shqiptar në Kosovë e të luftëtarëve të UÇK-së, e cila i kish parë me sy krimet serbe disa vite më herët në Bosnjë. Dhe kjo epërsi e zonjës Ollbrajt ndaj gjithë diplomatëve të tjerë qëndronte edhe për faktin se ajo, para së gjithash, ishte nënë dhe dihet që, zemrat e nënave kur shohin krime lotojnë e qajnë dhe veç dritë ato shpërndajnë.

Pse Adem Demaçi nuk pranonte që në bisedime, nuk duhej të merrnin pjesë as Rugova, as Qeveria Bukoshi dhe as satelitët e tyre?

Demaçi e kundërshtonte pjesëmarrjen e Rugovës dhe udhëheqjen e LDK-së në konferencën ndërkombëtare, jo se ata nuk ishin për pavarësinë e Kosovës, por, edhe pse ishin sjellë si zot për gati një dekadë në Kosovë, ishin përgjegjës që nuk kishin ndryshuar asgjë. Kjo ishte një nga arsyet që ata nuk e shikonin me sy të mirë UÇK-në, dhe dashur pa dashur ishin bërë pengesë serioze për luftën çlirimtare të popullit. "*Rugova për një kohë të gjatë e kishte mohuar ekzistencën e UÇK-së dhe bota i kishte besuar atij*"[95], pohonte analisti angles H. Perrit. Duke qenë "*kryesori i shqiptarëve të moderuar dhe rival i kryengritësve*"[96], Rugova e pat kundërshtuar publikisht luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës, edhe pse "*është gjë e rallë që një komb i shtypur nga diktatura të gjejë mënyrën të çlirohet pa një luftë*", sikundër shprehej i vetmi personalitet i madh i Evropës Prëndimore të pasluftës, nobelisti Vili Brand. Madje është Rugova ai që në konferencën për shtyp, në 10 Prill 1998, pasi u shpall rezultati i zgjedhjeve të paimagjinuara në kushte lufte, bëri

---

[95] Henry H. Perrit Jr. "Rrëfim prej brenda për një kryengritje", Koha, Prishtinë, 2008, 193

[96] Associated Press: "As Fighting Eurupts in Serbia, U.S. Envoy Presses the Rebels", 28 Janar 1999

deklaratën më të hapur dhe më fyese të tij kundër luftës së armatosur për liri dhe për mohimin e UÇK-së: "*Në Kosovë kemi shtetin e ndërtuar. Edhe zgjedhjet presidenciale e parlamentare janë kryer. Këto janë baza e shtetit, i cili doli nga zgjedhjet e Marsit të këtij viti. Mbi këto zgjedhje së shpejti do ndërtohet edhe qeveria*"[97)].

Mirëpo dihet që zgjedhjet elektorale të Marsit 1998 ishin një gënjeshtër dhe se parlamenti i dalë nga ato zgjedhje nuk kishte asnjë vlerë, nga shkaku jo vetëm i gjëndjes së luftës, ku në disa krahina nuk u zhvilluan as votime, por edhe i korrupsionit në kohën e zgjedhjeve dhe në të gjithë aparatin administrativ të LDK, mbajtur në kushtet e një nënshtrimi absolut nga aparati shtypës shtetëror serb.

Demaçi nuk e akuzonte LDK-në për tradhëti, por rruga që ata ndiqnin kundër luftës çlirimtare ishte e rrezikshme për Kosovën. Përçarja, në çdo periudhë të historisë sonë, ka qenë rreziku më i madh i shqiptarve. Të përpiqesh të dobësosh bashkimin e popullit në kulmin e luftës për çlirim, për Demaçin dhe cilindo shqiptar me dy paré mend në kokë, vetëm punë patriotike nuk mund të quhet.

Një nga të këqijat më të mëdha të LDK-së, për të justifikuar qëndrimin e saj anti-UÇK, ajo nisej nga kushte paraprake të rreme ndaj saj. Ajo thoshte se UÇK-ja frymëzohej nga mësimet e Enver Hoxhës, se gjoja luftonte për revolucion shoqëror dhe kjo ka ndodhur, theksonte Rugova, me ardhjen në pushtet të Partisë Socialiste, në Tiranë, duke ia thënë këto edhe Presidentit Klinton në 28 Maj 1998[98)], kur ishte i ftuar në zyrën ovale të tij. Kjo ishte teza kryesore e LDK-së dhe e Rogovës.

Edhe në 25 Mars 1998, 20 ditë pas luftës së Jasharajve në Prekaz, kur në Kongresin Amerikan mbahej dëshmia për Kosovën nga

---

[97)] Gazeta "Rilindja", 11 Prill 1998

[98)] Shpetim Golemi "Romantika e Luftes së UÇK", Tirane-Prishtinë, 2012, f. 47

diplomati Robert Gelbard, bëhet e njëjta deklaratë kundër UÇK-së nga Kryeministri në ekzil i Kosovës, i dalë nga LDK, Bujar Bukoshi, ndërkohë që 25 mijë shqiptarë të Amerikës brohorisnin "UÇK, UÇK!", para Kapitolit, (100 metra larg vendit ku bëhej kjo dëshmi). "*Në pauzën e asaj dëshmije, në një nga sallat e Kongresit, Xho Guardi e takoi Robert Gelbardin me Bujar Bukoshin dhe Alush Gashin (kryetar i LDK në SHBA). Pyetja e parë e Gelbardit drejtuar Bukoshit ishte:* "*Çka mendon për UÇK-në?" Dhe Bukoshi, pa pikë ngurimi u përgjegj: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës është një grupacion i njerëzve të frustuar, fshatarëve injorantë, të manipuluar nga fundërinat e marksizëm-leninizmit dhe të sigurimit të Enver Hoxhës, të cilët me veprimet e tyre terroriste provokojnë policinë serbe*." **"99)**; kurse para tubuesve shqiptarë pat bërë hipokritin, duke thënë: "*të gjithë shqiptarët janë UÇK*", sikundër dëshmon një nga organizatorët e atij tubimi, dëshmitari okular Naim Balidemaj. Ja pra që zoti Demaçi kishte të drejtë të mos u besonte këtyre njerëzve me njëzet flamurë në xhep.

Edhe "*Në Kuvendin e Serbisë, nëse ju kujtohet ajo kohë, është cituar edhe Rugova",* - tregon një nga figurat drejtuese të formacioneve të UÇK-së në zonën e Junikut, Naim Maloku.- *"Është thënë kështu: "Edhe Rugova po thotë se nuk ka Ushtri Çlirimtare të Kosovës*".**100)**" Historia ka treguar se sa herë të privilegjuarit kanë parë se kombi ka cënuar privilegjet e tyre, ata kanë marrë anën e këtyre privilegjeve dhe janë hedhur kundër tij.

Por nuk mund ta akuzoje UÇK-në për revolucion shoqëror, pasi edhe parulla politike kryesore e saj ishte: "*Luftojmë për shtet dhe jo për pushtet*"**101)**; ajo luftë nuk mund të trajtohej si revolucion shoqëror pasi në programin e saj politik nuk pretendohej kalimi nga një mënyrë qeverisëse në një tjetër mënyrë, pavarësisht se në pushtetin e

---

99) Naim Balidemaj "Tragjedia kosovare", Prishtinë, 2001, f. 184-185

100) Naim Maloku:"Dëshmi për rrugën e lirisë", Prishtinë, 2000, f. 116

101) Dilaver Goxhaj: Gazeta "Rilindja", Tiranë, 28 Korrik 1998, si dhe "Rruga që më çoi në radhët e UÇK", Tiranë, 2000, f. 55

Rugovës ishin njerëzit e së kaluarës; nuk propagandohej përmbysja e marrëdhënieve ekzistuese të pronësisë apo cënimi i interesave të kësaj apo asaj pjese të popullsisë; si dhe nuk pati aspak faza tiranike ndaj asnjë lloj pjese të popullsisë. Të gjitha këto i dhanë asaj thjeshtë tiparet e një lufte çlirimtare, që pretendonte vetëm largimin e pushtuesit dhe lirinë e popullit.

Mirëpo, akuzat që LDK-ja i bënte UÇK-së se gjoja udhëhiqej nga ideologji majtiste kishin për qëllim jo vetëm që ta nënçmonte atë dhe luftën e saj, por gjithë popullin shqiptar në Kosovë, pasi bijtë e atij populli ishin ata që mbushnin radhët e UÇK-së, si një forcë që kish për qëllim të çlironte Kosovën nga pushtuesi serb.

Përderisa Serbia me policinë dhe ushtrinë e saj e urrente dhe e sulmonte UÇK-në, si e vetmia forcë reale që i qendronte përballë Serbisë, LDK-së nuk i falej të fliste me të njëjtën gjuhë si Serbia, kundër UÇK-së. Atëherë, në mullirin e kujt shkonte uji i saj?

Mirëpo tezës së LDK-së, se UÇK-ja bënte revolucion komunist, kishin dëshirë dhe i besonin shumë prej ndërkombëtarëve, ndaj dhe në atë projekt-marrëveshje e theksuan kërkesën e Rugovës dhe të Millosheviçit që të çarmatosej UÇK-ja, se ndryshe "përmbyste LDK-në", aleaten e pushtuesit dhe të çdo ndikimi të huaj; ndërkohë që në atë projekt-marrëveshje nuk ngulej këmbë për largimin total të forcave ushtarake të Serbisë nga Kosova, dhe kjo pikërisht për ta "shpëtuar" Kosovën që mos t'i bashkangjitej Shqipërisë. Të gjithë jemi dëshmitarë që Rugova nuk donte t'i dëgjonte as emërin Shqipërisë. Dhe rasti më i dukshëm ishte ai kur ai u kthye nga Rambujeja, ku nuk pranonte as të zbriste në tokën shqiptare, ku e priste te shkallët e avjonit edhe Presidenti i Shqipërisë, por qëndronte në avjon me ambasadorin frances[102)](!) E si mund të pranonte Demaçi që këta mosprishës rehati të Serbisë të bëheshin avokatë të Kosovës dhe UÇK-së?!

Shumë prej ndërkombëtarëve e donin Rugovën dhe Bukoshin të ishin

---

[102)] Pr.Dr Paskal Milo "Ditari i një ministri të jashtëm", f. 180

prezentë në Rambuje sepse këta të dy ishin miq të bindur të tyre, të cilët nuk u hapnin asnjë problem për çështjen shqiptare në Ballkan, sidomos për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Rugova, Bukoshi, shumica e kryesisë së LDK-së, por edhe shumica e ndërkombëtarëve nuk donin aspak ta njihnin UÇK-në, megjithse, ç'është e vërteta, nuk dinin asgjë për të. Ata nuk kishin bërë gjë tjetër veçse i kishin shpallur luftëtarët e saj si rebelë e separatistë të rrezikshëm dhe ishin mjaftuar me kaq. Nëse Evropa, LDK-ja dhe vetë Rugova do të interesoheshin me të vërtetë për UÇK-në, pse nuk shkuan të kontaktonin me të në terren, sikundër shkuan Amerikanët? Anëtarët e kryesisë së LDK-së dhe vetë Rugovën kush i pengonte të shkonin në terren? Nëse Rugova kish frikë të shkonte në male, pse nuk e thirri një ditë në zyrën e tij Përfaqësuesin Politik të UÇK-së, Demaçin, i cili edhe konferencat e tij të shtypit i jepte në godinën ku kish zyrat LDK-ja, atje ku i jepte edhe Rugova?!

Që të zhdukej ai mosbesim ndaj UÇK-së, pse ndërkombëtarët nuk organizuan një takim me të gjithë antarët e SHP, por bënin veç takime të fshehta me dy antarë të Drejtorisë Politike dhe kurrë të paktën me gjithë përbërjen e asaj Drejtorie? Pse nuk takoheshin qoftë edhe në Zvicër apo Gjermani me kryesinë e LPK-së, që kish inicuar dhe financuar UÇK-në, ndërkohë që kishin tre javë që debati bëhej publik? Apo këto gjëra nuk i dinin? Prandaj bindemi se organizimi i Rambujesë dhe thirrja në të e LDK-së ishte një dredhi për të arritur qëllimim e shuarjes së UÇK-së.

Mos shkuarja në terren e diplomatëve evropianë, që vepronin në Prishtinë, dhe e Rugovës për kontakt me SHP të UÇK-së tregon se nuk donin ta njhnin atë. LDK-ja nuk pranoi të merrte pjesë dhe nuk u interesua aspak edhe në ceremoninë më fatlume të UÇK-së, gjatë shkëmbimit të robërve midis dy ushtrive ndërluftuese, në 13 Janar 1999! Qëndrimi pasiv i LDK-së në këtë rast, ishte thjeshtë një neutralitet armiqësor ndaj UÇK-së. LDK-ja, nëse do të shkonte në terren për të kontaktuar me udhëheqjen e UÇK-së, ose të paktën në momentin e shkëmbimit të robërve, do të tregonte së paku shfaqjen e

dëshirës për bashkpunim me UÇK-në, gjë që tregoi se nuk e dëshironte një gjë të tillë.

"*Partitë e tjera e kanë shfrytëzuar rastin mirë, kurse administratorëve të huaj kjo u ka konvenuar. Edhe pse nuk kanë pasur ithtarë të shumtë afër vetes, mendoj për të dy partitë, LDK, LBD, që kanë qenë pjestare të delegacionit në Rambuje, ato e kanë shfrytëzuar rastin dhe kanë shfaqur mospajtueshmëri me politikën e luftës dhe këta janë ata gjeneratorët kryesorë që nuk kanë lejuar të shfrytëzohet ky mekanizëm. Kujtoj që këta janë përgjegjës dhe fajtorë për gjendjen e krijuar.*"[103], mbështet qëndrimin e Demaçit komandanti i zonës së pestë operative, Rrustem Mustafa.

Atëherë, me ç'të drejtë LDK-ja duhej të përfaqësohej në Rambuje? Mirë, u bë si u bë dhe u përfaqësua, por me ç'të drejtë me një numër edhe më të madh delegatësh se UÇK-ja? Ato dy forca, UÇK-ja dhe LDK-ja, ndoshta ishin me të vërtetë me ndikim të barabartë në opinionin kosovar, por me veprimtari dhe qëndrime ishin diametralisht të kundërta. Si të tilla, o njëra, o tjetra duhej të shkonte në Rambuje. Futja e LDK-së dhe e të "pavarurve" në përbërje të delegacionit, të cilët nuk kishin hedhur qoftë edhe një fjalë të vetme në përkrahje të UÇK-së dhe luftës që ajo po bënte, e jo më një pushkë, u bë me qëllim që edhe nëse do të ishte shumica me UÇK-në, të paktën në konferencë të ekuilibrohej ajo. Kjo taktikë u përdor edhe për kryesinë e delegacionit: 2 me 2; Rugova + Surroi : Thaçi + Qosja. Dhe kjo bëhej ngaqë shumica europiane ishte e sigurtë se LDK-ja do të përkrahte çdo propozim të tyre, gjë që do t'ua lehtësonte nënshkrimin e marrëveshjes, sikundër edhe ua lehtësoi. Faktikisht, sikundër edhe e pamë, LDK-ja dhe të "pavarurit" ishin ortakët e tyre. Dhe këtë gjë Adem Demaçi e kish më se të qartë, prandaj dhe nuk ishte dakort që LDK-ja të ishte pjesë e atij delegacioni.

Mirëpo, pranimi i atyre kushteve nga SHP ishte rënie në kurthin e LDK-së, i ngritur nga francezët dhe europianët e tjerë, me qëllim që

---

[103] Safet Zejnullahu "Lufta për Kosovën", Prishtinë, 2000, f. 120

të ringrihej LDK-ja nga gremina ku kishte rënë, duke qenë se vetëm tek ajo ata kishin besim. Dhe SHP e kreu këtë mision të tyre(!!!) Kjo ishte një nga ato momentet e papritura dhe fyese që ata bënë ndaj UÇK-së dhe Adem Demaçit, në të cilën mori pjesë edhe SHP dhe që i vështirësoi aq shumë marrëdhëniet me Demaçin. Me atë veprim të tyre, antarët e SHP e trajtuan Demaçin për budalla; po a nuk u tregua Demaçi shumë herë më i mënçur se të gjithë ata së bashku? E keqja ishte se në Dr.P dhe në SHP ka patur njerëz të interesit, kështu që është e vështirë të merret vesh se pikërisht cilat forca brenda tyre e luftuan UÇK-në dhe Adem Demaçin. Ndoshta në këtë dakordim të SHP mund të kenë vepruar edhe forca jashtë UÇK-së. Lufta, ndonse jo të gjithve, disave u hyn në punë.

E megjithatë, edhe pse pati shumë presione, Demaçi nuk e pranoi as përbërjen e delegacionit dhe as përmbajtjen e projekt-marrëveshjes, edhe pse ajo ishte hartuar sipas të gjitha rregullave ndërkombëtare. Demaçi e argumentoi atë qëndrim me faktin e të qenit të Kosovës e okupuar nga Serbia, gjë që nuk i jepte as diplomatëve të përfshirë në ato ngjarje dhe as G-8 të drejtën t'i impononin vullnetin e tyre popullit shqiptar në Kosovë e në mënyrë të veçantë ushtrisë së tij çlirimtare, si për kushtet e propozuara, ashtu dhe për përbërjen e delegacionit. Demaçi i kundërshtoi, duke thënë se me këtë lloj delegacioni nuk mund të arriheshin përfundime konkrete. Dhe ashtu ndodhi.

Qëndrimin e tij kundërshtues ndaj Rugovës, Demaçi ua pat shprehur amerikanëve shumë më herët, madje në zyrën e tyre, në Prishtinë, qysh në 4 Korrik 1998: "*Rugova duhet të tërhiqet plotësisht nëse duam të bëjmë punë… Këtu ka hile pse insistohet që ai të mbetet*".[104)]; ua tha atëherë kur qenë bërë publike shpifjet e Rugovës për UÇK-në thënë në zyrën e Presidentit Klinton, një muaj më herët.

Duke mos e pranuar LDK-në në bisedime, Demaçi nuk mendonte për pushtet të vetin, por për shkëputjen e plotë të Kosovës nga Serbia,

---

[104)] Blerim Shala: "Vitet e Kosovës", Prishtinë 2000, f.106

mosçarmatosjen e UÇK-së, realizimin e vetëvendosjes së Kosovës dhe shmangien e LDK-së nga pushteti i ardhëshëm, të cilën e konsideronte si forcë politike e dëmshme për Kosovën. Një qeveri e përbashkët e UÇK-së me LDK-në, sikundër edhe u propozua në Rambuje (dhe u bë realitet pas zgjedhjeve të vitit 2001), e cila për Demaçin ishte më shumë se një gjethe fiku në rrugën e ardhjes në pushtet të udhëheqësve politikë të UÇK-së, për Adem Demaçin nuk ishte gjë tjetër veçse përjetësimi i Rugovës dhe i politikës së tij pa bosht kombëtar. Çështja e vërtetë që shtrohej para Adem Demaçit nuk ishte zgjedhja midis arritjes së fitores dhe kompromisit, por midis fitores dhe disfatës për UÇK-në; gjë që ishte edhe për Kosovën.

Adem Demaçi këmbëngulte në mospranimin e LDK-së dhe të Rugovës në përbërje të delegacionit për bisedime, edhe për faktin se pacifistët e kishin humbur shansin e tyre për këtë gjë, sepse nuk kishin ngritur as gishtin kundër pushtuesve serbë, duke e ruajtur veten vetëm për të vepruar kur të çlirohej Kosova dhe atëherë për të sulmuar UÇK-në, sikundër deklaroi publikisht Rugova, kur ishte në Romë, në Gusht të vitit 1999, duke thenë: "*Nuk kthehem në Kosovë pa u çarmatosur edhe ushtari i fundit i UÇK-së*." Gjë që vërtetoi se për Rugovën populli i armatosur ishte më i frikshëm se pushtuesi serb.

Dhe ky konstatim i Demaçit u vërtetua edhe ditët e para të pas luftës, ku shtypi i LDK-së dhe ai i "pavarur" e akuzuan UÇK-në si ushtri fashiste dhe se gjoja ka bërë spastrim etnik, mbi bazën e të cilave justifikohet sot ngritja e një Tribunali në Kosovë[105], gjë që u pa edhe

---

[105] "Pas mos-përkrahjes së Ligjit për veteranët e UÇK-së, LDK ka 'befasuar' me përkrahjen e saj për Tribunalin. Anëtari i Kryesisë së LDK-së dhe kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri ka thënë se kjo parti përkrah idenë që ky Tribunal të jetë në Kosovë. Ai madje ka thënë se ky Tribunal i mundëson Kosovës 'perspektivë evropiane' (sic!)". (www.*radiokosovaelire.com, 28 Mars 2014)*

në mospranimin e miratimit prej tyre të Ligjit për Veteranët e UÇK-së, më 27 Mars 2014. Kjo tregon se LDK-ja dhe satelitët e saj kanë patur më të shtrenjtë pasurinë dhe privilegjet e tyre[106)] se sa largimin e Serbisë pushtuese nga Kosova dhe kurrësesi vetvendosjen e Kosovës, të cilën, së bashku me Drejtorinë Politike, (udhëheqja kryesore e sotme e PDK-së), e kanë sanksionuar edhe në Kushtetutë. LDK-ja dhe satelitët e saj kanë qenë e janë nacionalistë, por janë nacionalistë të pasurisë dhe jo të Kosovës. Ata e kanë dashur dhe e duan Kosovën, shprehet Demaçi, por si çiflik të tyre dhe jo si Atdhe, ndryshe do të sakrifikonin për atë.

Gjithkush që mbaron së lexuari këta argumenta, që tregojnë se pse Demaçi nuk pranonte që LDK-ja të merrte pjesë në bisedimet ndërkombëtare së bashku me UÇK-në, ka të drejtën të shtrojë pyetjen: Kur Demaçi kish këto arsye kundërshtuese ndaj LDK-së, pse ai pranonte që LDK-ja të ishte pjesë e Asamblesë Qytetare nga e cila do të delte edhe Qeveria e Koalicionit Kombëtar ku, pa dyshim do të merrte pjesë edhe LDK-ja? Kur flasim për kompromis historik midis

---

[106)]Ja se si e përshkruan këtë fakt, kryetari i Shoqatës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, z.Behxhet Shala: "Qytetarët" e pispillosur janë "aristokracia" e formuar pas heqjes së autonomisë së vitit 1989 edhe "aristokracia" e formuar pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Këto "aristokraci" shquhen apo identifikohen me vetura të kushtueshme, truproja prej banditësh të cilët pastaj edhe vet u bënë "aristokratë", të dashura të mbuluara me para dhe flori por të zhveshura nga rrobat dhe morali, frekuentim të lokaleve dhe restoranteve që nuk ua dinin as kuptimin e emrit, mësimin e gjeografisë duke shetitur shtete që nuk ua kishin dëgjuar kurrë emrat, stolisje me tituj akademikë dhe shkencorë duke mos hyrë asnjëherë në këto institucione, pushimet verore në Antali, Rodos, Florida, Ibica, San Tropez etj., ndërsa ato dimërore në Sent Moric, Insbruk, Garmish Parterkirhen etj., çmime ndërkombëtare për fleksibilitet politik, mirënjohje ndërkombëtare për oratori orale dhe shërbime anale, takime në korridore me mogulët vendimmarrës botërorë si infuzion për ringjallje dhe mbijetesë politike, fotografi ma krerë të Vatikanit dhe ajatollahë të Iranit,...". (*Shih: www.Pashtriku.org, 28. 02. 2014)*

UÇK-së dhe LDK-së pacifiste, në kohë lufte, nuk do të thotë se në qendër të atij koalicioni udhëheqës të luftës do të qenë udhëheqësit pacifistë të LDK-së, por do të ishin ata drejtues politikë të saj që ishin për fitoren e lirisë përmes luftës së armatosur dhe që i ishin bashkuar asaj lufte, si p.sh. Sokol Dobruna[107)] me shokë. Së dyti, prania e LDK-së si forcë e përgjithshme në atë grupim qeverisës për drejtimin e luftës, do të thoshte që ajo të hynte në atë grupim ku, me forcën e përgjithshme që do të kishin, do të vlerësoheshin bashkëpërgjegjës për vendimet që do të merreshin; ata do të ishin pjesë e asaj qeverie, për hir të unitetit kombëtar, por jo si elementë përcaktues, por si elementë kontribues. Ky lloj kontributi do t'u jepte të nesërmen të drejtën që të ishin pjestarë të barabartë në bisedime apo në qeverinë e pasluftës.

Mirëpo, pranimi vullnetarisht i çarmatosjes së UÇK-së nga ana e Drejtorisë Politike, u vinte në takim ndërkombëtarëve nismëtarë të Rambujesë, të cilët kishin si objektiv vetëm përfundimin e luftës, ngaqë e shihnin UÇK-në si një pengesë për paqen dhe jo si një aleate. Ndaj dhe donin ta çarmatosnin atë.

Dallimi në këtë pikë midis Drejtorisë Politike dhe Adem Demaçit ishte, se Dr.P nuk donte ta kuptonte këtë realitet, por që kuptohej shumë qartë nga vetë Rugova, LDK-ja dhe satelitët e saj. Por, duke qenë se Dr.P i pranoi parakushtet e marrëveshjes që do të nënshkruanin në Rambuje, Demaçi e kuptoi se fati i së ardhmes së Kosovës nuk do të vendosej nga lufta që pat bërë e do të bënte UÇK-ja, por në tavolinën e bisedimeve, ku vendimmarrëse do të ishte edhe pala tjetër shqiptare që ishte kundër UÇK-së, përjashtuar LBD-në e Rexhep Qoses.

Bazuar në sa më sipër, Demaçi ishte i bindur se në të tilla bisedime vetëm UÇK-së i takonte të përfaqësonte Kosovën, pasi ishte e vetmia dalëzote ushtarake dhe politike e saj. Por që të arrihej me siguri të

[107)] Sokol Dobruna, Kryetari i LDK për Gjakovën, luftëtar, drejtori i Drejtorisë Juridike i SHP të UÇK.

plotë kjo pozitë për UÇK-në, Demaçi mendonte se ajo duhej të shpërthente në sulme masive të vijueshme me grupe të vogla në të gjithë territorin e Kosovës, kundër çdo objektivi ushtarako-policor të Serbisë në Kosovë, për ta kapur Serbinë në befasi të plotë dhe të mos i lihej asaj inisiativa e sulmeve për të zënë në befasi UÇK-në, sikundër e zuri në Reçak e në Rogovë gjatë muajit Janar 1999.

Vullnetarizmi i antarëve të Dr.P të SHP të UÇK-së, duke pranuar eleminimin e UÇK-së, pa pyetur asnjë strukturë të saj, (sepse edhe shefat kryesorë të Shtabit të Përgjithshëm ishin vetë ata), për Demaçin mëshironte dështimin ideologjik të njerëzve që nuk kuptojnë thelbin e luftës çlirimtare dhe më në fund bëhen padashur rrezik për të ardhmen demokratike të Kosovës, të cilët shprehen në mënyrë hipokrite si patriotë të ndershëm. Me atë vullnetarizëm personal ata sabotuan Asamblenë Kombëtare të Kosovës, e cila do të mbahej maksimalishtë vetëm 4 ditë më pas se ajo e Rambujesë, në 10 Shkurt, e që do të merrte vendime për fatin e Kosovës.

Po të mblidhej Asambleja, përveç se krijoheshin Qeveria e Koalicionit dhe institucionet e tjera për drejtimin e luftës, do të kishim edhe disa përparësi të tjera: do të ngjallej në popull besimi në fitore; do të forcohej në popull vullneti për luftë; do të krijohej mundësia për t'u kuptuar nga shumica e popullit në Kosovë se vetëm të bashkuar mund të shkatërrohej edhe një armk i fortë si ushtria e Serbisë; do të ndërgjegjësohej populli për zgjatjen e luftës dhe, së fundi, prezantoheshin e hiqeshin dyshimet e përfolura për ata që ishin në krye të UÇK-së. Mirëpo, ata e sabotuan Asamblenë Qytetare, ndoshta ngaqë kishin frikë se mund të mos ishin të gjithë në krye të Qeverisë të dalë prej saj, ndaj dhe e vlerësuan situatën e krijuar në Janarin e vitit 1999 në mënyrën më kontraverse që mund të bëhej. Përveç kësaj, ai sabotim arbitrar i Asamblesë prej Drejtorisë Politike e mënjanoi popullin për të vendosur për fatin e vet, si dhe tregoi se ata e konsideronin UÇK-në si me qenë pronë private e tyre dhe e pavlefshme për më tej.

Ky veprim i Dr.P u erdhi për hosh disave prej diplomatëve europjanë,

atyre, të cilët mbledhjen e Asamblesë Qytetare e shihnin si një qëllim armiqësor ndaj vendeve të tyre, si aleatë të përhershëm të Serbisë që ishin. Gjithashtu, duke u sabotuar Asambleja, nuk krijohej Qeveria e Koalicionit, e cila pa dyshim që do të kryesohej nga Demaçi, gjë që ishte shqetësim për Serbinë, për faktin se sigurohej udhëheqja solide dhe ekzistenca e UÇK-së edhe pas pushimit të luftës.

Dhe të gjitha këto "rreziqe" Serbia dhe ndërkombëtarët i shihnit tek roli i Demaçit.

Pse Adem Demaçi nuk pëlqehej nga shumë diplomat të huaj[108)]?

Filozofi, poeti dhe dramaturgu gjerman Emanuel von Gaibel, thotë se, *"Diplomacia përpiqet ta ndryshojë historinë e re me një gomë, që me ndihmën e saj të fshijë revolucionin*". Kjo ka dash të ndodhë edhe për rastin tonë: një pjesë e mirë e diplomatëve europianë, të angazhuar me luftën në Kosovë, kërkonin ta fshinin nga kujtesa e historisë gjithë luftën e bërë nga UÇK-ja dhe ta dënonin atë me vdekje. Mjafton të sjellim në kujtesë përpjekjen që po bëhet me ngulm gjatë vitit 2014 nga Brukseli dhe EULEX-i për ngritjen e Tribunalit të Posaçëm për "krimet" e UÇK-së, bindesh që diplomacia europiane e ka pasur dhe e ka ende atë qëllim. Dhe, të ishe kundër dënimit me vdekje të UÇK-së, natyrisht që do të viheshe në shënjestrën e tyre; dhe shembulli më i mirë ndaj këtij qëndrimi kundër dënimit me vdekje të UÇK-së ishte Demaçi, i cili luftoi kundër atij absurditeti. Dhe këtë luftë ai e luante pa prapaskena. Ai nuk i pëlqente këto mjete të diplomacisë. Duhet të jesh më trim nga ç'pandehet që ta thërrasësh veten me emërin tënd të vërtetë. Nuk mund të merret me mend se sa ka vuajtur Adem Demaçi deri sa ka arritur në këtë stad njerëzor.

Diplomatët e ndjenin se Demaçi simbolizonte mendjen e kërkuesit të fitores me çdo kusht, teknologjinë e orientuar drejt ndryshimit të strategjisë së luftës, për ta transformuar atë dhe historinë si favorit i

---

108) "E di mirë që Adem Demaçi është përfaqësues i UÇK-së këtu, në Prishtinë, por as unë, as ambasadori Hill, nuk mund të merremi vesh me të për asgjë. - u shpreh z. Hollbruk". (*Blerim Shala: "Vitet e Kosovës", Prishtinë 2000. F.149)*

përhershëm për Kosovën. Qëndrimi, pamja dhe fjala e tij u jepte diplomatëve të huaj idenë e një qëndrimi prej aristokrati të natyrshëm. Si i tillë, ai s'kish si të pëlqehej prej tyre.

Por ja që puna ia desh që Demaçi të përplasej me diplomacinë dhe prapaskenat e saj. Diplomatët e huaj kërkonin që ta detyronin atë të hiqte dorë nga vijimësia e mëtejshme e UÇK-së dhe të pranonte bisedimet për këtë problem. Pikërisht këto ishin kërkesat kryesore të tyre. Dhe, kur Demaçi i kundërshtonte u dukej interesant. Kjo ndodhte se ata nuk mund ta merrnin me mend se ai kish jetuar në kohëra interesante; nuk mund ta kuptonin vendosmërinë e tij si shkëmb graniti, ngaqë ishte më mirë i informuar se autorët e komunikimit diplomatik, si dhe nuk e kuptonin atë nevojë që ndjente ai: ndreqës i çdo padrejtësie për popullin e tij, mbrojtës i popullit të nëpërkëmbur.

Edhe Adem Demaçi, sikundër thamë, ishte për bisedime ndërkombëtare. Edhe ai ishte i bindur se momenti përfundimtar për largimin e Serbisë kolonizuese nga Kosova ishin bisedimet. Por ai këmbëngulte që bisedimet të kryheshin pa i ndërprerë UÇK-ja luftimet, ose bisedimet të zhvilloheshin në fund të luftës. Gjithashtu, në këto bisedime ai nuk pranonte 10 parakushtet e panegociueshme të projekt-marrëveshjes të hartuar nga ata diplomatë[109)], ndaj dhe këmbëngulte të hiqej mosnegocimi i tyre; dhe kjo të bëhej para se delegacioni të nisej për bisedime. Është më se e vërtetë dhe më se e provuar që edhe negocjimi më i keq për pushimin e një lufte është më i mirë se lufta më e mirë. Por ja që "*Propozimet e Rambujesë nuk lanë zgjidhje tjetër përveç luftës*"[110], sikundër konkludon pas asaj konference, diplomati i shquar amerikan Henry Kissinger, gjë që i jep të drejtë Demaçit në parashikimet e tij.

Dhe, ajo që vlen të theksohet, Demaçi nuk fliste në emër të tij, por në

[109)] Adem Demaçi: "Liria dhe joliria", f. 30-31

[110)] Henry Kissinger ""A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme?", Tiranë, 2004, f. 409

emër të popullit të Kosovës, që pritej ta thoshte fjalën e vet deri në 10 Shkurt. Për këto arsye ai u shprehej ndërkombëtarëve pse nuk ishte dakort për prezencën e LDK-së e të Rugovës, pasi prezenca e tyre në tavolinën e bisedimeve e inkurajonte Serbinë të këmbëngulte edhe më me forcë në kërkesën e saj për ta mbytur UÇK-në pa luftë. Kjo këmbëngulje e tij ishte një arsye më shumë pse diplomatët shprehnin pakënaqësi ndaj Demaçit.

Diplomatëve nuk u pëlqente të debatonin me njerëz këmbëngulës si Demaçi. Prandaj në rrugë të tjera po mundoheshin të bindnin udhëheqjen e ngushtë politike të UÇK-së, Drejtorinë Politike, që të pranonte shkuarjen në Rambuje. Dhe se si u arrit ajo, këtë na e sqaron Ministri i Jashtëm i Francës i asaj kohe, Hubert Vedrin, duke i deklaruar Agjensisë AFP të nesërmen e fillimit të bisedimeve në Rambuje, më 7 Shkurt 1999: "*Ajo që për diplomacinë franceze është me rëndësi, është fakti se ishim ne ata, që i tejkaluam divergjencat në grupin e shqiptarëve. Na u desht mund dhe aftësi që t'i bindnim ata, se nuk ka rëndësi as emri as numri i anëtarëve, as kush do të jetë kryesuesi i grupit, por me rëndësi është që Kosova të fitojë një status të autonomisë substanciale në kuadër të Serbisë-Jugosllavisë*"[111]. Dhe ia arritën qëllimit! Ata e ndoqën atë rrugë, pasi u bindën se Demaçin nuk mund ta gënjenin; ai u dukej si një dijetar i rreptë, i cili shpesh herë u thoshte: *"Nuk duam as të na lavdëroni as të na shani. Mbështetuni vetëm në faktet që duken sheshit dhe jo në fjalët që përhapen nga dashakeqët e UÇK-së*".

"*Përfaqësuesit e OSBE-së kanë bërë një presion jashtzakonisht të madh ndaj Demaçit*"[112], - tregon komandanti i zonës së pestë operative, Rrustem Mustafa, por shumë shpejt u bindën se Demaçit ata nuk ia delnin dot as edhe me anë kërcënimesh indirekte për UÇK-në, ndaj dhe hoqën dorë shpejt nga ajo metodë.

---

[111] Fehmi Baftiu "Kosova krizë ndërkombëtare", Prishtinë, 2004, f. 324

[112] Safet Zejnullahu "Lufta për Kosovën", Prishtinë, 2000, f. 85

Adem Demaçi nuk ishte vetëm përfaqësuesi politik i UÇK-së, por edhe diçka tjetër. Ai ishte për UÇK-në dhe gjithë Kosovën edhe një kujtim i vyer dhe i paprekshëm i një të kaluare legjendare, prandaj dhe thirret: simboli i rezistencës. Reagimet e tij nervore ishin tepër të shpeshta, pasi distanca midis mendimit dhe veprimit tek ky njeri është shumë e shkurtër. E megjithatë, përsëri atij i mbetej kohë për të menduar çdo fjalë kur bisedonte me diplomatët, por edhe me antarët e Dr.P dhe të ShP të UÇK-së. Demaçi, duke shprehur të vërtetën ashtu si e ndjente, e kishte gjuhën shumë të mprehtë, shumë i fortë në diskutime; qëndrimin e tij ai e shprehte shumë qartë, duke e shpjeguar haptazi, pa bërë asnjë dredhi dhe pa dhënë shkas që ata të bënin supozime. Mëndjemprehtësia me të cilën Demaçi i thoshte të vërtetat, ata i bënte që të mos e ndjenin veten të qetë përpara tij.

Adem Demaçi kish arritur në këto vlera përmes një rruge të natyrshme, duke u mbështetur në përvojën e tij dhe jo në arsyetime metafizike të kota dhe në përuljen morale përpara ndonjë personaliteti ideal.

Është e vërtetë që Demaçi nuk jepej edhe aq pas ceremonialit diplomatik, mirëpo, po t'u referohemi bisedave të tij, duket që në çdo frazë të tij fshihej një ironi e hollë e thumbuese, gjë që, një gjë e tillë nuk u pëlqen aspak diplomatëve. Mirëpo ata nuk mund t'i duronin fjalët e tij thumbuese, edhe pse ishin mendime të çiltra dhe të hapta, sepse i merrnin për fyerje edhe pse ato nuk ishin fyerje. Ndaj dhe ata shpesh herë i shmangeshin Demaçit, duke u konsultuar me Rugovën, por edhe me "të pavarurit", të cilët përfaqësonin shoqërinë civile, edhe pse ajo vijonte të funksiononte nën regjimin e Millosheviçit.

Diplomatët nuk e duronin Demaçin sepse ai jo vetëm që i kundërshtonte ata, por edhe i korigjonte në çështjet ku kish mundësi t'ua delte atyre. Mirëpo diplomatët s'e durojnë dot një gjë të tillë. Ndaj dhe ata gradualisht filluan të ndjenin një urrejtje të përmbajtur ndaj tij, ngaqë u vinte edhe maraz nga besimi që ai kish tek forcat e UÇK-së dhe tek vetja e tij, si dhe u vinte plasja që ai nuk i frigohej asgjëje. E

vërteta i ka këto të këqija, që për fat të mirë a të keq, nuk dimë se si ta themi, ajo ndodhet gjithmonë në duart e të vuajturve dhe të vegjëlve.

Demaçi u bënte diplomatëve, si të thuash, një provim mbi qëndrimin e tyre kundrejt UÇK-së dhe përfaqësuesit të saj. Që të kalonin këtë provim ata duhej të çmonon Demaçin, sikurse i çmonte edhe ai; të mësoheshin me të, siç u mësua edhe ai; të ndjenin forcën e personalitetit të tij, ta pikasnin çdo gjë që kish ndodhur e ndodhte në Kosovë si dhe ai; të kishin besim në luftën e popullit shqiptar në Kosovë si dhe ai dhe, më së fundi, të tregoheshin në diskutim po aq të durueshëm sa edhe ky martir i gjallë e i pamposhtur, që qëllonte aq lehtë me shigjetat e satirës së tij çdo "nishan".

Po të dëshironin ata diplomatë ta shtronin problemin e UÇK-së dhe të ardhmen e Kosovës vetëm me Demaçin, duke u shkëputur nga Rugova dhe të "pavarurit", kish të ngjarë që bisedimet dhe ngjarjet të merrnin shumë shpejt rrugën e zgjidhjes dhe nuk do të kishin ndodhur gjithë këto ngjarje që ndodhën e po ndodhin pas luftës. Por, me sa u duk në Rambuje, pengesë për ata ishte ekzistenca e UÇK-së dhe qënia e Demaçit në krye të saj.

Diplomatët e huaj ndiheshin gushtë kur Demaçi thoshte se Lufta Çlirimtare në Kosovë ishte një revolucion historik për Kosovën, një lëvizje që lindi vetvetiu, ndaj dhe shpifjet se gjoja ishte një lëvizje me tendenca komuniste as që duhej të merreshin fare në konsideratë. Për Demaçin, ajo luftë ishte një vepër historike e ligjshme, ndaj dhe duhej të njihej e të pranohej për bisedime vetëm UÇK-ja. Nuk ishin të pakta rastet që Demaçi diskutimin me diplomatët e kalonte në shpjegimin e ligjeve të historisë, duke ua përsëritur se ligji themelor i saj janë ndryshimet e pandërprera që përmirësojnë gjendjen e popujve. Ndaj dhe ata e etiketonin atë dhe UÇK-në si shumë radikalë, pasi harronin që radikalizmi i saj ishte inversi i radikalizmit serb ndaj popullit shqiptar në Kosovë, por me një ndryshim rrënjësor: UÇK-ja nuk hakmerrej ndaj popullsisë serbe në Kosovë. Radikalizmi i UÇK-së, argumentonte Demaçi, do të qetësohej shumë shpejt nëse

Serbia prananonte të tërhiqej pa kushte nga Kosova. Nëse UÇK-ja nuk do të kish treguar ndaj policisë dhe ushtrisë serbe të njëjtën ashpërsi që tregonin serbët kundër popullit shqiptar, Kosova sot do të ishte e boshatisur nga shqiptarët dhe ne nuk do të ishim duke biseduar së bashku, ngulte këmbë Demaçi.

Diplomatët, gjithashtu, nuk donin ta pranonin se UÇK-ja kish lindur në gjirin e popullit të shumëvuajtur shqiptar në Kosovë, si një forcë e armatosur që kish për qëllim largimin e kolonializmit serb prej saj dhe të krijonte kushtet për vetëvendosjen e popullit të Kosovës, por e quanin atë si një nxitje nga Shqipëria, pasi ashtu fliste edhe Rugova e dashamirët e tij në Tiranë dhe satelitët e tyre. Me argumentat e faktuar të tij, Demaçi ua bënte të qartë diplomatëve se Serbisë i kish ngelur sharra në gozhdë gjatë përpjekjeve për ta shpopulluar Kosovën dhe kjo nga shkaku i UÇK-së. "*Kjo ndodh se luftëtarët e saj nuk e kanë zakon ta shohin luftën si një zbavitje xhentëllmenësh, sikundër e shohin "patriotët" tanë nga Tirana e Zvicra*", shprehej tërë nënkuptim Demaçi. Luftëtarët e saj, thoshte shpesh ai, janë njerëz të qytetërur, shumica intelektualë dhe të ardhur nga Perëndimi dhe, si çdo njeri i qytetëruar, natyrisht që ata janë të pamëshirshëm në luftë ndaj armikut për të mbrojtur popullin e tyre, dhe si të tillë kurrë nuk mund të bëjnë masakra ndaj civilëve sikundër bëjnë serbët.

Këto arsyetime e kishin shndërruar Demaçin në "grindavec" për diplomatët. Kështu ndodh ngahera kur njeriu kërkon një zgjidhje përfundimtare në çdo fjalë. Mirëpo diplomatët që bashkëbisedonin me Demaçin e shikonin çështjen e Kosovës dhe të UÇK-së nga pikpamja e interesave të qeverive të tyre me Serbinë[113)]. Ç'punë pa

---

[113)] Dhe kjo u duk qartë në vendimet e marrëveshjes së Kumanovës, më 10 Qershor 1999, ku u ruajtën të paprekura njësitë ushtarake serbe të mëdha e të vogla dhe më pas u lejuan edhe të armatosen, duke përqëndruar më pas një njësi të madhe në Vranjë, në vend që të shpërndaheshin,pa folur për faktin që si ushtri e mundur ajo duhej t'i dorzonte palës fituese (ta zemë NATO-n) gjithë armatimin që Forcat e Armatosura Serbe kishin në Kosovë.

shpresë!
Gjithashtu shumë diplomatë europianë dhe ai i Rusisë as që pranonin ta diskutonin që Kosova mund t'i shkëputej Serbisë dhe "*një grusht aventurierësh ta shpallnin atë shtet më vete*". Edhe për këtë pikë Demaçi pat kundërshtuar qysh në momentin që i dorëzuan në Shkup projekt-marrëveshjen, duke argumentuar se Kosova ka të drejtën të vërë në jetë të drejtën e saj për vetëvendosje, të cilën vetë Fuqitë e Mëdha e njohën dhe e nxitën qysh pas Luftës së Parë Botërore dhe e ritheksuan kur filloi Lufta e Dytë Botërore. Nëse Kosova i bashkangjitet shtetit amë, këmbngulte Demaçi, zhduket varfëria dhe prapambetja e saj, si dhe ndikimi i klikave politike që ruanin interesat e kapitalit të huaj dhe të politikanëve të korruptuar të Kosovës.

A mundej Demaçi të ndikonte mbi zhvillimin e historisë, ta detyronte i vetëm diplomacinë euro-atllantike të bënte një politikë qindpërqind në favor të Kosovës dhe UÇK-së, kur ajo diplomaci, me përjashtime të vogla, kish zhvilluar kurdoherë një lodër në favor të Serbisë?

Jo! Edhe Demaçi e kish të qartë se i vetëm nuk mund ta realizonte një gjë të tillë, të ndryshonte mendimet e diplomatëve ndërkombëtarë, të cilat ishin vendimet e padukshme të qeverive të tyre. Por Demaçin e ngushëllonte fakti se kish edhe qindra e mijëra të tjerë në Kosovë që luftonin për ato ideale që luftonte edhe vetë Demaçi. Dhe të tillë ishin shumica e atyre që kishin rrëmbyer armët dhe që ishin të arsimuar, duke patur mbështetje edhe familjet e tyre.
Adem Demaçi ishte i bindur se fitorja vjen pas shumë betejash, pas shumë disfatash dhe fitoresh të panumërta. Secila fitore dhe secila disfatë ta mprehin shkathtësinë dhe të rrisin fuqitë, guximin, qëndrueshmërinë, aftësitë dhe vetëmohimin, ndaj dhe çdo pengesë trajtohet si rast për të shkuar përpara. Nëse në luftë u kthen shpinën pengesave, atëherë i ke ikur ardhmërisë së Atdheut. Prandaj dhe Demaçi e përsëriste shpesh: "*UÇK-ja nuk do të kapitulloi dhe do të vazhdojë të luftojë forcat serbe ndoshta gjatë dy apo tre vjetëve të*

ardhshëm. Kam frikë se gjakderdhja do të vazhdojë. Ne do të praktikojmë format guerile në vend të një lufte frontale. Sigurisht popullsia do ta paguaj çmimin. Ne u shprehëm për pavarësinë dhe kjo ka çmimin e saj."[114)]

Por e rëndësishme është që Demaçi qëndroi i patundur në pikëpamjet e tij, sikur të ishte një hero i kohrave të Skëndërbeut, i papërkulshëm, i pathyeshëm.

Vërtet që gazetat tona pacifiste e ato "të djathta" e bënë Demaçin copë e thërrime, por ajo nuk do të thoshte aspak se ai nuk arriti asgjë. Demaçi ishte ai që i dha gjallëri UÇK-së dhe gjithë popullit shqiptar që e donte Kosovën si ai. Dhe kjo mjaftonte. Në Kosovë dhe në gjithë trevat shqiptare shumëkush e çmonte qëndrimin dhe inisiativën e tij dhe ishin gati të merrnin atë qëndrim politik, pa pasur frikë nga pasojat. Dhe ashtu rezultoi. Radhët e UÇK-së u shtuan edhe më shumë, me pjesmarrës nga i gjithë kombi shqiptar.

Adem Demaçi bën pjesë në atë kategori njerëzore që nuk merr parasysh sesa të lartë janë muret që duhet të kapërcehen kur bëhet fjalë për transformime njerëzore. Ai tregoi se ishte një kërkues i rreptë i së vërtetës, herë naiv që u beson verbërisht anëtarëve të Drejtorisë Politike, shumë herë zgalem i pamposhtur, e në të njëjtën kohë i ndjeshëm, kokfortë, shpirtmirë, gjakftohtë, i rrëmbyer, i duruar e mbi të gjitha i vendosur, si në politikë ashtu edhe në jetën vetjake.

Nëse Kosova do të heq dorë nga revolucionarë si Adem Demaçi, të cilët përpiqen në mënyrën më të vërtetë, të çiltër e të ndershme duke i treguar popullit udhën e drejtë, atëherë kemi për të hedhur poshtë haptazi gjënë më të shtrenjtë: lirinë dinjitoze, dhe vendin do ta drejtojnë ata që e shesin atdheun me mendjelehtësi si dhe vetveten për një grimë pushtet, për kundërmimin e pasurisë.

Ishte apo jo Demaçi për një konferencë ndërkombëtare për Kosovën?

Organizimin e një konference ndërkombëtare për Kosovën Adem

[114)] Revistën Periodike "Diaspora Shqiptare", nr.1, Shtator 1998, f. 29

Demaçi e shihte të pashmangshme, por jo në ato momente kohore kur UÇK-ja porsa pat arritur t'i afrohej barazimit në vlera ushtarake me ushtrinë serbe në aspektin ushtarak dhe politik; jo në ato momente kur ishim në pragun e vendosjes së luftës në Kosovë nën udhëheqjen e një qeverie gjithëpërfshirëse e zgjedhur prej popullit, e cila do të delte nga Asamblea Qytetare, ku të gjitha forcat politike në Kosovë do t'i ngrinin programet e tyre politike deri në fund të luftës; jo në atë kohë kur, përmes kësaj ngjarje të madhe politike, Asamblesë, do të hidheshin bazat e një uniteti shqiptar të panjohur kurrë më parë, qysh prej Lidhjes së Prizërenit.

Marrëveshjet për bisedime ndërkombëtare zakonisht i kërkon në rrugë diplomatike pala që e sheh se së shpejti do të jetë humbëse. Gjë që UÇK-ja nuk ishte në ato pozita. Prandaj Demaçi nuk kish pse të pranonte atë lloj marrëveshje të ngutëshme, në paragrafët e së cilës Kosovës i ndalohej të negocionte për 10 kushte që ishin në dëm absolut të saj. "*Nuk ka kompromis mbi parimet dhe interest kombëtare*", shprehej me zë të lartë dikur Presidenti Xhon Kenedi. Mbetja e Kosovës nën Serbi dhe shkrirja e UÇK-së, përveç të tjerave, binin ndesh me interesat kombëtare, aq më shumë në ato momente kur UÇK-ja ishte në avantazh të gjithanshëm.

Midis dobishmërisë së asaj konference dhe të drejtës për t'i kundërshruar ato 10 kushte, gjendej madhësia e fajit midis Drejtorisë Politike dhe Adem Demaçit. Kjo madhësi e pamatshme dypalëshe e fajit përbënte antagonizmin midis Demaçit dhe Dr.P, të cilat deri në atë moment ishin një palë. Dhe ky antagonizëm u duk qartë kur Drejtoria Politike pranoi në mënyrë të befasishme 10 kushtet e panegocueshme dhe shkuarjen e tyre në Rambuje, kur të tjera projekte politike ishin vënë në rrugën e zgjidhjes, në marrëveshjen midis UÇK-së dhe forcave politike në Kosovë, sikundër e theksuam më lartë.

Ajo këmbëngulje e Demaçit tregoi se për atë dhe UÇK-në çështja kryesore, javën e parë të Shkurtit 1999, nuk ishte armiku, por problemi i brendshëm: udhëheqja gjithëpërfshirëse e luftës çlirimtare.

Për këtë të drejtë të Demaçit bindemi edhe po t'i referohemi vetëm debatit që ai bën me Veton Surroin, pasqyruar tek libri "Liria dhe joliria", ku vihet re se Demaçi e ka pas më se të qartë se, luftën guerile (partizane) ai nuk e shihte thjesht në pikpamjen e veprimeve luftarake. Ai ishte i bindur se aksionet luftarake të UÇK-së, që ai kërkonte të intensifikoheshin, nuk ishin çelësi për mposhtjen me forcë të gjithë forcave ushtarake të Serbisë përmes betejave ushtarake, por ishin pjesë e një përpjekjeje politike në disa drejtime, të cilat duhej të ecnin në mënyrë paralele, për ta bindur Serbinë se luftrat guerile (partizane) nuk mposhten kurrë, e cila të detyrohej më në fund të tërhiqej nga Kosova. "*Eshtë e pamundur që një forcë e jashtme të mundi një lëvizje guerile në vendin e vet*"[115)], argumenton analisti amerikan i luftrave lokale në këto tre dekadat e fundit, historiani Xhorxh Fridman. Në rast se njëra prej atyre të dyjave do të ndalonte së funksionuari, (aksionet luftarake apo politike), ose do të ecte më shumë se tjetra, (sikundër ishte rasti i vendimit të Dr.P), do të krijoheshin vështirësi serioze, sikundër edhe u krijuan; pse jo edhe dështim, pasi edhe gjatë kohës që zhvilloheshin bisedimet në Rambuje, nga UÇK-ja u përsërit strategjia e luftës mbrojtëse, njëjtë si në verën e vitit 1998.

Mbledhja e Asamblesë Kombëtare në mes të luftës, do të ishte ecje paralel e aksioneve luftarake dhe ngritja e strukturave politike të pushtetit të ardhshëm, gjë që do të forconte besimin në popull, se e ardhmja e Kosovës do të ishte liria dhe demokracia liberale. Vetëm ashtu i jepej shpresë popullit. Kjo ishte politika e Demaçit, e cila është edhe qëllimi i vetë politikës. Madje, me shkëmbimin e robërve të luftës, më 13 Janar 1999, UÇK-ja, duke u bërë sunduese absolute e situatës politike dhe ushtarake në Kosovë, tregonte se ajo nuk kish për t'u dobësuar, por, përkundrazi, do t'i rritej edhe më shumë autoriteti, si dhe do të kishte edhe mbështetjen de fakto të të gjithë spektrit politik në Kosovë.

[115)] George Friedman "America's Secret Wars", USA, 2007, f. 307

Këtë gjë e patën vënë re edhe analistët anglezë James Pettifer dhe Miranda Vickers, që e kanë ndjekur nga afër atë luftë, të cilët shprehin të kundërtën e asaj që shprehen Jakup Krasniqi e Ramë Buja, duke thënë: "*Nga fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999, ishte bërë një hap i madh përpara në drejtim të aftësisë dhe organizimit të UÇK-së. Sipas komandantëve të UÇK-së, pikërisht në këto momente, kur ajo ishte shndërruar në një forcë koherente dhe shumë të suksesshme, po u kërkohej të ndërprisnin luftimet dhe të çarmatoseshin… Nuk vihej në dyshim, se UÇK-ja në Janar dhe Shkurt 1999 ishte duke fituar gjithnjë e më shumë hapësira në Kosovën Qëndrore dhe Perëndimore*"[116)].

Në ato kushte UÇK-ja do t'i përgjigjej asaj situate të krijuar me shtimin edhe më tej të numurit të luftëtarëve të saj, krahas presionit ushtarak ndaj Serbisë dhe atyre segmenteve të faktorit ndërkombëtar, që e shihnim me skepticizëm luftën tonë çlirimtare dhe objektivat që ajo synonte të realizonte. Vetëm pas mbledhjes së Asamblesë Qytetare, sipas Adem Demaçit, mund të bisedohej për të shkuar në një konferencë ndërkombëtare. Ndërprerje e këtij procesi shqiptar ishte një dramë e madhe si për UÇK-në edhe për Demaçin.

Për fat të keq, ngjarjet rodhën ndryshe. Duke u abandonuar Asmableja Kombëtare, praktikisht goditej drejtpërsëdrejti UÇK-ja. Pse e themi këtë? Sepse vetëm "*Lufta ndërton strukturat e reja që do të jenë institucionet e para të paqes*"**[117)]**, thotë pacifisti dhe shkrimtari i njohur frances Zhan Pol Sartri. E megjithatë, në këto kushte e për këto arsye që parashtruam, Adem Demaçi u përpoq të shpëtohej çfarë mund të shpëtohej. Ai propozoi që të bëhej një hap prapa: të zgjatej dhënia e përgjigjes për Konferencën Ndërkombëtare të Paqes

---

[116)] James Pettifer & Miranda Vickers: "Çështja sh`qiptare", Tiranë-New York, 2007, f.325-326

[117)] Franc Fanoni "Të mallkuarit e botës", Prishtinë, 1984, f. 20, (Sartri, autor i parathënies)

në Paris (Rambuje), derisa të mblidhej Asambleja Qytetare; të riorganizohej UÇK-ja për të përballuar ofensivën e mundshme serbe; të bëhej ç'është e mundur që t'i imponohej Serbisë të kalonte forcat e saj në mbrojtje si rjedhojë e sulmeve të shpeshta të UÇK-së dhe, më në fund, kur serbët do të ishin në gjendje për kundërsulme ndaj UÇK-së, kjo jo vetëm që do të ishte e aftë ta përballonte armikun, pasi serbëve u duhej një kohë e gjatë që të arrinin në atë stad, por atëherë do të duhej të delte në skenë konferenca ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, natyrisht që do të zgjatej lufta. Kjo do të ishte edhe pika më e dobët për Serbinë, të cilën e pat konstatuar edhe "Zëri Amerikës", i cili, në analizën e bërë në datën 15 Janar 1999 deklaronte: "*Serbia është dobësuar ekonomikisht dhe nuk ka burimet e duhura; një luftë afatgjatë për Serbinë është barazi me një katastrofë të paevitueshme*"[118]. Po këtë gjë raportonte nga Beogradi, në 2 Shkurt 1999, gazetari amerikan Steven Erlanger: "*Tani vendi është më i varfër se kurrë*"[119]. Prandaj themi se në këto kushte që ndodhej Serbia, strategjia e Demaçit do të rezultonte e suksesshme, pasi do të ishte Serbia ajo që do të kërkonte bisedimet, si palë që shkonte drejt humbjes së luftës. Si rjedhojë, Kosova do të kish këto përfitime: UÇK-ja do të mbetej ushtria e rregullt e Kosovës; LDK-ja nuk do të merrte më pushtetin dhe, qysh në zgjedhjet e para, forcat progresiste politike përkrahëse të luftës së armatosur do të merrnin pushtetin dhe s'do të ndodhte e kundërta, sikundër ndodhi.

Derisa Adem Demaçi shkoi në Shkup dhe e pranoi ta merrte dhe ta studjonte projekt-marrëveshjen e Rambujesë, shihet qartë që ai ishte për një mbledhje ndërkombëtare. **Por, të pranosh, nuk do të thotë të pajtohesh**. Që të pajtohej, ai kërkonte një zgjidhje të arsyeshme: mosçarmatosjen e UÇK-së dhe vetëvendosjen e Kosovës, të cilën ai e kish të qartë që arrihej vetëm me këtë rrugë. Gjithashtu, ai nuk

---

[118] Fehmi Baftiu "Kosova krizë ndërkombëtare", f. 295

[119] The New York Times, 2 Shkurt 1999, marrë prej Hajrudin S. Muja "Lufta e Kosovës në shtypin amerikan", Prishtinë, 2012, f. 214

ishte për një pavarësi që të dhurohej nga duart e Evropës dhe më pas të shfrytëzohej për qëllimet e ruajtjes së ekuilibrave në Ballkan, por për një pavarësi të vërtetë me të drejtën e vetëvendosjes.
Duke qenë se Shtabi i Përgjithshëm e pranoi vendimin e Drejtorisë Politike, strategjia e Demaçit dështoi. Dështimi i Demaçit ishte dështim edhe për UÇK-në; rrjedhimisht dështim edhe për Kosovën. Për të mos ndodhur ai dështim, ai menjëherë, porsa delegacioni kosovar mbriti në Paris, organizoi në Shtabin e Përgjithshëm, në Abri të Drenicës, zgjedhjen dhe emërimin e Komandantit të ri të atij shtabi, Sylejman Selimin, (deri në atë kohë komandant i Zonës së Parë Operative), në vend të Azem Sylës, që pat shkuar në Rambuje[120]. Madje, Demaçit në atë mbledhje iu dhanë edhe të gjitha kompetencat për Udhëheqjen Politike të UÇK-së, si Komisari i saj Politik.
Për vendimet e dala nga ajo mbledhje në Abri, kundërshtarët e akuzuan menjëherë Demaçin se paskish bërë puç! A ishte i tillë veprimi që ai inicoi?
Na vjen keq që një shkrimtar i përmasave botërore si Ismail Kadare të shprehet nga Kafe "Saint-Claude", Paris, pranë statujës së Dideroit, duke thënë: "*Adem Demaçi ka bërë një farë puçi në Kosovë, e ka shpallë të pavlefshëm mandatin e delegacionit dhe paska kërcënuar vërtetë ta shpallë tradhëtar po të nënshkruajë. Mungesa e papërgjegjësisë e këtij njeriu është ulëritëse. S'është më fjala për lajthitje, është fjala për një krim. Çdo trill të këtij njeriu Kosova e paguan me gjak, me tortura e me foshnja të vrara… Sikur të mos e njohja do të dyshoja për tradhëti*"[121]. Dhe këtë akuzë tepër të rëndë e bën Kadareja, ai që i ka njohur mirë vuajtjet dhe idealin e Heroit

---

[120] Në atë mbledhje morrën pjesë gjithë komandantët e zonave operative, të cilët në atë mbledhje pranohen edhe antarë të Shtabit të Përgjithshëm: Ramush Haradinaj, Rrustem Mustafa, Rrahman Rama, Ekrem Rexha, Sylejman Selimi, Ahmet Isufi, si dhe i ngarkuari me detyrën e Shefit të Sh.P, Bislim Zyrapi dhe antari i Sh.P. Rexhep Selimi.*(Shih Shkëlzen Gashi: "Demaçi", f. 162)*
[121] *Ismail Kadare: "Ra ky mort e u pamë", Onufri, 1999, f.29*

Demaçi, duke e quajtur tradhëti vendosmërinë e tij për të arritur në Pavarësinë e Kosovës me të drejtën e Vetëvendosjes dhe jo që ajo të kthehej prapa, në Autonomi. Adem Demaçi nuk vuajti nëpër burgjet e Serbisë për t'u bërë "puçe" ca nxënësve të tij mosmirënjohës e karrieristë, dhe këtë duhej ta kish parasysh zoti Kadare para se të shpehej në atë mënyrë.

Nëse Kadareja do ta shihte me qetësi se cilët ishin ata përfaqësues të UÇK-së që shkuan në Paris, do ta kuptonte se Ushtria Çlirimtare e Kosovës mbeti pa komandim unik ushtarak e politik, pasi u largua e gjithë Drejtoria Politike, anëtarët e së cilës përbënin edhe shumicën e Shtabit të Përgjithshëm. Ai që kryente detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Bislim Zyrapi, nuk ishte i emëruar, por i komanduar prej atyre që u nisën për në Konferencë. Me këtë rast vlen të theksohet se Bislim Zyrapi, edhe pse ishte ngarkuar të kryente detyrën e Shefit të Shtabit, (prej Qershorit 1998), ky fakt nuk ishte bërë publik; atë e dinin vetëm njerëzit pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e zonave, por jo masa e gjithë luftëtarëve dhe e popullit. Bislim Zyrapi është bërë publik në detyrën e Shefit të Shtabit në fund të muajit Mars 1999, përmes një interviste të botuar në gazetat "Ushtria" dhe "Shekulli" të Tiranës, nga autori i këtij libri. Madje, kur anëtarët e Drejtorisë Politike e lexuan këtë intervistë shtrëmbëruan buzët, sepse ata kishin planifikuar të emëronin në këtë detyrë Agim Çekun, i cili erdhi me shumë vonesë, në gjysmën e dytë të muajit Prill, një muaj pasi NATO kish filluar bombardimet me aviacion; ai erdhi në një kohë kur nuk kish mbetur asnjë shqiptar që të ishte skeptik për mundësinë e fitores së luftës sonë (!)

Komandimi i Kolonel Bislim Zyrapit[122)] në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, automatikisht e pati bërë atë edhe zevendës

---

[122)] Bislim Zyrapi vinte nga lufta në Bosnjë, ku gjatë asaj lufte kish mbritur deri Komandant Divizioni, me gradën Kolonel. Gjatë gjithë periudhës së luftës në Kosovë, në UÇK nuk ishin vendosur gradat ushtarake, edhe pse në Maj të vitit 1999 u përgatit projekt-regulloria për gradat ushtarake, por që nuk u vu në zbatim.

Komandant të Përgjithshëm. Mirëpo, me largimin e Komandantit të Përgjithshëm të UÇK-së për në Paris, Azem Sylës, (edhe pse nuk njihej si i tillë as nga shumica e komandantëve të zonave), nuk kemi asnjë vendim apo urdhër nga Azem Syla, apo vendim të Dr.P ose të Shtabit të Përgjigjthshëm të UÇK-së që zotit Bislim Zyrapi t'i transferoheshin edhe kompetencat e Komandantit të Përgjithshëm, deri në kthimin e drejtuesve të lartë të UÇK-së nga Parisi. Në çdo kushtetutë theksohet se çdo kryeministër e ministër, në zbatim të kompetencave të tij nga zevendësit e tij, nxjerr urdhëra e udhëzime edhe në kohë paqe e jo më në kohë lufte.

Por, edhe sikur të ishte lëshuar një urdhër i tillë që Kolonelit Bislim Zyrapi i transferoheshin kompetencat e Komandantit të Përgjithshëm të UÇK-së, ajo nuk mund të lejohej, pasi në këtë rast zotit Bislim i jepeshin tre funksione: shef i Shtabit të Përgjithshëm, zevendës-Komandant i Përgjithshëm dhe Komandant i Përgjithshëm. Vetë Ali, e vetë Kadi! Prandaj "*pjesëmarrësit e këtij takimi (në Abri) kuvënduan lidhur me çështjen se UÇK-ja ka dy zevendës të Komandantit të Përgjithshëm –Jakup Krasniqin dhe Sokol Bashotën- por asnjë Komandant të Përgjithshëm*"[123)], ndërkohë që Sokol Bashota pat dhënë dorëheqje nga ajo detyrë[124)], ndërsa zoti Jakup kish shkuar në Rambuje. Të gjitha këto e bënin të domosdoshme emërimin e një Komandanti të Përgjithshëm. Prandaj nuk mund të quhet puç.

Këtë analizë nuk e sjellim thjeshtë e vetëm për të saktësuar disa vogëlsira, por në mënyrë të veçantë për të theksuar se largimi i anëtarëve të Dr.P dhe të SHP nga drejtimi i luftës dhe nisja e tyre me nxitimi për në Paris, mund ta kish çuar UÇK-në edhe në qorrsokak ose në aventurizëm, po të mos ishte ai veprim i Demaçit.

Nëse Azem Syla do të kish lëshuar një urdhër, ku të përcaktohej personi që i transferoheshin kompetencat e tij si Komandant i Përgjithshëm gjatë kohës që ai do të ndodhej në Francë, atëherë po,

---

123) Shkëlzen Gashi "Adem Demaçi, biografi", f. 162

124) Jakup Krasniqi, "Kthesa e madhe", f. 183

ai veprim i Adem Demaçit do të quhej thjeshtë një puç ushtarak.
Mirëpo, na rezulton se nuk është Adem Demaçi ai që t'i jetë imponuar SHP për të zgjedhur komandantin e ri të UÇK-së, por, përkundrazi, është nisma e asaj pjese të mbetur të SHP dhe e komandantëve të zonave operative. Dhe këtë gjë na e dëshmon komandanti i Zonës së Pestë Operative, Rrustem Mustafa: "*Para Sylejman Selimit nuk ka pasur komandant të UÇK-së. Nëse ka ekzistuar ai, nuk ka mundur të jetë ilegal për komandantët e zonave. Ka fjalë që ka qenë dikush, por nuk ka mundur të jetë ilegal… Ideja për emërimin e komandantit ka dalë aty. Ne kemi dashur të kontribuojmë për të mirën dhe ta forcojmë delegacionin shqiptar në Rambuje, për të bërë me dije se ata e kanë komandantin e vet dhe duhet të vijnë këtu për t'u konsultuar dhe se nuk janë ata që mund të vendosin për fatin e Kosovës... Unë pata propozuar Bislim Zyrapin, kurse Ramush Haradinaj Sylejman Selimin. Pas diskutimeve që kemi bërë në atë kohë, kemi ardhur në përfundimin se Sylejman Selimi duhet të jetë komandant i UÇK-së. Ai e ka pas votën e të gjithë neve dhe ky vendim është përcjellë me të shtëna nga të gjithë ne. Kjo menjëherë, përmes telefonit, i është komunikuar delegacionit në Rambuje"*[125].

"Frikën se mos ky emërim do të tingëllonte si puç, nuk e kemi pasur, - vijon të na e plotësoi më tej këtë dëshmi, komandanti i Zonës së Tretë Operative, Ramush Haradinaj, - *sepse nuk kemi ndryshuar asgjë. Vetëm jemi munduar të përsosemi në organizim, që kemi menduar se është e drejta e jonë dhe natyrisht se për këtë nuk i kemi kërkuar leje askujt*"[126].

Pavarësisht se mbledhja në Abri të Drenicës, ku u zgjodh Sylejman Selimi Komandant i Përgjithshëm, në pamje të parë mudet që dikujt t'i japi përshtypjen e një veprimi të gabuar, edhe pse i pa-paramenduar, përsëri, për ta quajtur puç duhej, më së paku që, një

---

[125] Safet Zejnullahu "Lufta për Kosovën", vepër e cituar, f. 94
[126] Bardh Hamzaj "Rrëfime për luftën dhe lirinë", Prishtinë, 1999, f. 140

pjesë e strukturës së brendshme të arrinte të merrte nën kontroll udhëheqjen e të gjithë piramidës drejtuese të UÇK-së dhe ta zevendësonte atë, duke mohuar komplet lidershipin e parë. Gjë që "*nuk kemi ndryshuar asgjë*", sikundër pohon Ramush Haradinaj.

Në rastin tonë, ky i ashtuquajturi puç, nuk ndodhi. Madje, dimë se menjëherë pas emërimit të Sylejman Selimit Komandant të Përgjithshëm, ai Shtab i dërgon telegram delegacionit në Rambuje, ku thuhej: "*SHP i UÇK-së ka bindjen se delegacioni i Kosovës në Rambuje për asnjë moment nuk do ta harrojë gjakun e bijve dhe bijave më të mira të popullit tonë"*[127], gjë që tregon se nuk mohohej lidershipi politik i luftës që pat shkuar në Rambuje. Në kriteret klasike të një puçi dihet nga përvoja që struktura e re e lidershipit të luftës mohon strukturën që zevendëson, e akuzon atë deri për tradhëti dhe ndryshon vijën e deriatëhershme politiko-ushtarake. Në rastin e UÇK-së, me largpamësinë e tij, Adem Demaçi vijonte të komunikonte me drejtorin e Dr.P, Hashim Thaçin, madje edhe u takua e shkëmbeu mendime me të, në Lubjanë, më 19 Shkurt, në prezencën edhe të Hetem Ramadanit[128], gjë që tregon se Thaçi e kish pranuar emërimin e para një jave të Sylejman Selimit Komandant të Përgjithshëm dhe të Adem Demaçit Komisar të Përgjithshëm. Gjithashtu, Demaçi nuk i ndryshoi aspak objektivat politikë e ushtarakë të UÇK-së, përkundrazi, kërkonte t'i thellonte edhe më shumë ato. Për këtë mjafton të lexohet deklarata Politike e SHP të UÇK, nr. 31, datë 19 Shkurt 1999, ose letra e zotit Demaçi e datës 12 Shkurt dërguar delegacionit në Rambuje[129].

Nëse për anëtarët e delegacionit të UÇK-së në Rambuje ky veprim i Adem Demaçit do të konsiderohej puç ushtarak, ata, me kthimin në Kosovë, në pauzën ndërmjetëse të të dy raundeve të asaj konference, (25 Shkurt-14 Mars 1999), do të ishin munduar t'i

---

[127] Arkivi RKL, v.1, f. 279-280, datë 14 Shkurt 1999

[128] Shkëlzen Gashi, "Demaçi-biografi", f.163

[129] Fehmi Baftiu: "Kosova krizë ndërkombëtare", f.329 dhe 336

anullonin të gjithë vendimet e marra në Abri; por, përkundrazi, nuk e diskutuan fare, si në Shtabin e Përgjithshëm ashtu edhe me komandantët e zonave operative dhe të brigadave. Ky fakt është një argument më shumë, që tregon se ata e kishin pranuar mbledhjen në Abri si një akt të domosdoshëm për UÇK-në. Por, me sjelljet e tyre gjatë atyre ditëve të kthimit të përkohshëm, (të cilën do ta trajtojmë më poshtë), ata plotësuan kuadrin e realizimit të një skenari, sipas të cilit, akuza kundër zotit Adem Demaçi ishte formë presioni politik që ai të detyrohej të jepte dorëheqjen nga funksioni i Komisarit të Përgjithshëm Politik i UÇK-së.

Mund të supozohet që këtë akt ndaj Adem Demaçit, ata e kanë ndërmarrë ngaqë e kanë kuptuar që nënshkrimi i tyre në Rambuje mund të mos kishte vlerë juridike, pasi nuk ishin më ata përfaqësuesit politikë të UÇK-së, por ishte Adem Demaçi, i zgjedhur nga Shtabi i Përgjithshëm, Komisar i Përgjithshëm Politik i UÇK-së.

Ardhja në Kosovë në këto kushte e anëtarëve të Drejtorisë Politike, mbase edhe me nxitje nga jashtë, kuptohet se kishte dy synime: ose të detyrohej Adem Demaçi të shkonte së bashku me ta në Rambuje e të nëshkrunate çfarë t'i servirej, ose të detyrohej të jepte dorëheqjen. Vetëm dorëheqja e Demaçit e bënte të vlefshëm nënshkrimin e tyre në Rambuje.

Përcaktimi që doli në atë kohë se gjoja delegatët e UÇK-së u kthyen në Kosovë për t'u konsultuar me komandantët e Zonave Operative dhe me anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, përfshi natyrisht edhe Adem Demaçin, ishte praktikisht "bërthama" e një përzënie fyese që iu bë atij, dhe jo konsulta. E themi këtë gjë, pasi nuk kemi mbledhje të SHP dhe të komandantëve të zonave operative, por takime një nga një e veças të secilit prej tyre dhe këto takime u bënë pasi Demaçi e kish bërë publike dorëheqjen e tij.

Sa më shumë kohë që kalon prej atyre momenteve historike, në të cilat u ndodh UÇK-ja dhe Shtabi drejtues i saj, aq më shumë konturohen pozicionet e njerëzve pjesëmarrës në ato ngjarje, të drejta a të gabura qofshin, ku spikat në mënyrë të vaçantë

personaliteti i Adem Demaçit. Ai e kishte treguar me gjithë jetën e tij dhe e tregoi edhe në këtë rast se ishte i lidhur shpirtërisht me nënën Kosovë dhe nuk i interesonin gradat e postet. Dorëheqja e tij nga drejtimi politik i UÇK-së është një veprim qytetar, nga i cili kanë çfarë të mësojnë shumë drejtuesit që, me apo pa merita të spikatura apo rutinore, qoftë edhe si pasojë e zhvillimeve të paparashikuara, kanë ardhur apo kanë kapur një pozicion drejtuesi të lartë në forcat politike apo në organet shteterore, në kushtet e Kosovës së pasluftës.

Po ashtu, me ato vendime që u morën në mbledhje, në Abri, për zgjedhjen e S. Selimit e Deamaçit, u dakorduan edhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Bislim Zyrapi, si dhe Inspektori i Përgjithshëm i atij shtabi, Rexhep Selimi, gjë që e bën nonsens atë akuzë të Kadaresë.

Nëse do të ishte puç ushtarak, më vonë, kur z. Demaçi pat dhënë dorëheqjen dhe delegacioni i UÇK-së ishte kthyer në Kosovë pasi e kish nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, të paktën do të ishte shkarkuar Sylejman Selimi nga funksioni i Komandantit të Përgjithshëm, gjë që nuk ndodhi, por, përkundrazi, është po ky që drejtoi luftën deri në fund të Prillit 1999, pasi miratoi edhe operacionin më të rëndësishëm të asaj lufte çlirimtare, Operacionin "Shigjeta", 45 ditë pas angazhimit të NATO-s në atë luftë.

Sot, kur kanë kaluar mbi 15 vjet nga ajo ngjarje bindemi akoma më shumë që Adem Demaçi, së bashku me komandantët e zonave dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Bislim Zyrapin, ka kryer një veprim taktik shumë efikas e të zgjuar, i diktuar nga kushtet e krijuara pas largimit të udhëheqjes politike të UÇK-së dhe komandantit të saj, Azem Sylës, (pavarësisht se i panjohur publikisht), ku patën mbetur vetëm Bislim Zyrapi, Lahe Brahimi dhe Rexhep Selimi.

Që të përmbushte kushtet e një puçi klasik ushtarak, përveç deklarimit se nuk do t'i njihte më ish antarët e Drejtorisë Politike dhe të komandantit të SHP, Adem Demaçit do t'i duhej të deklaronte se nuk e njihte aspak Konferencën e Rambujesë. Ndërsa ai, jo vetëm që nuk bëri ndonjë deklaratë të tillë, jo vetëm që nuk e shpërbëri piramidën komanduese të UÇK-së, por është po kjo strukturë

ushtarake që mbajti bashkveprimin me aviacionin e NATO-s dhe që drejtuan luftimet tokësore gjatë 78 ditëve të angazhimit të saj.
Për të gjitha këto arsye, mbledhja në Abri nuk mund të pranohet se ishte një "puç", por përkundrazi, kishte si synim të vetëm: UÇK-ja të mos ngelej pa drejtuesin kryesor ushtarak; sepse nuk dihej sesa do të zgjasnin bisedimet dhe, në këtë rast, Serbia mund ta shfrytëzonte momentin për një mësymje të përgjithshme me ushtrinë e saj, siç veproi në fund të muajit Korrik 1998. Në një situatë të tillë, kush do ta drejtonte luftën? Asnjë ushtri nuk mund të luftojë e të fitojë pa një komandim unik. Dhe këtë bindje Demaçi e ka patur qysh atë ditë që organizoi mbledhjen në Abri. Gjë që e pat theksuar ndihmësi i Demaçit, zoti Albin Kurti, para mediave, në 8 Shkurt 1999: "*Adem Demaçi është dakort për të shkuar delegacioni i UÇK-së në Rambuje. Ndërkaq, mosshkuarja e tij në Rambuje ka pasur për qëllim ballafaqimin e drejtpërdrejtë të palëve që bëjnë luftën në Kosovë*"[130]. Njëkohësisht me atë veprim Adem Demaçi i bënte presion BE-së, dhe sidomos shteteve nismëtare të Konferencës, që të gjenin një zgjidhje sa më të drejtë e sidomos humane për Kosovën, populli i së cilës po ballafaqohej çdo ditë me vepra genocidi.

Ç'qëllim pat Demaçi me atë ndryshim në Sh.P. ?

Sikundër thamë, zevendësimi me urgjencë i Komandantit të Përgjithshëm të UÇK-së kish për qëllim organizimin e kryerjes së sulmeve të shumta e të shpeshta me formacione të vogla, në të gjithë territorin e Kosovës, sipas taktikës partizane (guerile): "Godit e ik". Përmes kësaj strategjie UÇK-ja do ta habiste Serbinë se nga i mori ajo gjithë këto forca, ndërkohë që deri atëherë kish zhvilluar kryesishtë luftime mbrojtëse? Ajo strategji do t'i imponontе Serbisë një luftë lodhëse, duke e mbajtur atë nën një tension nervoz, duke i shkaktuar më shumë pasiguri sesa humbje, derisa ta detyronte atë dhe aleatët e saj, që të pranonin kushtet që shtronte Adem Demaçi. Lufta është politikë. Prej asaj strategjie luftimesh synohej të

---

[130] Fehmi Baftiu: "Kosova krizë ndërkombëtare", f. 325

nxirreshin dobitë maksimale politike dhe ushtarake. Për këtë ia vlente që formacionet e UÇK-së të lodheshin, natyrisht që edhe do të gjakoseshin. Prandaj e kish krijuar populli UÇK-në, që të sakrifikonte.
Në kushtet kur armiku hakmerret me zjarr masiv artilerie dhe aviacioni kundër popullsisë civile vendase, vetëm mënyra e intensifikimit të mëtejshëm e luftës guerile, (sikundër e përzgjedhi Demaçi), është kundërveprimi më i efekshëm, të cilën e thekson edhe historiani i shquar ushtarak anglez i kohëve moderne, Lidëll Hart: "*Lufta guerile duhet të jetë gjithmonë dinamike dhe t'i përshtatet momentit. Intervalet statike të kësaj lufte janë më të dëmshme (detimentrale) sesa ato të luftës me front të regullt, pasi ato e lënë armikun të fitojë hapësirë dhe të depërtoi brenda territorit në një shtrirje të gjerë, duke mos u dhënë kohë forcave guerile të zgjerojnë radhët e tyre me luftëtarë të dalë nga populli. Mbrojtja statike nuk ka vend te veprimet e luftës guerile, përveç rastit kur forcat guerile janë në pritë*"[131]).
Që të realizohej ajo strategji guerile e përzgjedhur nga Demaçi, duhej patjetër që të lëshohej një urdhër. Nëse nuk do të kishim Komandant të Përgjithshëm, kush do ta lëshonte një urdhër të tillë?
Madje këtë mendim, për intensifikimin e mëtejshëm të sulmeve nga ana e UÇK-së, zoti Demaçi ia shprehu në telefon edhe zonjës Medlin Ollbrajt, ato ditë Shkurti të Konferencës: "*Nuk e kemi nis luftën për të provuar se a do të fitojmë, por e kemi nis për ta fituar. Nëse është e nevojshme të vdesim edhe tridhjetë mijë shqiptarë, le të vdesim, por ne nuk do t'i dorzojmë armët vetëm mbi bazën e premtimeve. Ne nuk do të heqim kurrë dorë nga ëndrra jonë për të qenë të lirë*"[132]). Kush nuk dorëzohet, nuk vdes; kjo është receta e pavdekësisë. Dështimi kurrë nuk mund t'ia arrijë qëllimit nëse vendosmëria për sukses e atyre që luftojnë është mjaft e fuqishme, sikundër përgjigjet edhe Demaçi.

---

[131]) Lidëll Hart: "Strategjia", SHBU, Tiranë 1997, f.462
[132]) Madeleine Albright, "Zonja sekretare", Dudaj, 2003, f. 471

Por, në ato momente, për fat të keq, as Komandanti i ri i Përgjithshëm nuk rezulton se e lëshoi urdhërin për sulme guerile masive në të gjithë territorin e Kosovës, por as edhe komandantët e zonave operative, të cilët ishin edhe anëtarë të SHP, nuk e zbatuan atë direktivë[133)] të Komisarit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së, edhe pse ishin ata që e kishin zgjedhur në atë funksion (!)
Shtabi i Përgjithshëm luhatej.

Fati i UÇK-së ishte paracaktuar.

Forca luftarake e një ushtrie çlirimtare bazohet vetëm në të qenët të gatshëm komandatët e formacioneve luftarake të saj për të sulmuar, dhe në asnjë motiv tjetër. Po t'i referohemi historisë së luftrave të ndryshme në botë, do të konstatojmë se në të gjitha luftrat e zhvilluara deri më sot, ushtritë kanë bërë të vetën vetëm një rregull: *Vepro, para se dikush të mund të të ndalojë*!
Ndoshta, ajo mosgatishmëri e komandantëve të zonave operative duhet të arsyetohet me faktin se edhe ata mund të ishin të dyzuar.
Nëse ajo direktivë e zotit Demaçi do të zbatohej me ashpërsinë më të madhe nga komandantët e zonave operative, të brigadave e batalioneve të UÇK-së, Serbia do ta kish të pamundur që të kundërpërgjigjej me një shkallëzim të madh ushtarak, (sikundër veproi më pas me operacionin "Patkoi"), pasi, duke e sulmuar kudo, natën dhe ditën, armiku do të detyrohej të kalonte në mbrojtje. Nëse ia ke arritur kësaj, e ke fituar luftën; në të kundërtën je i humbur. Me një fjalë, përmes sulmeve të vijueshme UÇK-ja do t'i vinte ndërkombëtarët para faktit të kryer dhe ajo nuk do të diskutohej më për t'u eleminuar si ushtri e ardhëshme e Kosovës dhe nuk do të thyhej uniteti midis Drejtorisë Politike dhe SHP të UÇK-së me

---

[133)] Direktiva është një udhëzim që jepet nga një person me përgjegjësi të lartë politike ose organ drejtues për vijën që duhet ndjekur në një punë; në këtë rast për intensifikimin e sulmeve në vijimësi në të gjithë territorin e vendit. Në luftrat çliritare si ajo në Kosovë është më se praktike dhënia e direktivave se sa e urdhërave luftarakë, ngaqë nuk kemi të bëjmë me luftë me front të regullt.

Udhëheqësin e Përgjithshëm Politik të saj, sikundër edhe ndodhi. Pikërisht, ky aspekt i përplasjes midis Adem Demaçit dhe Drejtorisë Politike shkaktoi plagë, të cilat as sot nuk janë shërruar ende, por përkundrazi, janë majisur edhe më keq.

Dikush edhe mund ta quajë utopi një presion të tillë guerilas nga ana e UÇK-së, ndaj bisedimeve ndërkombëtare, përmes strategjisë së shtimit të sulmeve në pragun e një konference të ngutshme ndërkombëtare. Por historia e luftrave na jep shembuj të ngjashëm me strategjinë që propozonte Adem Demaçi, që dikujt edhe mund t'i duket e pabesueshme. P.sh. një strategji e tillë e intensifikimit të luftimeve sulmuese nga ana e palës çlirimtare, që lufton për liri, në pragun e një konference ndërkombëtare, ka ndodhur në pragun e Konferencës së Gjenevës, në Prillin e vitit 1954, e cila u mblodh urgjentisht sipas propozimit të sovjetikëve, për ndalimin e luftës midis Vietnamit dhe Francës. Në momentet kur filloi konferenca, vietnamezët i shtuan sulmet ushtarake në terren. Si rjedhojë e detyruan administratën e Ajzenaurit të zgjidhte midis teorive dhe mundësive të saj, duke e detyruar Francën të lëshonte Vietnamin[134)].

Por, për fatin e keq tonin, asaj nisme të Adem Demaçit iu kundërpërgjigj vet Hashim Thaçi, tashmë me cilësinë e kryetarit të delegacionit kosovar në Rambuje, i cili urdhëroi ndërprerjen e veprimeve luftarake sulmuese nga ana e UÇK-së, duke u kërkuar ndërkombëtarëve që t'u bënin presion serbëve që të ndërpritej lufta, por që ata nuk e pranuan atë propozim[135)]**;** dhe kjo ngaqë Hashimi dhe gjithë Drejtoria Politike nuk njohin një nga parimet e luftrave çlirimtare: Armëpushimi mund të arrihet vetëm atëherë kur lufta kundër pushtuesit është forcuar dhe zgjeruar. "*Çdo ndalim i veprimtarisë luftarake është në kundërshtim me logjikën,* -thotë Klauzeviçi-*, kjo të paktën kur nuk pritet një moment më i favorshëm*

[134)] Henry Kissinger: "Diplomacia", Tiranë 1999, f.630

[135)] Arkivi i Radio Kosova e Lirë, v.1, 2004, 7.2.1999, por dhe 9.2.1999, f. 233.

për të vepruar". "*Kur bëni pauzë, njerëzit mendojnë se keni humbur besimin në atë që bëni. Kur dëshironi të rifilloni, ata, që herën e parë nuk kanë besuar në luftimet, do t'i refuzojnë ato më tej dhe do t'ju akuzojnë për një dështim të dytë, se nuk keni shfrytëzuar përparësitë gjat pauzës për të vendosur paqe, ndërsa ata që u kanë përkrahur tash janë konfuzë, sa që tash jeni të pasigurt se a duhet rifilluar sulmet fare. Dhe, nga aspekti ushtarak, pauza i rimundëson armikut të rikëndellet, të rivendosë mbrojtjen në vend të vet dhe të vazhdojë i papenguar me spastrimet etnike*"[136)], kështillonte Uesli Klark Ruper Smithin dhe Dieter Stockmanin, në 29 Mars 1999, në takimin e tyre pesë ditë pasi NATO kish filluar sulmet ajrore. Ja që edhe në këtë rast kemi një përputhje mendimesh në strategji ushtarake midis Gjeneralit Uesli Klark dhe Komisarit Politik të UÇK-së, Adem Demaçit!

Pra, strategjia e Demaçit do të na çonte në fitoren e vështirë, por të sigurtë të UÇK-së, pavarësishtë se do të sakrifikoheshin edhe më shumë jetë njerëzish. Dasëm pa mish, nuk ka. Por, me atë veprim që bëri Dr.P, duke e marrë pavarësinë e Kosovës nga ndërkombëtarët si një lloj dhurate, tani në Kosovë po ndodh çudia botërore: fitimtarët vihen në bangon e të akuzuarve dhe gjykohen...!?

Kryetari i delegacionit kosovar, Hashim Thaçi, i panjohur deri në momentin e mbritjes në Rambuje, si të thuash, nga një trup asteroid që lundron i vetmuar në kozmosin njerëzor, u bë pika tërheqëse e fateve të Kosovës, duke kërkuar armëpushim, e cila ishte një kërkesë absurde, pasi i hiqte Serbisë motivin e tërheqjes. Dhe, çuditërishtë, në vend që atë diplomaci ushtarake ta bënte UÇK-ja e bëri Serbia, duke iu kundërpërgjigj Thaçit me intensifikimin e sulmeve të saj, kurse formacionet e UÇK-së kaluan në mbrojtje (!!!). Me këtë lloj presioni ushtarak Serbia i imponohej delegacionit shqiptar që të pranonte pa asnjë kundërshtim kushtet e paracaktuara në projekt-marrëveshje, (për të cilat ata u prishën me Demaçin), duke e patur

---

[136)] Wesley Clark: "Të bësh luftë modern", Prishtinë 2003, f.263

tërë synimin tek mosnjohja e UÇK-së, pasi ishte ajo që e kish sfiduar Serbinë. Boll dhe me kaq, Serbia ishte e kënaqur. Ky është edhe një fakt më shumë që të bind se urgjenca Rambuje është e inicuar nga Serbia përmes miqve të saj të fuqishëm europianë.

Duhet të jetë e qartë për lexuesin se, nuk ishte UÇK-ja pala që e kërkoi atë konferencë ndërkombëtare dhe atë marrëveshje, sepse nuk ishte ajo pala humbëse. Dhe, sikundër rezulton, konferenca është kërkuar nga Serbia, pasi po shihte humbjen e saj. Për këtë arsye Hashim Thaçi nuk kish pse të kërkonte pezullimin e luftimeve. Të gjitha këto na flasin për drejtësinë e vendimit të Adem Demaçit, i cili i mblodhi me urgjencë komandantët e zonave operative dhe u dakordua me ata për emërimin e një komandanti të përgjithshëm dhe vijimin më me ashpërsi të luftimeve sipas taktikës guerile.

Ajo kërkesë e zotit Hashim Thaçi na kujton edhe diçka tjetër: ai s'bëri gjë tjetër veçse përsëriti me zë të lartë atë që e pat deklaruar shtatë muaj më herët, zoti Xhavit Haliti, në 6 Korrik 1998, i cili ishte përpunuesi kryesor i strategjisë politike e ushtarake të UÇK-së, edhe pse komandonte nga Tirana: "*Vështirë është të fitohet lufta në Kosovë. Përkundër vullnetit të madh të pjestarëve të UÇK-së, armatimi ynë tutje ngec shumë, përballë atij që posedon Serbia… Kur ia nisëm kësaj pune, nuk kishim fort iluzione të mëdha. Madje ne jemi të befasuar se sa shpejt është popullarizuar dhe zgjeruar UÇK-ja. Ne vendosëm për të krijuar UÇK-në, sepse e pamë se Perëndimi nuk po mërzitet fort për zhvillimet në Kosovë. Pra, bindja jonë ishte që në këtë mënyrë, me zhurmën e pushkës pra, mund të kthejmë vëmendien e Perëndimit nga Kosova…. nëse nuk ndodh farë kthese spektakolare, ne nuk mund ta fitojmë luftën*"[137)]. Ndërkohë që Demaçi deklaronte të kundërtën: "*Nuk e kemi nis luftën për të provuar se a do të fitojmë, por e kemi nis për ta fituar".*

Kjo lloj strategjie ushtarako-politike e përzgjedhur prej Drejtorisë Politike, tregon se ajo e konsideronte atë luftë pa perspektivë, si një

[137)] Blerim Shala: "Vitet e Kosovës 1998-1999", Prishtinë 2000, f.111-112

lloj kryengritje fshatare, e cila, për shkak të spontanitetit dhe mungesës së organizimit e të udhëheqjes unike, nuk të çon në asnjë rezultat; prandaj dhe anglezët e quajtën "*një kryengritje fshatare dhe e fshatarëve*"[138]. Sikundër shihet, edhe strategjia e Drejtorisë Politike ishte e njëjtë me atë të Rugovës: lirinë e prisnin t'ua sillte në pjatë të argjentë Perëndimi dhe jo nga lufta e vetë popullit shqiptar. Me atë lloj strategjie Dr.P dhe Rugova donin të thoshnin: të zhyten të gjithë shqiptarët në një luftë pa shpresë, derisa të dobësohen e raskapiten dhe pastaj, pasi të jenë gjakosur e vrarë, të thirret një konferencë ndërkombëtare në interes të paqes e "humanizmit" dhe t'u diktohen kushtet që dëshiron Serbia. Dhe kështu edhe ndodhi. A thua ta kishte të vetën zoti Xhavit Haliti këtë strategji?

Ajo strategji e Drejtorisë Politike, e shprehur me gojën e Xhavit Halitit, nuk i kish pëlqyer aspak edhe Sekretares së Shtetit Amerikan, zonjës Medlin Ollbrajt, e cila u shpreh pesimiste për të ardhmen e asaj lufte: "*Në radhët e UÇK-së nuk dukej se kishte mendime xhefersoniane[139]. Duke goditur shpesh ku të mundnin guerilet dukej se ishin të vendosur t'i nxisnin serbët të kundërpërgjigjeshin në shkallë të gjerë, në mënyrë që të siguronin ndërhyrjen ndërkombëtare*"[140].

Me këtë lloj strategjie të saj ushtarake jo sulmuese, Drejtoria Politike veçse e detyronte UÇK-në të ishte inferiore në çdo moment dhe, natyrisht, si e tillë, ajo do t'i nënshtrohej në çdo rast çdo lloj presioni ndërkombëtar, duke u shndërruar si një lloj kopeje që e shpien në therrtore. Dhe, ç'është më e keqja, ata të Dr.P ende krekosen me atë lloj "strategjie": "*Lufta Guerile i konvenonte UÇK-së,* -shkruan sot e gjithë ditën z.Jakup Krasniqi-*, por masat e regjimit kriminel të Beogradit ishin të paparashikueshme, ata po hakmerreshin mbi*

---

[138] James Pettifer & Miranda Vickers "Çështja shqiptare", Tiranë-Newyork, 2007, f. 183

[139] Tomas Xheferson, autori kryesor i Deklaratës së Pavarësisë, 4 Korrik 1776, icili thosh: Vetëm lufta mbarëpopullore siguron lirinë. (*Shih "Historia e SHBA", Tiranë,2010, f.108-110)*

[140] Madelein Albright "Zonja Sekretare", Dudaj, 2003, f.450

popullsinë duarthatë…Situata e krijuar, shkalla e lartë e luftimeve dhe e rreziqeve të mundshme shtruan para SHP ngritjen e llogoreve të luftës dhe krijimi i territoreve të lira"[141]. Sikundër shihet, e pranojnë një gjë të tillë me bindjen e plotë të një të pafajshmi që nuk di gjë dhe nuk ka frikë nga asgjë.

Mirëpo, duke e parë se edhe strategjia e "territoreve të lira" s'ishte gjë tjetër veçse luftë frontale mbrojtëse, Adem Demaçi e kritikoi atë qysh në Nëntor 1998. "*Duke marrë parasysh shpërpjestimin e forcave midis UÇK-së dhe Serbisë, atij i duket i pavend krijimi i territoreve të lira gjithandej Kosovës, por edhe pozicionimi që e përvetëson UÇK-ja për t'i mbrojtë ato, ndaj ai u sugjeron eprorëve të UÇK që të transformohen në guerile të përbërë prej njësiteve të vogla, të shpejta e të armatosura lehtë*"[142].

Si rrjedhojë e mosbindjes së udhëheqjes politike e ushtarake të UÇK-së, strategjia ushtarake e zgjedhur nga Demaçi dështoi; dhe këtu duhet gjetur përgjigjia e arsyes kryesore pse popullsia filloi të frikësohej dhe po largohej nga Kosova. Ç'ka ishte dështim për Demaçin, ishte sukses për antarët e Drejtorisë Politike dhe për LDK-në, ndaj dhe pranuan kushtet fatale, që Demaçi i kundërshtonte, pasi ishin në favor të Serbisë.

Mos vallë, shkaku i prishjes së njësisë së mendimit dhe veprimit midis Demaçit dhe Drejtorisë Politike, përbënte ndryshimin në strategji midis tyre?

Të përcaktosh qysh në fillim strategjinë më efikase të një lufte çlirimtare do të thotë të përcaktosh karakterin e gjithë periudhës së asaj lufte; do të thotë të përcaktosh, si me thënë, nëntë të dhjetat e fatit të të gjithë luftës. Në këtë gjë konsistonte detyra e strategjisë së luftës guerile e përzgjedhur nga Demaçi.

Ndërsa strategjia e Drejtorisë Politike, e përzgjedhur dhe e shprehur prej zotërinjve Xhavit Haliti, Hashim Thaçi, Azem Syla, Kadri Veseli,

---

[141] Jakup Krasniqi, "Kthesa e Madhe", f.82

[142] Shkëlzen Gashi :"Demaçi-biografi", f. 150

Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, nuk garantonte fitore; ajo karakterizohej nga një shabllonizëm i pakrahasueshëm, që predikonte komandimin jo unik si dhe luftën e karakterit lokal shumë të ngushtë, të cilën na e shpreh qartë ish-komandanti i Zonës së Tretë Operative të UÇK-së, Ramush Haradinaj: "*Lufta në Kosovë është bërë nga komandantët e zonave. Nuk është bërë nga drejtoritë politike. Këtu duhet të jemi të qartë. Drejtoritë politike kanë mundur të veprojnë edhe prej Hëne. Qëndrimi i Drejtorisë Politike në Kosovë është identifikuar me lëshimin e komunikatave në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-s, që mendoj se nuk është ndonjë vlerë e jashtëzakonshme"*[143].

Kurse strategjia e Adem Demaçit karakterizohej nga metoda dialektike në studimin dhe vlerësimin e elementëve për sulme të vazhdueshme, që përcaktojnë mënyrën e fitores së luftës për çlirim; ndërsa strategjia e Drejtorisë Politike përcaktohej "*në ngritjen e llogoreve të luftës dhe krijimin e territoreve të lira*", duke i angazhuar të gjitha forcat e UÇK-së në luftime frontale mbrojtëse që në ditët e para të luftës për çlirim!

Nëse strategjia e Demaçit karakterizohej nga përdorimi i drejtë dhe racional i forcave të UÇK-së, nga përdorimi i drejtë dhe jo i parakohshëm për në momentin dhe vendin e duhur, duke e përdorur luftimin mbrojtës jo si llojin kryesor të luftimit, sikundër bënte strategjia e Dr.P, por si një formë luftimi e nevojshme për t'u dhënë kohë popullsisë të evakuohej, ndërsa forcat e tjera të jepnin goditje të shpejta e të shkurtëra në shpinë e në krah të armikut si dhe në prita, në ato vende e drejtime në të cilat luftimi mund të korrte në kohën më të shkrurtër maksimumin e rezultateve; kurse strategjia e Dr.P nisej nga premisa jo reale dhe udhëhiqej nga metoda metafizike në vlerësimin e mundësive të fitores së lirisë. Kjo është edhe një nga arsyet që formacionet e UÇK-së, në shumicën e kohës rrinin në pritje të sulmeve nga forcat serbe, sesa të merrnin nismën e të sulmonin

---

[143] Bardh Hamzaj:"Rëfimi për luftën dhe lirinë", Prishtinë 1999, f. 130

armikun. "*Lufta Guerile e tipit "sulm e tërheqje nga vendi i ngjarjes", u tregua e dëmshme,* -kërkon edhe sot të na mbushi mendjen z. Jakup Krasniqi,- *sepse armiku po hakmerrej mbi popullsinë civile… Veprimi kësisoj ishte i detyrueshëm sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të përballej tash e tutje jo vetëm me luftën, por edhe me ruajtjen dhe evakuimin e UÇK-së*"[144](!!!). Dhe e gjithë kjo praktikë ishte treguesi i asaj "strategjie ushtarake" e përcaktuar nga disa persona të vetëquajtur politikë dhe ushtarakë, por pa asnjë lloj njohurish teorike apo përvoje të deriatëhershme ushtarake, si dhe politike.

Nëse do t'i referohemi përvojës së Luftës Nacionalçlirimtare të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, është krejtësisht e kundërta me atë çka na server zoti Jakup Krasniqi. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH, qysh në urdhërin e parë të krijimit të tij theksonte: "*Urdhëroheni që të gjithë të goditni pareshtur dhe pa mëshirë ushtritë e okupatorit, me pre rrugët dhe me goditë kolonat e armikut, në mënyrë që me e dëmtue rëndë, me e lodhë dhe me e detyrue të dorëzohet. Mos me pritë në asnjë mënyrë që ai të na godasë ne, por duhet të jemi çdo ditë në ofensivë, në rrugë, në kazerma, në depo me material ushtarak, dhe kudo ku ka grumbullime ushtarakë, karabinierë italianë dhe gjermanë. Në asnjë mënyrë dhe asnjë ditë batalionet, çetat e njësitet të mos rrinë me duar kryq në fshatrat, këto duhet të jenë kurdoherë në prita për të goditur armikun*"[145]. Ndaj dhe kemi të drejtë të mendojmë se shkaku i asaj strategjie që na e thekson z.Jakup, nuk ishte se *"u mbyllën rrugët furnizuese, ndaj pranuam të shkojë në Rambuje"*, por ishte mungesa e dëshirës për të luftuar.

Na vjen keq që z.Jakup Krasniqi dhe kolegët e tij e kanë ende këtë koncept për luftrat çlirimtare të popujve të robëruar, dhe kjo vjen ngaqë ende nuk e kanë të qartë se, kur durimit dhe përkuljes prej robi i vjen fundi, ato zevendësohen nga guximi dhe këmbëngulja. Ata

---

144) Jakup Krasniqi, "Kthesa e Madhe", f. 81-82

145) Dokuenta të SHP të UNÇl Shqiptare, Tiranë, 1976, f. 32

harrojnë se kur popullin e çojnë gjer në shkallën më të ulët të gjendjes prej robi, në të shuhen të gjitha ndjenjat njerëzore, të gjitha pasionet, dëshirat dhe aspiratat, me përjashtim të dy prej tyre: urrejtja ndaj robërisë dhe dëshira për liri; ata harrojnë se, sikundër shprehet filozofi B. Rasëll, "*fitorja në luftë nuk shkon përherë tek pala me burime më të mëdhenj ekonomikë*." Nuk është i denjë për lirinë vetëm ai popull, që, duke qenë i shtypur pa kufi, vijon me paturpësi dhe kokëfortësi të pajtohet me gjendjen e tij prej robi, ndaj dhe asnjëherë nuk do të mund ta fitojë atë, lirinë.

Ngaqë Dr.P kish përzgjedhur atë strategji, ndaj dhe nuk ditën të shfrytëzonin mbështetjen mbarë popullore që patën në 6-mujorin e parë të vitit 1998. Duke qenë të pa ditur në politikë dhe në drejtim të artit ushtarak, "strategët ushtarakë" të Drejtorisë Politike nuk mund ta dinin se lufta frontale mbrojtëse e praktikuar nga ana e UÇK-së është strategjia e lodhjes së guerilasve, aq shumë e dëshirueshme nga kundërshtari me ushtri klasike të rregullt, gjë që strategjia serbe e priste aq shumë atë lloj lufte të aplikuar nga zoti Jakup me shokët e tij, pasi me luftë mbrojtëse frontale, sikundër krenohej edhe zoti Ramë Buja: "*lufta e formës guerile, u zhbë ngase, numuri i njerëzve të gatshëm për t'iu bashkangjitur radhëve të luftëtarëve të lirisë ishte i madh.*"[146])! Eja dhe zbërtheje këtë lloj "strategjie"!?

Si rrjedhojë e kësaj "strategjie çlirimtare", duke u mbrojtur(!), të përzgjedhur prej Dr.P, UÇK-ja ngelej një forcë e paefekshme për Serbinë. Ndërsa strategjia e Demaçit nisej nga të dhënat dhe mundësitë konkrete që kishin formacionet e UÇK-së, sulme të shpeshta me grupe sa më të vogla, duke u udhëhequr nga metoda dialektike në vlerësimin e armatimit dhe kushteve që kish UÇK-ja.

Strategjia mbrojtëse e Dr.P, e aplikuar gjatë vitit 1998, bëri që UÇK-ja të mos mund t'i rezistonte makinerisë së ushtrisë së Millosheviçit. Ndërsa në sajë të strategjsë së luftës guerile, e aplikuar në shumicën e rasteve në luftimet gjatë periudhën prej 20 Marsit 1999 e deri në

---

[146]) Ramë Buja "Konferenca e Rambujesë", Prishtinë, 2006, f.54

fund të luftës, (por që Demaçi pat këmbëngulur qysh në 15 Gusht 1998, por e vendosur kolegjalisht në mbledhjen urgjente të SHP më 20 Mars 1999), UÇK-ja arriti të fitonte jo vetëm respektin e Presidentit Amerikan Bill Klinton, i cili në fund të Prillit 1999 tha se "*UÇK-ja është bërë e papërmbjatëshme*", por në mënyrë të vaçantë ajo fitoi besimin e forcave të NATO-s, ndaj dhe Uesli Klark pohon, duke thënë: "*UÇK-ja, shpesh i detyronte forcat serbe të dilnin në terren të hapur, ku ne kishim mundësi t'i sulmonim ato*"[147]; ndërsa Ministri i Mbrojtjes së SHBA, z. Cohen, në 16 Prill 1999 thoshte: "*Millosheviçi mund të mendojë se e ka eleminuar UÇK-në, por gabon*"[148].

Strategjia dhe taktika guerile, e përdorur me mjeshtëri në luftimin e shkallës operative në datat 31 Mars e 1 Prill 1999, në bjeshkët e Berishës dhe ato të Kravaserisë (Pagarushë), i dha zjarr të madh përdorimit të asaj taktike. Luftimet e datës 31 Mars-1 Prill 1999, sipas taktikës partizane, përbënin një nga luftimet më të mëdha të deriatëhershme të shkallës operative, me pjesmarrje të gjerë të forcave të UÇK-së[149], e cila tregoi një shembull të shkëlqyer të qëndresës popullore dhe të lidhjes së ngushtë të forcave tona çlirimtare me popullsinë. Taktika guerile i dha vrull luftës çlirimtare dhe thelloi krizën në forcat pushtuese, duke i dhënë UÇK-së tiparet e një ushtrie të rregullt guerile (partizane), gjë që vërtetoi se kur ne morrëm atë vendim e kishim studjuar mirë situatën dhe i kishim bërë mirë llogaritë; dhe, sikundër dihet, pas asaj disfate forcat ushtarako-policore serbe filluan të merrnin masa të rrënda terrori e genocidsite.

Duke qenë se e përdorëm me mjeshtëri taktikën guerile, ndaj dhe shkëlqyen forcat e zonës së Drenicës në luftimet e datave 20 - 31 Mars; po ashtu edhe forcat e zonës së Dukagjinit në luftimet e mëvonshme, sidomos në Dushkajë, apo ato të zonës së Llapit e të

---

[147] Wesley K. Clark "Të bësh luftë moderne", Prishtinë, 2003, f. 372

[148] Eilen Yan: "High Risk of Casualties", Newsday, 16 Prill 1999, marrë prej Hajrudin S.Muja "Lufta e Kosovës në shtypin amerikan", f. 351

[149] Shih me gjerësisht: Shpëtim Golemi "UÇK dhe Kadare", Prishtinë, 2004, f. 130-132

Bajgorës gjatë muajit Prill, si dhe të Br153 në Gollak gjatë muajit Maj 1999. Pa taktikën e luftës guerile nuk do të kish qenë e mundur mbrojtja e popullsisë 400 mijëshe që i qe bashkangjitur formacioneve të UÇK-së. Ato fitore tregojnë, pik së pari, se formacionet e UÇK-së, përmes strategjisë dhe taktikës së luftës partizane i kapërcyen me sukses të gjitha provat në zjarrin e luftës të imponuar nga operacioni "Patkoi", duke treguar vitalitetin e tyre të plotë. Prandaj dhe zëdhënësi i NATO-s, Xhimi Shi (Jemie Shea), pat thënë: "*Sikurse feniksi që rritet nga hiri, UÇK-ja ka mundësi të ndërmarrë një numër sulmesh brenda Kosovës*"[150] dhe kjo, si rezultat i atyre sulmeve të suksesshme të UÇK-së, sipas taktikës së luftës partizane.

Me këto fakte që shprehëm nuk është fjala për të ditur se lufta guerile ka vitalitet apo jo, sepse pas përvojës konkrete të asaj lufte, asnjë skeptik nuk do të kishte guximin të shprehte dyshimin në lidhje me atë lloj lufte të UÇK-së, sepse lufta partizane (guerile) është forma më e mirë e organizimit të një lufte çlirimtare kundër një pushtuesi shekullor, por duam të themi se me atë lloj strategjie UÇK-ja përballoi të gjitha vështirësitë e luftës gjenocidiste serbe të Operacionit "Patkoi", duke provuar vitalitetin e asaj strategjie të sugjeruar nga Adem Demaçi qysh ditën e parë të pranimit prej tij të detyrës së Komisarit Politik të UÇK-së. Por, për fat të keq, zoti Jakup Krasniqi edhe sot e kundërshton atë fakt fatlum, duke na thënë: "*Ndonjë tjetër është angazhuar për të shkruar, jo për të ndriçuar një ngjarje të rëndësishme, por për të falsifikuar të vërtetën se gjoja luftën na e paskan "udhëhequr" profesionistët, se aty apo këtu ishte nisur lufta e vërtetë. Qëllimi është i qartë, dikush do që të shkëpusë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nga djepi i saj – Prekazi*"[151](!) Me këtë "argument" prej amatori, zoti Jakup mundohet të na mbushi mendjen se vendi çlirohet duke luftuar vetëm në mbrojtje dhe duke u vrarë të

---

[150] The New York Times, 17 Prill 1999; "U.S. Holds Yugo Officer as PO", Daily News, 17 Prill 1999; marrë prej Hajrudin S.Muja "Lufta e Kosovës në shtypin amerikan", f. 351

[151] Jakup Krasniqi, "Kthesa e madhe", f. 11

gjithë, duke u munduar të na mbyllë gojën me këtë krahasim; dhe tjetra, sipas tij, se lufta çlirimtare fitohet nga ata që nuk janë profesionistë të luftës guerile(!!!) Kur flet për teorinë e luftës një amator qenka gjë shumë e bezdisshme. Ç'paska heq i shkreti Demaçi!

Ngaqë Drejtoria Politike i imponoi këtë lloj strategjie ushtarake UÇK-së, mundi t'u jepte argumenta kritikuesve dhe skeptikëve ndaj forcës dhe aftësive të UÇK-së, deri në atë nivel sa të hidheshin parulla disfatiste të tilla si: "*Të niset lufta kundër Serbisë dhe Jugosllavisë, me AK-47, njimend ishte Mission Impossible*", sikundër shkruante publicisti Blerim Shala [152], apo *"Kosova nuk mund të çlirohet dot me luftë kaçakësh"*[153], sikundër shprehej historiani Zekeria Cana, etj, etj.

Strategjia e Demaçit ndryshonte rrënjësisht edhe me strategjinë e ushtrisë serbe, e cila karakterizohej nga mbivlerësimi i disa armëve (si artileria dhe tanket), si dhe nga nënvleftësimi i UÇK-së; ndërsa strategjia guerile e Demaçit karakterizohej nga vlerësimi i drejtë i armikut dhe i mundësive të forcave të UÇK-së, prandaj ai e ka prsëritur disa herë se strategjia e UÇK-së duhej të karakterizohej nga organizimi i sulmeve të rrufeshme në të gjithë territorin e Kosovës, sipas taktikës "godit e ik" (godit si rrufeja dhe zhduku si era), pa të cilën nuk mund të ketë fitore për një ushtri çlirimtare popullore.

Lufta jonë çlirimtare guerile nuk qe vetëm një mallkim, ajo qe njëkohësishtë një shkollë e madhe në të cilën populli shqiptar në Kosovë dhe forcat e tij politike u vunë në provë dhe u vërtetua. Ajo luftë nxorri në shesh të gjitha faktet dhe ngjarjet, duke grisur pamëshirë të gjitha mbulesat dhe maskat që fshihnin fytyrën e vërtetë të forcave politike e ato të "*shtetit paralel*" në Kosovë, duke i paraqitur në skenën e historisë pa maskë, me të gjitha të metat dhe cilësitë e tyre.

Miklimi me Qeverinë e Përkohëshme

---

[152] Blerim Shala, "*Vitet e Kosovës 1998-1999", Prishtinë, 2000, f. 10*

[153] Zekeria Cana "Ditari i Robërisë",v.2, f. 100

Nëse anëtarët delegatë të UÇK-së nuk do të ishin lidhur vullnetarisht me zinxhirë politikë, ata, gjatë qëndrimit në Rambuje, do ta kishin marrë seriozisht situatën në dorë dhe do ta kishin mbrojtur UÇK-në nga shuarja e saj. Ndryshe, do të largoheshin. Por, diplomatët ndërkombëtarë, duke parë që anëtarët e Drejtorisë Politike të UÇK-së ishin të pa regjur me intrigat e diplomacisë, si dhe kishin ardhur pa u konsultuar nga i kalituri me përvojën e tij politike 38 vjeçare të burgjeve të Jugosllavisë, menjëherë i mikluan, duke përdorur marifetin e ngritjes dhe përbërjes së një Qeverie të Përkohëshme për Kosovën (QPK), një qeveri koalicioni (por jo si ajo që do të mund të delte nga Asamblea Qytetare), sidomos tani që situata politike kish marrë një kthesë serioze. Kush ka etje për pushtet ëndërron atë që i do qejfi.

Me sa u pa më vonë, me këtë marifet, antarëve të UÇK-së në Rambuje u kishin gjetur zemrën. Gjithçka që i shërben vetëm vetëvetes është e keqe, qoftë ajo shkencë, politikë, letërsi, art apo dhe fé. Sa shpejt e lëshojnë veten njerëzit para miklimit, sidomos kur u afrohet pushtet (!)

Dhënia e së drejtës delegatëve të UÇK-së për të formuar QPK-në, ishte dëmshpërblimi që i jepej Drejtorisë Politike me që pranonte eleminimin e UÇK-së, por edhe me një kosto tjetër jo të vogël: do të ringrihej nga balta ku kish rënë Rugova dhe partia e tij. E megjithatë Hashim Thaçi e ndjente se, me nënshkrimin e atyre kushteve të disfavorshme për Kosovën, veçanërisht për UÇK-në, po shkelte me të dy këmbët betimin e UÇK-së, dhe këtë e ka shprehur vetë në fjalët që i thotë Xhejms Rubinit në Kështjellë, disa momente para se të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë: “kam frikë për jetën time!... Ai ruante lëkurën e vet”.[154)]

Por, ja që ishte miklimi me pushtetin që Thaçi dhe Drejtoria Politike u trullosën, u magjepsën dhe u përgjumën. Pushteti është drogë e fortë. Po të mos ishte e tillë etja për pushtet, politikanët nuk do të

[154)] Madeleine Albright “Zonja Sekretare”, f. 470

mashtronin paturpësishtë gjatë fushatave elektorale.
Kjo është arsyeja kryesore pse këta njerëz, sot e gjithë ditën falënderojnë Rambujenë[155]. Dhe këtë e bëjnë ngaqë garantuan pushtetin, duke bërë kurban UÇK-në. Ndaj dhe ata kanë 15 vjet që nuk guxojnë me thënë se lirinë në Kosovë e solli UÇK-ja duke bashkëvepruar edhe me NATO-n, por thonë të kundërtën[156].
Për delegatët pa përvojë diplomatike të UÇK-së, (themi të UÇK-së, pasi anëtarët e tjerë të atij delegacioni ishin thjesht për dekor dhe për ringjallje), ishte e pamundur ta kuptonin "ofiçinën" e diplomacisë. Duke qenë se në diplomaci nuk ka ligje dhe regulla të qëndrueshme, diplomatët europianë iu përveshën UÇK-së, duke u nisur nga paragjykimet që kishin krijuar për të. Faktet që mundoheshin të sillnin anëtarët e Drejtorisë Politike nuk luajtën asnjë rol, të cilat na i dëshmojnë në librat e tyre zotërinjtë R. Qose, J. Krasniqi, E. Tahiri e R. Buja. Detyra e diplomatëve është që të mos i japin palës tjetër asnjë epërsi, se vetëm kështu mbrojnë interest e qeverive të tyre, të cilat nuk janë argumentë juridikë e që mund të debatohen. Dhe të gjithë diplomatët profesionistë ia arritën qëllimit, asnjë pikë e projekt-marrëveshjes nuk u ndryshua!
Por ajo mbledhje pati edhe dy të mira: delegacioni kosovar bëri një muaj konvaleshencë dhe, e dyta, nuk u nënshkrua marrëveshja nga serbët, të mirën e sëcilës do ta trajtojmë në vijim.
Jo më kot i argasuri në vuajtje, Adem Demaçi ngulte këmbë që gjithçka duhej bërë para se të niseshin për në këtë Konferencë.
Rezultati përfundimtar i asaj konvaleshence në kështjellën mesjetare, ku Napoleon Bonoparti kaloi natën e fundit të tij si Perandor, erdhi ngaqë delegatët e UÇK-së, në vend që të bënin diplomaci, bënin politikë për pushtet. Mirëpo, në aktivitete të këtij karakteri po bëre

---

155) "Me marrëveshjen e Rambujesë u krijua mundësia e intervenimit të NATO-s ndaj caqeve të ushtrisë serbe në Kosovë". Hashim Thaçi, me rastin e 15 vjetorit të fillimit të bisedimeve në Rambuje, (***"Express", 05 Shkurt 2014).***
156) Po aty

politikë me synimin për pushtet, nuk udhëhiqesh kurrë nga ndjenjat dhe interest e vendit, por vetëm nga interest partiake, personale apo grupore. Antarët e Dr.P u mikluan aq shumë kur u besuan mandatin e krijimit të Qeverisë së Përkohëshme, sa u ishte mbushur mendja se gjithë bota po i kthente sytë nga ata. Gjë që edhe ndodhi.

Delegacioni i UÇK-së, ndoshta e lidhi ofrimin e QPK-së dhe veten me kushtet demokratike për vetëvendosjen. Mirëpo ky vetëmashtrim i tyre vinte ngaqë ata nuk e dinin se përse ekzistojnë në botë diplomatët, të cilëve shpesh ua ka ënda të kërkojnë ato fakte që i duhen diplomacisë së tyre. Diplomacia është një lloj arti, jo si shkencat e tjera ku të gjithë fenomenet pleksen midis tyre dhe ndikojnë në njeri-tjetrin, por një lloj arti ku secili sheh vetëm interest e vendit të tij dhe jo të vetat personale; ndaj dhe shkrimtari Mark Tuen thoshte se, "*Diplomacia është një lloj shahu, ku popujt zihen në mat-pozicion.*"

Delegatët kosovarë pa dyshim që i kanë përfytyruar bisedimet e Rambujesë si një komedi me role të caktuara paraprakisht, ndaj dhe shkuan sikur venin në dasëm, duke harruar që serbët nuk e harrojnë diplomacinë edhe kur bëjnë shaka (hajgare), të cilëve u rreh çekani kurdoherë: vetëm për Serbinë. Këta thjeshtarakët tanë "demokratë" fluturonin nga gëzimi kur mendonin dhe shihnin sesi shumë figura të larta diplomatike të Perëndimit po merreshin me ta seriozisht; si të tillë, ata shkriheshin nga entusiazmi që u zjente përbrenda, entusiazëm që mbyteshin në një pikë ujë, ngaqë secili prej tyre ishte i etur për pushtet e lavdi.

Kalimi i UÇK-së në sulme të përgjithshme - një armë e mirë diplomatike.

Krahas këmbënguljes për mospranimin e 10 kushteve vdekjeprurëse për Kosovën dhe UÇK-në, Demaçi ishte edhe për vijimin e sulmeve nga ana e UÇK-së, deri sa të ishin serbët ata që të kërkonin me zë të lartë paqen. Për Demaçin, kalimi i UÇK-së në atë periudhë në sulme të përgjithshme, ishte një lloj diplomacie ushtarake në favor të delegacionit shqiptar. Ai dhe komandantët e zonave operative ishin të

bindur se fati i Kosovës do të niste fillimisht me vendosjen e një balance të forcave, duke luftuar në terren dhe pastaj në tavolinën e bisedimeve. Për këtë arsye Demaçi kërkonte ta zvarriste edhe më shumë Konferencën Ndërkombëtare, sepse, duke e zvarritur atë dhe duke u kërkuar forcave të UÇK-së në terren që të ndërmerrnin sa më shumë sulme masive të gjithanshme, (duke i ardhur kështu në takim diplomacisë amerikane), me synimin që balanca ushtarake të peshonte në anën e UÇK-së. Kjo gjë do të sillte përmirësimin e pozitës negociuese të UÇK-së, duke bërë të mundur të sillte edhe oferta më të mira. "*Diplomacia ka sukses kur ke në dorë një forcë të konsiderueshme*", thoshte Napoleon Bonoparti.

Demaçi i bënte këto llogari, pasi ai bën pjesë në atë lloj kategorie njerëzore që e di mirë punën e tij. Një njeri që e di mirë punën e tij diplomatike, vlen më shumë se një delegacion me dhjetra diplomatë e me dhjetra baule me dokumenta. Kjo aftësi dhe ky qëndrim i Demaçit, duke u kundërshtuar nga faktori diplomatik europian, zbulonte hipokrizinë e prapaskenës së Rambujesë. Për këtë arsye Demaçi u akuzua puçist edhe nga Kadareja pse këmbëngulte të mos realizohej ajo marrëveshje e heshtur ndërkombëtare kundër UÇK-së, e cila parashihej në projekt-marrëveshjen e përgatitur me arrogancë e pa asnjë lloj finese, duke u munduar t'u mbushte mendjen shqiptarëve se: e bardha nuk ndryshonte aspak nga e zeza.

Nëse UÇK-ja do të kish ndyshuar strategjinë luftarake të saj, duke kaluar në atë të taktikës partizane (guerile), për të cilën këmbngulte Demaçi qysh në Gushtin e vitit 1998, por edhe sikur ajo të kish nisur ta zbatonte masivisht taktikën guerile edhe ato ditë Janari, pas shkëmbimit të robërve, bisedimet në Rambuje do të ishin në interes të UÇK-së dhe të Kosovës. Jo ajo që s'ndodhi, por delegatët e UÇK-së kërkuan ndalimin e luftimeve porsa vunë këmbët në Kështjellë! Ai propozim kosovar tregon se delegatët tanë as atëherë e as sot nuk e kuptuan se pse ajo Konferencë bëhej me aq urgjencë, për mos të thënë gjë tjetër.

Si mund t'ia mbushje mendjen Demaçit se me eleminimin e UÇK-së

garantohej liria e Kosovës?! Dhe kujt! Adem Demaçit (!), i cili ishte rrahur me vaj e me uthull, jo pak, por 28 vjet nëpër burgjet e Serbisë. Kjo ishte arsyeja pse Demaçi habitej dhe nuk mund ta konceptonte se mbi ç'baza detyrohej Drejtoria Politike të pranonte kushte të tilla! Apo mos vallë kishin pranuar të vendosej në Kosovë një pushtet i tillë që të ishte mik dhe i parrezikshëm për Serbinë e të mos kërkonte kurrë vetëvendosjen e shqiptarëve në Kosovë?! Dhe, me sa dimë, kjo e fundit është theksuar në Kushtetutën e Kosovës. Dhe, një qeveri e tillë nuk mund të bëhej pa LDK-në dhe satelitët e saj.

Ajo projekt-marrëveshje e inkurajonte Millosheviçin ngaqë ia bënte të qartë se UÇK-ja nuk kish aleatë as në Kosovë dhe as jashtë Kosovës; ia bënte të qartë se UÇK-ja mbetej e izoluar dhe se ushtria e tij në këtë rast mund ta sulmonte UÇK-në pasi nuk do të kishte mbështetje, duke e rrudhosur gjithnjë e më shumë pa rrezikuar që mund të haste në një rezistencë edhe nga ana e NATO-s dhe vendet e G-8. Ishte ky inkurajim që e çoi Serbinë në hartimin e planit të Operacionit "Patkoi". Në këto kushte nuk është për t'u habitur pse Adm Demaçi do të delte kundër asaj projekt-marrëveshje.

Kur Demaçi u bind përfundimisht se antarët e delegacionit kosovar në Rambuje ishin të vendosur ta eleminonin UÇK-në, ai, në 2 Mars 1999, dha dorëheqjen nga funksionet që kish për luftën, duke u shndërruar në një qytetar i thjeshtë, i bindur se në të ardhmen, atij nuk do t'i besohej më asnjë detyrë në institucionet kukulla të Kosovës; ndoshta mund ta "qetësonin" me nderime të tjera, por kurrë që t'i besohej pushtet. Dorëheqja e tij tregonte se në të ardhmen njerëzit plastelinë të Kosovës shumë shpejt do të bëheshin miqtë më të mirë të shumë prej diplomatëve dhe politikanëve proserbë. Kjo është ligjësi e çdo pushtuesi. Dhe kjo e trondiste atë. Demaçi e gjykonte gjithçka nga pikëpamja e interesave të Kosovës, pasi e kish të qartë rëndësinë që kish Kosova kukull për interesat dhe sigurinë e diplomasisë europiane dhe asaj sllave në Ballkan, se vetëm kështu mund t'ia arrijnë qëllimit që amerikanët të mos ua zenë vendin në këtë gadishull. Dhe kjo politikë e nëndhéshme europjane bëhet

ngaqë e dinë se interesi i Amerikës kërkon që kombet e vegjël të jenë miqtë e tyre, pasi ata janë mbështetja kryesore e tyre në Evropë.

Pse Demaçi dha dorëheqjen nga detyra që i pat ngarkuar SH.P. i UÇK-së?

Adem Demaçi kishte jetuar shumë gjatë jashtë rrethit të njerëzve të atij kallëpi, që e fyen. Si në burgjet e Jugosllavisë ashtu edhe në opinionin shqiptar të ish-Jugosllavisë atë e mbanin përveç si një hero, edhe si një dijetar erudit dhe, ai vendosi të largohej nga këta njerëz kur e pa se rruga e tyre ishte pa kthim prapa, duke menduar me vete se është më mirë të rish vetë larg njerëzve të tillë karjeristë sesa të të nxjerrin ata jashtë rrethit të tyre, të cilët tallen me gjithçka që ndryshon nga qëndrimi i tyre. "*Ata që ma kishin dhënë para gjashtë muaj të drejtën për të folur në emër të tyre, ata edhe pas gjashtë muajsh, ma morën atë të drejtë. Ata më patën ofenduar, ata më patën goditur në shpirt. Prandaj unë dhashë dorëheqje, sepse nuk kishte kuptim që t'u shërbeja edhe më tutje atyre që menduan atëherë se e dinin politikën më mirë se unë dhe se, në synimet e tyre, për t'u bërë "liderë politikë". Ademi i ngratë me bashkëpuntorët e vet, ishin pengesë*"[157], përgjigjet vet Adem Demaçi.

A duhej që Demaçi të jepte dorëheqjen në ato momente?

Faktet tregojnë se Demaçi nuk e kish menduar dorëheqjen deri një ditë më parë se ta bënte atë veprim. Përkundrazi, ai kish menduar kompromisin midis tij, Drejtorisë Politike dhe Shtabit të Përgjithshëm, ku bënin pjesë edhe komandantët e zonave operative. Për këtë qëllim u përpoq të organizonte atë mbledhje të përbashkët, (ndoshta përfshi dhe LKÇK-në), ku të analizoheshin të mirat dhe të këqijat që do të pasonin për Kosovën dhe UÇK-në prej aktit të mosnënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë, ose nënshkrimin me kushte. Vetëm kompromisi të shpëton nga kolapse të tilla. Adem Demaçi këtë demarsh e ka bërë në datën 1 Mars 1999, porsa kthehen delegatët e UÇK-së nga Rambujeja dhe mbrijnë në Kosovë, pas fazës së parë të

---

[157] Adem Demaçi: "Liria dhe joliria", f.28

Konferencës së Rambujesë.
Sikundër do ta shohim më poshtë, edhe ky demarsh i Demaçit dështoi, pasi ishin marrë masat shumë më herët që Demaçi të dështonte në misionin e tij: Dimë se Demaçit propozimin, në Gushtin e vitit 1998, për të qenë përfaqësuesi politik i UÇK-së ia bënë në emër të Drejtorisë Politike Xhavit Haliti dhe Azem Syla dhe jo drejtori politik i saj, z.Hashim Thaçi, edhe pse edhe ky ato ditë ishte në Tiranë! Rezulton, gjithashtu, që Adem Demaçi nuk ka kontaktuar në asnjë rast me Drejtorin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçin, prej 13 Gushtit 1998 deri në Shkurt 1999, kur ai shkoi në Rambuje; edhe atëherë me telefon! Bazuar në rrjedhën e mëpasme të ngjarjeve, që tashmë dihen, nuk gabojmë të themi se Hashimi i ka qëndruar qëllimisht larg Demaçit që ky i fundit ta kuptonte se kryesori i politikës së luftës në Kosovë ishte Hashimi, ndërsa Demaçi thjesht një i deleguar prej tij në Prishtinë ku, për çdo veprim të tij do të merrte miratimin e Hashimit përmes zëdhënësit të SHP, Jakupit. Dhe, me sa kuptohet, Demaçi ose nuk e ka vlerësuar ose nuk e ka vënë re këtë zgjedhje të Hashimit.
Meqenëse Hashimi arriti ta tundonte Jakupin, duke e nxitur të sabotohej Asambleja Qytetare edhe nga Shtabi i Përgjithshëm, erdhi momenti që ta përdorte Jakupin edhe për t'i hapur rrugën për Kryeministër. Kjo kërkonte që përsëri duhej luftuar kundër Demaçit, pasi ai ishte pengesa më serioze. Dimë që në Rambuje, me pëlqimin edhe të amerikanëve, u pranua nga i tërë delegacioni kosovar që të krijohej Qeveria e Përkohëshme (QPK) dhe mandatori i saj të delte nga UÇK-ja. Dimë, po ashtu, që Rugova e pranoi atë qeveri kalicioni me një kusht: që *mandatori i saj të ishte Jakup Krasniqi*[158]. Këtu Hashimi manovroi me shumë shkathtësi. Kërkoi që të ndërpritej konferenca, pasi i duhej që "*të konsultohej me komandantët në terren dhe me SHP*". Mirëpo, që të eleminohej pengesa Demaçi, duhej që ai të jepte dorëheqjen, ndryshe, nëse mblidheshin komandantët e

[158] B. Shala "Vitet e Kosovës", f. 282

zonave operative dhe SHP, të cilët dy-tri javë më parë e kishin zgjedhur Demaçin Komisar të Përgjithshëm të UÇK-së, Demaçi do të ishte kandidatura e vetme për Kryeministër. Dhe mënyra u gjet: Fillimisht shkuan në Kosovë Jakup Krasniqi, Ramë Buja dhe Azem Syla, të cilët, kuptohet, duhet të kenë marrë për detyrë që ta detyronin Demaçin të jepte dorëheqjen dhe më pas ishte e lehtë manipulimi veç e veç i komandantëve për propozimin e Hashimit për Kryeministër.

Dhe skenari u realizua lehtësisht.

Demaçi shkoi në Drenicë për kompromisin midis tij, Drejtorisë Politike dhe Shtabit të Përgjithshëm, i shoqëruar nga Albin Kurti dhe shoferi Shasivar Makolli, ku takohet me antarët e SHP të UÇK: Azem Syla, Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi, Lahi Brahimaj dhe Ramë Buja. Ai shkoi për t'i bindur duke shfrytëzuar kryesishtë po ato argumenta që vet ata i kishin përdorur në Rambuje; për t'i bindur se ato kushte që i imponoheshin UÇK-së qenë vetëm një humbje e rëndë kohe, duke i quajtur punimet e deriatëhershme si bisedime, ngaqë nuk ishte bërë asnjë përparim. Nëse arrihej ai kompromis, atëherë në udhëheqjen e UÇK-së do të krijohej një rregull i ri, gjë që tregon se Demaçi nuk e bënte atë përpjekje për arsye individuale.

Por, çuditërisht, ata e pritën me gjuhën e armiqësisë, "me këmbët e para". Ajo lloj pritje eleminoi kompromisin. Jakup Krasniqi, i ndihmuar nga Fatmir Limaj, e realizoi edhe këtë detyrë të dytë kundër Demaçit. Në shenjë mirënjohjeje, me të mbritur pas disa ditësh në Kosovë Hashimi e mori Fatmirin si shoqërues në të gjitha lëvizjet që bëri "për t'u konsultuar" me komandantët e zonave operative. Madje, edhe pas një muaji, kur Fatmiri u vetëemërua zevendës Ministër i Mbrojtjes, Kryeministri Thaçi nuk reagoi.

Dhe ja si ndodhi: "*Fatmir Limaj e urdhëron Demaçin të dalë jashtë nga dhoma e takimit. Fill më pas, Demaçi fillon të spjegojë përse dokumenti i ofruar në Rambuje është krejt i papranueshëm. Albin Kurti ndërhyn për ta plotësuar… Sipas Kurtit, Krasniqi e kishte ndërprerë, duke i thënë: "Ne e kemi nisë UÇK-në, prandaj ju nuk*

mund të na mësoni se si të veprojmë… Askush nuk u ka ftuar, mund të shkoni" "[159]).

Edhe i pavdekshëm sikur të ishte Demaçi, zemra do t'i kish krisur përbrenda. I shumëpësuari Adem Demaçi, nuk e priste nga Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj atë përgjigje, e miratuar në heshtje nga Azemi, Ramë Buja dhe Lahi Brahimi. I adhuruar nga të gjithë, i flakur nga Drejtoria Politike, Ai e ndjeu veten si një mall i pashitur. Shumë gjëma kish kaluar ai mes dallgëve të jetës, por ja që duhej edhe kjo bashkë me të tjerat. Ju prenë zemër e gjunjë që nuk ia mundësuan shpresën e fundit të shpëtimit të UÇK-së nga vdekja. Ai u kurbanizua si individ, e cila u bë në emër të cinizmit politik, e kamufluar në emër të interesave gjoja fisnike të Kosovës. Dhe si zgalem fluturimthi doli jashtë i zhgënjyer dhe i lodhur nga humbja, por edhe i vetëm sepse ishte i vetëm. E megjithatë në moment iu lartësua krenaria nga bindja se nuk do ta thyenin dot, ajo krenari e burrit që nuk pranon të përkulet as para perëndive, as para frikës së tragjedisë së individit që nuk përshtatet, që nuk dorëzohet, që arsyeton me kokën e vet dhe për këtë arsye vdes i vrarë nga të gjithë.

I ngopur me vuajtje, ai u nis për në Prishtinë, pa u ankuar, edhe pse e shihte me sy vdekjen e UÇK-së. "*Për Demaçin mund të shkruhet gjithçka, por mund të thuhet vetëm një: është një histori e gjallë në lëvizje e sipër dhe si e tillë të detyron jo vetëm respektin, por edhe dashurinë; jo vetëm dashurinë, por edhe përcaktimin. Mund të jesh me të, përbri tij, por nuk mund të jesh indiferent ndaj tij.*"[160])

Veprimtaria politike e Demaçit të bind se gjithkush mund të jetë dikushi nëse ndjek rrugën e shpëtimit të popullit, që është shembulli i individit që revolucionarizon vetveten. Por e vërteta është se ne nuk dimë t'i kushtojmë tërë dashurinë tonë një personi të spikatur progresist, dhe, edhe kur duam të sillemi me nderim ndaj tyre, më tepër respektojmë veten tonë. Vetëm mjedisi që i rrethon këta njerëz

---

[159)] Shkëlzen Gashi "Adem Demaçi, biografi", Prishtinë, 2010, f. 168-169

[160)] Ukshin Hoti, vepër e cituar, f. 176

është i aftë ose t'i ngrerë në majat më të larta të filozofisë ose t'i gremisë në humnerat më të neveritshme.

Një konsultë të tillë, sikundër kërkoi Demaçi në 1 Mars 1999, për nënshkrimin a mosnënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë, atë ditë e prisnin edhe vetë komandantët e Zonave Operative. Dhe këtë na e dëshmon komandanti i zonës së tretë operative, Ramush Haradinaj, i cili thotë: "*Kam respekt të jashtëzakonshëm për Adem Demaçin, për meritat e tij si shqiptar, simbolizon ndoshta edhe periudhën e kaluar të popullit tonë si periudhë persekutimi… Mendoj se zgjedhja e Demaçit nuk ka qenë e gabuar… E kam parë duke dalë i nervozuar prej aty. Evitimi apo mënjanimi i Demaçit nga posti që ishte nuk m'u ka duk punë e mirëfilltë.…Fakti se një ditë të caktuar ky njeri, që u identifikua me ne, nuk është më, nuk më ka pëlqyer. Nuk kam pasur të qartë se pse veprohej kështu. Ne, komandantët e zonave kemi kërkuar të ballafaqohemi me të.*"[161])

Dorëheqja e Demaçit, përveç që i hapi rrugën Hashimit për Kryeministër, ajo entusiazmoi edhe gjithë ish-nëpunësit kosovarë që i patën shërbyer me zell Serbisë në 20 vitet e fundit, pasi u garantuan se me ardhjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe më pas të koalicionit qeverisës UÇK-LDK, ata do të rikthehesin në po ato vende pune që kishin pasur më parë. Dhe nuk u gabuan.

E gjithë kjo tregon se, mosmarrëveshja midis Adem Demaçit me Drejtorinë Politike dhe SHP të UÇK-së, nuk vinte nga moskuptimi prej tyre i pasojave që rridhnin nga pranimi i 10 kushteve të panegociueshme të projekt-marrëveshjes së Rambujesë, por ngaqë kjo anëtarësi bënte dredhi të organizuar, duke bërë të paditurin për pasojat që do të rridhnin prej atyre kushteve; thjesht për interesa grupore. Me atë veprim "*Qëllimi i tyre, -* shkruante tre ditë më pas, në 5 Mars 1999 Fazlli Veliu, i cili e udhëhoqi LPK-në për një dekade të tërë, deri në Maj 1998 - *ishte që të mënjanohej LPK-ja dhe me*

---

[161]) Bardh Hamzaj "Rrëfime për luftën dhe lirinë", vepër e cituar, f. 112-113

UÇK-në të veprohej sipas skenarëve të faktorëve të jashtëm"[162]).
Është keq kur lufta i nënshtrohet një interesi të përcaktuar që më parë, pasi nuk dëgjohen mendimet e kujdesshme të të tjerëve. Po kaq e keqe është kur ata që janë në krye të kryengritjes përpiqen t'ia nënshtrojnë vetes politikën e luftës. Ndaj dhe për Demaçin u bë e qartë se Dr.P dhe SHP nuk donin ta dëgjonin zërin e arsyes. Në ato rrethana, Demaçit nuk i mbetej gjë tjetër, veçse të jepte dorëheqjen; akt, të cilin e bëri ditën e nesërme. Ai e ndërmori atë veprim pasi e pa që e kish shumë të vështirë t'ia arrinte qëllimit për të cilin u mundua, sepse po ndeshej me dy verbëri: verbërinë kolektive pacifiste dhe verbërinë selektive për pushtet e lavdi, të cilat përbënin dhe përbëjnë një gënjeshtër të madhe që sundon ende Kosovën.

Çfarë do të ndodhte nëse Drejtoria Politike dhe SHP do të dakordoheshin me Demaçin që Marrëveshja të mos nënshkruhej nga UÇK-ja?

Le ta merrnin përgjegjësinë e nënshkrimit të saj forcat e tjera politike dhe të "pavarurit", që na mburren sot e gjithë ditën se kanë bërë heroizëm, ngaqë edhe përbënin shumicën e atij delegacioni kosovar. Se si do të vijonin punët më pas, atë do ta diktonin situatat që do krijoheshin, por, ama, do të ishte një vendim kolegjal dhe i përgjegjshëm i forcave politike që shpërthyen luftën dhe jo vendim i 4-5 personave. Si rjedhojë, UÇK-ja nuk do të kish disfatë përderisa nuk e ndjente veten të mundur. Mos harrojmë një përvojë të përbotshme: është i tmerrshëm ai që nuk ka më se ç'të humbasë.
Cilido që do të ishte reagimi i Fuqive të angazhuara në Rambuje, pas shpalljes së mosnënshkrimit nga UÇK-ja të Marrëveshjes, SHBA tashmë kishin shkuar shumë larg në mbështetje të Kosovës dhe UÇK-së, saqë nuk mund të tërhiqeshin nga pozitat e mbështetjes së saj, të cilës i kishin premtuar edhe referendumin, pa ngjallur një farë ndjenje poshtërimi. Vetëm e ardhmia do ta tregonte nëse Serbia do

---

[162]) Fazlli Veliu "LPK dhe UÇK, një emblem një qëllim", Tiranë, 2000, f.150

të ishte aq e fortë sa të përballonte forcën mbarë shqiptare dhe atë të opinionit publik botëror, i cili ishte haptazi me frymën luftarake në Kosovë. Madje edhe Kryemyftiu i tartarëve kazanë, Ravil Gainutdin, deklaroi se *muslimanët rusë do të nxisnin vullnetarë për të luftuar në anën e shqiptarëve*[163]).

Franca dhe Rusia nuk mund ta mbështesnin Serbinë në rast se kjo do të hynte në luftë me Amerikën. Aq më shumë që qeveria ruse nuk kish marrë asnjë zotim në këtë apo atë mënyrë. Gjithashtu, duke qenë se dëshira e fuqive të tjera europiane ishte për të ruajtur paqen në Ballkan, kjo do t'i shtynte ato të bashkonin gjithë forcat e tyre për të gjetur një zgjidhje që do të mund të pajtonte aspiratat e ligjshme të Kosovës me parimin e vetëvendosjes, edhe për faktin se Rusia nuk do t'ia lejonte vetes që Serbia ta tërhiqte për hunde, po të kemi parasysh mundësitë ekonomike të atëhershme të Rusisë.

Mirëpo, Drejtoria Politike dhe Shtabi i Përgjithshëm, duke qenë entusiastë ngaqë po u dhurohej pushteti, as u shkonte ndërmend të merrnin parasysh këto rrethana, të cilat e bënin të pashmangshme edhe ndërhyrjen me forca tokësore të SHBA.

Vetëm me këtë strategji politike të Demaçit shtyhej për në fund të luftës diskutimi zyrtar i çështjes së pavarësisë a vetëvendosjes së Kosovës, ku do të përfshihej pa dyshim edhe çështja e Kosovës Lindore dhe e kufijve me Serbinë. Në këtë rast një pajtim i plotë i Fuqive lidhur me pikat që preknin interest e tyre do të ishte absolutishtë e nevojshme, kur të vinte momenti, pavarësisht se do të bëhej a nuk do të bëhej një konferencë apo një mbledhje ambasadorësh.

Pikërisht tashti ishte momenti sipas Demaçit që, po ta refuzonin nënshkrimin e asaj lloj Marrëveshje të Rambujesë, do të ishte e sigurtë që do të merrnin pavarësinë a vetëvendosjen, pasi Amerika, meqë kish premtuar referendumin mund të lëshonte edhe më shumë rrugë e mund të rriste edhe më shumë përkrahjen, sidomos duke parë që opinioni publik shqiptar në tërë trojet shqiptare dhe në

---

[163]) Stephen Schwatz "Prejardhja e një lufte-Kosova", Prishtinë, 2005, f.137

diasporë dukej që ishte i gatshëm ta mbështeste UÇK-në në të gjitha mënyrat. Dhe faktet tregojnë se kjo gjë pritej edhe nga SHBA. Këtë na e bën të qartë deklarata e kryeministrit shqiptar i asaj kohe, Pandeli Majko, dhënë TVSH, porsa ishte kthyer nga Uashingtoni, datë 9 Shkurt 1999: "*Nëse serbët vazhdojnë të ushtrojnë gjenocid mbi vëllezërit shqiptarë në Kosovë, atëherë gjithë shqiptarët, kudo qofshin, në Mal të Zi, Maqedoni a Kosovë, kanë të drejtën e vetëmbrojtjes kolektive*"[164]. "*Në politikë asgjë nuk ndodh rastësisht*, - thotë Franklin Ruzvelt.- *Nëqoftëse ajo ndodh, atëherë të jesh i sigurtë se ajo është planifikuar të ndodhë ashtu*". Por shumëçka do të varej nga fakti nëse Shqipëria do të qëndronte bashkë me Demaçin apo me Drejtorinë Politike në këtë pikë.

A ka gabuar edhe zoti Demaçi?

Të gabosh është njerëzore; sidomos në situata të ndërlikuara dhe aq më shumë në kohë lufte. Vetëm të vdekurit nuk gabojnë. Bazuar në të dhënat dhe njohuritë që kemi sot rreth këtyre ngjarjeve që po analizojmë, mendojmë se edhe zotit Demaçi, sikundër edhe u shprehëm më lartë, i kanë shpëtuar disa raste pa u kushtuar vemendjen e duhur, në cilësinë e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së, të cilat kanë sjellë pasoja jo të këndshme.

Së pari, sikundër është bërë e njohur publikisht, zotit Demaçi, detyra e rëndësishme e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së i është propozuar nga dy persona, në cilësinë e anëtrëve të Shtabit të Përgjithshëm, Xhavit Haliti dhe Azem Syla. Mirëpo, nuk kemi asnjë lloj vendimi të Kryesisë së LPK-së, e cila pat organizuar shpërthimin e asaj; ose edhe të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që të jet marrë një vendim i tillë dhe, njëkohësishtë, të ketë autorizuar zotërinjtë Xhavit Haliti e Azem Syla t'ia afronin zotit Demaçi atë propozim! Madje edhe propozimi edhe pranimi nga ana e zotit Demaçi rezulton se janë bërë në mënyrë verbale; kur dihet që edhe nëse pranon të drejtosh përkohësishtë qoftë edhe veturën e një personi tjetër, do të

---

[164] Fehmi Baftiu: "Kosova krizë ndërkombëtare", f. 326

duhet të nënshkruhet një akt noterie midis dy palëve, e jo më për të drejtuar një luftë çlirimtare kombëtare! Ndërsa kjo lloj marrëveshje ndoshta mund të jetë unikale në llojin e vet. A është vepruar gabim nga të dy palët, në këtë rast? Fakti i mosekzistencës së një vendimi kolegjal nga një forum udhëheqës i luftës apo i UÇK-së, tregon se ata dy persona jo vetëm që atë nismë e kanë marrë në kry të vet, pa dijeninë e udhëheqjes së LPK-së apo të Shtabit të Përgjithshëm, por nuk përjashtohet mundësia që me atë propozim të kenë patur një qëllim me paramendim: për ta përdorur Demaçin për të manipuluar, qoftë edhe përkohësishtë, masën e luftëtarëve të UÇK-së dhe opinionin publik; dhe, sikundër e pamë, deri diku ata ia arritën atij qëllimi, falë sinqeritetit të zotit Demaçi.

Cila është pasoja e atij gabimi të zotit Demaçi? Demaçi, duke e pranuar atë detyrë vetëm nga këta dy përfaqësues të Drejtorisë Politike dhe SHP të UÇK-së dhe vetëm gojarisht, ai nuk mund të qëndronte më lart se programi politik i UÇK-së. Nëse ai do të këmbëngulte ta merrte atë detyrë nga udhëheqja e LPK-së dhe e LKÇK-së, (pasi SHP kish një marrëveshje të tillë edhe me LKÇK), ai do të qëndronte më lart se programi politik i UÇK-së, por edhe i atyre dy lëvizjeve politike; sepse për atë ishte thirrur, që t'i zbatonte dhe t'i përmirësonte ato programe në interes të Kosovës, të luftës në tërësi dhe të UÇK-së. Në atë rast do të ishte Demaçi, ai që do të urdhëronte SHP dhe jo ata, sikundër edhe ndodhi.

Nëse Demaçi do ta merrte detyrën përmes një marrëveshjeje serioze me shkrim nga udhëheqja politike kryesore e përbashkët, (LPK dhe LKÇK), automatikisht që nuk do të ishte Drejtoria Politike dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që do t'i thoshnin Përfaqësuesit të Politik të saj: *LARGOU!,* por e kundërta, pasi ai do të kishte mbështetjen e gjerë të atyre forcave politike. Për të arritur diçka, duhet të jesh në pozitën që mund të arrish diçka. Këtë pozitë Demaçi nuk e kërkoi kur iu afrua ajo detyrë. Dhe këtë gabim të tij Demaçi e kuptoi vonë, kur thjeshtarakët e SHP i treguan derën. Aq thellë e ka ndjerë në shpirt Demaçi atë gabim, sa edhe është hidhëruar përfundimisht edhe me

bigrafin e tij, Shkëlzen Gashin, pse ai e botoi atë fyerje që i bënë anëtarët e SHP[165], Fatmir Limaj e Jakup Krasniqi, në 1 Marsin e vitit 1999, kur i thanë: Dil jashtë!

Së dyti, Demaçi, porsa e pranoi atë detyrë, ashtu sikundër korigjoi strategjinë ushtarake të UÇK-së, duhej të kish korigjuar edhe tekstin e Betimit Ushtarak të saj, (sikundër bëri me *Ballkaninë* e tij), pasi ai tekst pasqyronte strategjinë politike të UÇK-së: bashkimin e Kosovës dhe të gjithë trojeve të tjera shqiptare nën ish Jugosllavi me shtetin amë, me Shqipërinë. Pse? Sepse ishte ende e parakohshme; sepse asnjë forcë politike legale shqiptare e të gjithë travave shqiptare nuk e kish atë mision në programin e vet. Madje nuk e kanë as sot, veç Lëvizjes Vetëvendosje. Prandaj, do të ishte mirë të bëhej çmos për ta sfumuar hë për hë atë kërkesë, pa u realizuar çlirimi i Kosovës, me qëllim që të mos kishin ku të kapesh diplomatët ndërkombëtare dhe politikanët servilë shqiptarë për të anatemuar UÇK-në. Tash që ka ardhë ajo kohë mund të gjenden disa rrugë për ta pajtuar këtë dëshirë të popullit shqiptar në Kosovë. Duke u parapublikuar ajo i ngjante tezës së Ballit Kombëtar për "Shqipërinë Etnike", kur në radhë të parë ishte Lufta për Çlirimin nga Fashizmi.

Së treti, nuk duhej që Demaçi ta neglizhonte marrëveshjen e SHP me LKÇK-në, sikundër bëri. Pse e themi këtë? Sepse dihet që: tre muaj më parë se Demaçit t'i propozohej detyra e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së, SHP i saj kish nënshkruar më 11 Maj 1998 me Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK): "*Marrëveshje për bashkim armësh në nivel vendi dhe për drejtimin politik të luftës*"[166].

---

[165] Shkëlzen Gashi "Adem Demaçi – biografi", Prishtinë, 2010, f. iii

[166] *Shih Shukri Klinaku: "Vendimi fatal", Çlirimi, Prishtinë 2000, f. 81-82*: "Takimet vazhduan në Kosovë me krerët e UÇK-së, të cilët luftonin. Më 10 Maj në Drenovc të Malishevës është arritur edhe një marrëveshje lokale ndërmjet Sabit Gashit (*Kryetar i LKÇK, D.G.)* dhe Fehmi Lladrovcit, sipas të cilës të gjithë antarët e armatosur të LKÇK-së hyjnë nën komandën e shtabit lokal të UÇK-së. Të nesërmen në takimin e zhvilluar ndërmjet Sabit Gashit e Fatmir Humollit me Rexhep Selimin, i cili fliste në emër të SHQ

Duke qenë se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e kish nënshkruar më herët një marrëveshje politike serjoze me institucionin e një lëvizje politike ilegale dhe luftarake, e cila vepronte brenda në Kosovë dhe jashtë saj, me të cilën kish rënë dakort të krijonin Frontin Politik të Luftës, njëjtë sikundër po bënte me zotin Demaçi, atëherë ky i fundit, tek ndan kaq qartë edhe ndryshimin e strategjisë së luftës së UÇK-së me të tijën, a mund të mos kërkonte prej Azem Sylës e Xhavit Halitit edhe prezencën në atë marrëveshje të përfaqësuesit të LKÇK-së? Nëse Demaçi do ta kish riaktivizuar atë marrëveshje, ai do të kishte një mbështetje edhe më të gjerë në vendimet që do të merrte, edhe pse nuk po i afrohej ajo detyrë nga udhëheqja e LPK-së.
Ndoshta zoti Demaçi nuk ka qenë në dijeni për marrëveshjen e SHP

---

të UÇK-së, nënshkruhet marrëveshja për bashkim armësh në nivel vendi. Kësaj i parapriu edhe një bisedë e gjatë ndërmjet Sabitit e Fatmirit me Rexhepin, pas së cilës, siç rrëfen Sabiti në një intervistë dhënë "Zërit" (25 Shtator 1999), Rexhep Selimi u nda më i kënaqur sesa kishte pritur. Pas kësaj ishte mbajtur takimi përfundimtar, nga i cili ka mbetur gjallë ky procesverbal: "Në takimin e mbajtur më 11.05.1998 në mes të Shtabit Qëndror të UÇK-së dhe Këshillit të Përgjithshëm të LKÇK-së, pas një vështrimi të përgjithshëm mbi rrethanat e krijuara së fundi në Kosovë është dalë me vendime konkrete që rezultojnë në bashkimin e të gjitha forcave çlirimtare në luftën e armatosur.
Këshilli i Përgjithshëm i LKÇK-së vendosi që potenciali ushtarak i disponuar nga LKÇK-ja dhe antarësia e gjerë e saj t'i jepet UÇK-së. Ky vendim është marrë duke e konsideruar bashkimin e radhëve si nevojë urgjente të imponuar nga domosdodhmëria e kohës dhe e rrethanave të luftës së krijuar në Kosovë. Në takimin në fjalë është diskutuar edhe për krijimin e Frontit Politik të Luftës, i cili do të angazhohet në mënyrë intensive për bërjen e politikës së luftës dhe do t'i amortizoi të gjitha veprimet e dëmshme politike të çdo subjekti politik të Kosovës. Rreth çështjes së Frontit Politik të Luftës u vendos që të punohet intensivisht nga të dy palët për të realizuar sa më parë këtë objektiv prioritar të luftës sonë të përbashkët..

` Shtabi Qëndror i UÇK-së — Këshilli i Përgjithshëm i LKÇK-së
Rexhep Selimi — Sabit Gashi
Mbajtur më 11.05.1998"

me LKÇK-në. Mundet që edhe Azem Syla e Xhavit Haliti nuk e kanë vënë në dijeni Demaçin për atë marrëveshje me LKÇK-në. Ose e ka ditur, por kur ka dëgjuar deklaratën e zotit Jakup Krasniqi, në fillim të Korrikut 1998, në emër të Shtabit të Përgjithshëm, kur tha se, "*UÇK-ja nuk ka nevojë për të qenë nën kontrollin e çdo force politike*", ka menduar se ajo marrëveshje ishte anulluar. Por, rrjedha e mëpasme e ngjarjeve na tregon se ajo deklaratë e zotit Jakup ka qenë inicuar nga dëshira për të mos e ndarë të nesërmen pushtetin, të nesërmen e luftës, me një forcë tjetër politike, duke menduar se një njeri i vetëm si Demaçi nuk ua rrezikonte atë qëllim. Mirëpo, është LKÇK-ja ajo që e ka vënë në dijeni zotin Demaçi pas një jave, në 20 Gusht, se ajo marrëveshje nuk qe anulluar me vendim kolegjal. Këtë njoftim LKÇK-ja e bëri përmes deklaratës së saj politike, ku theksonte: "*Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së është dashur që për një hap të tillë kapital, të konsultohet, përveç me të tjerët, edhe me Këshillin e Përgjithshëm të LKÇK-së, pasi që ka nënshkruar një marrëveshje me këtë organ të LKÇK-së*"[167]).

Madje Shukri Klinaku, përfaqësuesi i LKÇK-së në Evropë, sqaron: "*Pati tentime afrimi edhe më pas. Për shembull, disa herë kishim kërkuar nga LPK-ja në diasporë për të mbajtur tubime të përbashkëta informative dhe sqaruese në dobi të zhvillimit të luftës. Dhe, ndodhi që në Gjenevë të merreshim vesh për tubim të përbashkët. Tubimit i parapriu një marrëveshje me shkrim ndërmjet përfaqësuesve të dy organizatave, për mirësjellje përpara publikut. Publiku mirëpriti këtë paraqitje të përbashkët, mirëpo LPK-ja, siç do shihet më vonë arsyeja, kurrë nuk do ta dëshironte një tubim të tillë, e këtë e kishte ditur edhe pa këtë tubim*"[168]). Gjë që tregon se është vetë zoti Demaçi që nuk e ka marrë parasysh atë marrëveshje mes SHP dhe LKÇK-së; njëkohësisht nuk na rezulton që ta ketë marrë parasysh edhe më pas. Mos harrojmë që LKÇK-ja kishte edhe revistën ilegale

---

[167]) Gazeta "Rilindja", 21 Gusht 1998

[168]) Shukri Klinaku: "Vendimi fatal", f. 82

"Çlirimi", e cila botohej në një tirazh jo të vogël, të cilën Demaçi do ta kish një ndihmëse të pallogaritshme për të bërë udhëheqjen politike të popullit për luftë.

Duke e parë këtë fakt nga largësitë e sotme, mendojmë se zoti Demaçi e thellon këtë neglizhencë ndaj LKÇK-së, duke mos u konsultuar me atë edhe në rastin kur ai u kthye nga Shkupi, në takimin me Ministrin e Jashtëm Angles, në fund të Janarit 1999, para se të shkonte për t'u konsultuar me zotin Jakup Krasniqi ose, të paktën, të shkonin së bashku. Nuk përjashtohet mundësia që, nëse konsultohej edhe me LKÇK-në, antarët e Dr.P të mos e kishin marrë atë vendim nga hotelet e rehatshëm në Tiranë, pasi do të kishin të bënin me një forcë politike, e cila, ndryshe nga LPK-ja, i kish reshtuar në formacionet luftarake të UÇK-së të gjithë antarët e saj, rast unikal në historinë e Kosovës. Vullneti i një njeriu të vetëm, qoftë edhe i përmasave si Adem Demaçi, nuk mund të mjaftonte për një punë aq të stërmadhe; lipsen edhe njerëzit që do ta zbatojnë një vullnet të tillë. Një mendje, thotë filozofia kineze, hiç mendje, dy mendje – gjysëm mendje, tre mendje – bëjnë një mendje.

Mirëpo, edhe në mbledhjen e SHP në Abri, në fillim të Shkurtit 1999, kur u zgjodh dhe u emërua Sylejman Selimi Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe ku zoti Demaçi u zgjodh Komisar i Përgjithshëm Politik i saj, nuk na del se ka qenë prezent edhe përfaqësuesi i LKÇK-së!

Në këtë rastin e fundit, për mos thirrjen e LKÇK-së në mbledhjen e SHP në Abri, mendojmë se nuk duhet të ngelet pa përgjegjësi historike edhe zoti Rexhep Selimi, i cili ishte personi i autorizuar nga Shtabi i Përgjithshëm që e pat nënshkruar atë marrëveshje me LKÇK-në, në 11 Maj 1998.

I theksojmë këto raste si gabime të Demaçit dhe të z. Rexhep Selimi, për faktin se kanë ndikuar patjetër në rrjedhën e ngjarjeve për Kosovën, luftën dhe UÇK-në.

Ndoshta me një përgjegjësi të tillë mund të ngarkohet edhe Kryesia e LPK-së, me në krye zotin Bedri Islami, e cila na rezulton se ka

qëndruar sehirxheshë në të gjithë këto raste që i renditëm si gabime politike të zotit Demaçi dhe, nuk dimë se pse deri sot vijohet të heshtet për to! E themi këtë pasi, nuk njohim deri në këto momente të jetë publikuar ndonjë dokument nga ana e LPK-së, që të na tregoi nëse ishte anulluar marrëveshja midis LKÇK-së dhe SHP: kur, nga kush dhe për ç'arsye; por edhe për propozimin që i është bërë Adem Demaçit nga dy antarë të Sektorit të Veçantë të Kryesisë së LPK-së. Por edhe LKÇK-ja na rezulton se në këto situata dramatike të muajit Shkurt-Mars 1999, nuk rezulton se ka dalë me propozime konkrete!

Së katërti, zoti Demaçi, kur e pa se formacionet e UÇK-së nuk po kalonin në strategjinë e luftës guerile (partizane) duhej t'i kish kërkuar llogari Drejtorisë Politike dhe SHP për mos zbatimin e asaj direktive të tij, ndryshe të bënte presion me dorëheqje, derisa të vihej në zbatim taktika e luftës guerile nga të gjitha formacionet e UÇK-së. E theksojmë këtë, pasi gjatë gjithë periudhës që ai ishte në atë pozicion udhëheqës, UÇK-ja nuk kaloi në strategjinë dhe taktikën e luftës guerile edhe pse ai e përsëriste shpesh. Duke mos u kërkuar llogari për këtë mosbindje, ata mund që edhe të kenë menduar se zoti Demaçi nuk e kish serjozisht. Në të kundërt të dorëhiqej.

Duke qenë se ajo direktive e Demaçit, për të kaluar në strategjinë e luftës guerile, nuk gjeti zbatim nga Shtabi i Përgjithshëm, si rjedhojë as edhe nga komandat e zonave operative, (edhe pse UÇK-ja kish pësuar disfatë nga moszbatimi I saj në verën e vitit 1998), të përforcohet dyshimin se Drejtoria Politike e ka thirrur Demaçin thjesht për të dalë për momentin nga situata e asaj disfate, me qëllim që të tërhiqnin vemendien e popullit dhe të masës së UÇK-së që të mos akuzoheshin ata si shkaktarët e asaj disfate; thjeshtë për të përmirësuar imazhin e tyre dhe për ta shfrytëzuar në këtë drejtim Demaçin, deri në një moment të cakuar, sikundër dhe ndodhi.

Dhe, **së fundi,** për të mos u zgjatur më shumë, një prej gabimeve të tjera të Demaçit është ajo që e kemi përmendur edhe në një rast

tjetër[169]; ai do të kish bërë mirë që ta pranonte atë detyrë të propozuar nga zotërinjtë Xh. Haliti e A. Syla jo si individ, por si Parti Parlamentare, i cili ishte kryetari i saj.

Këto mendojmë se janë disa nga gabimet e zotit Demaçi mbi veprimtarinë gjashtë mujore të tij, si Komisar Politik i UÇK-së. Mjafton të besojmë se kemi vërejtur disa gabime pakujdesie tek ky atdhetar kaq i madh i rezistencës shqiptare; por, me këto çfarë evidentuam dëshirojmë t'i themi lexuesit se edhe njerëzit e mëdhenj gabohen sikur njerëzit e zakonshëm; gabimet që rreshtuam në këtë analizë, nuk e cënojnë asnjë grimë vlerën e përgjithshme që Demaçi i dha Luftës Çlirimtare në Kosovë.

Cila është arsyeja kryesore pse Serbia nuk e nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë dhe pse e ndërpreu aq pa papritur luftën?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje na e jep më të plotë diplomati dhe historiani serb, Dushan T. Batakoviç, As. Prof. në Universitetin e Beogradit, i cili në kohën që zhvilloheshin bisedimet në Rambuje ishte ambasador i Serbisë në Francë, i cili sqaron: "*Që delegacioni serb në Rambuje nuk do ta nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë ishte bërë e qartë nga deklaratat e tyre qysh ditët e para të Konferencës… Mirëpo, zonja Medlin Ollbrajt, para se të nisej për në Rambuje, e kish të qartë këtë vendim të atij delegacioni edhe nga një burim tjetër. Ai burim ishte letra e Patriarkut Pavle, që ia dorzoi asaj delegacioni i Kishës Ortodokse Serbe, të shoqëruar edhe me planin e kantonizimit të Kosovës*"[170]; plan i cili iu dha edhe dy

---

[169] Shih D. Goxhaj "UÇK-ja dhe Kadareja", 2004, f. 158

[170] Agjensia AFP e ka trasmetuar këtë plan, në datën 1 Shkurt 1999, (i cili po zbatohet aktualisht), ku thuhej:"Millosheviçi është duke shqyrtuar mundësinë e gjetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës, duke u propozuar disa antarëve të Grupit të Kontaktit ndarjen e Kosovës në propocion 60:40 në të mirë të serbëve dhe se kjo zgjidhje do të ishte përfundimtare, njësoj si ajo që u arrit në Dejton me boshnjakët dhe kroatët".(*Shih Fehmi Baftiu "Kosova krizë ndërkombëtare", f. 316*)

delegacioneve në Rambuje, por nuk u pranua prej tyre, dhe që Ollbrajt e theksoi edhe në takimin që bëri vite më pas me Patriarkun Artemie, gjatë vizitës së saj në Kosovë. Letra shpjeguese, vijon më tej Batakoviç, ishte e ndërtuar me tre pika. Në pikën e parë të saj theksohej: "*Millosheviçi nuk ka për ta nënshkruar atë Marrëveshje pasi çdo intervenim i NATO-s në Kosovë do t'i jepte atij mundësinë të fuqizonte pushtetin e tij në Serbi dhe do t'i zgjaste edhe më shumë qëndrimin në pushtet si dhe do të marrë masa drastike ndaj kundërshtarëve të tij. Ndërhyrja e NATO-s e legjitimon qëndrimin e Millosheviçit në pushtet*."[171], i cili justifikohej duke e përsëritur shpesh deklaratën e tij: "Sve ili mishta. Il çemo dobiti, il çemo izgubiti sve.", ("Ose do të fitojmë krejt, ose do t'i humbim të gjitha".), me të cilën ishte dashuruar jashtëzakonisht.

Edhe për ndalimin e luftës dhe tërheqjen e trupave serbe në mënyrë të befasishme nga Kosova, është strategjia e pandryshueshme e Serbisë ndaj Shqipërisë, e cila na e sqaron këtë gjë. Millosheviçi e kuptoi më në fund se SHBA ishin të vendosur për largimin e Serbisë nga Kosova. Gjithashtu ai e kuptoi edhe faktin tjetër se asnjë aleat europian proserb, sado i fuqishëm të ishte, nuk mundej ta ndihmonte më tej Serbinë. Prandaj ai doli në përfundimin: të delte me çdo kusht nga ajo krizë, por jo si humbës. Dhe për ta realizuar këtë duhej gjetur një rrugë e mesme, e cila për Millosheviçin të ishte gjysma e së keqes, por gjithmonë duke mos devijuar nga strategjia e Serbisë; dhe, njëkohësishtë, ajo rruga e mesme t'i siguronte qëndrimin sa më gjatë në pushtet.

Dhe, cila ishte kjo rrugë e mesme e zgjedhur nga Millosheviçi?

---

171) Dushan T.Batakoviç: "The Serbs in Kosovo-Metohia. War, International Protectorate and Catastrophe". www.rastko.rs Gjatë periudhës së luftës në Kosovë Dushan T. Batakoviç ishte ambassador i Serbisë në Paris si dhe vëzhgues në Konferencën e Rambujesë. "Sigurisht, Millosheviçi e llogariti që kjo zgjidhje përfundimtare jo vetëm që do t'ia rriste autoritetin në sytë e popullit serb, por do t'i garantonte edhe vazhdimin e qëndrimit të tij në pushtet", e pohon edhe Pr.Dr i Harvardit John G. Stoessinger ("*Përse kombet shkojnë në luftë", Tiranë, 2009, f. 153)*

Të pranonte për Kosovën një lloj pavarësie të tillë, ku të thuhej se ishte dhuratë e Evropës. Dhe këtë karem "dhuratë" e hëngri edhe shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, duke e shprehur publikishtë: "*Kam qenë përherë përkrahës i UÇK-së së Kosovës. I kam mbrojtur djemtë dhe vajzat e Kosovës që ishin gati të flijoheshin për të, në ditët e tyre më të këqija, atëherë kur u sulmuan me shpifje nga një stuhi propagandistike botërore. E megjithatë le të kemi kurajon të themi të vërtetën: Kosovën nuk e çliroi UÇK-ja, por Evropa Perëndimore*"[172]. Dhe ku qëndron hilja e kësaj "dhurate"? Që Kosova e "pavarur" të shfrytëzohet për qëllimet e Serbisë, do të thotë që të jetë një lloj *"shteti ndërkufitar"* sa më i vogël, "*me qëllim që shteti shqiptar, (Republika e Shqipërisë, DG), të mos ndjeki rrugën e pretendimeve kombëtare maksimale ndaj territoreve që banohen me shqiptarë, e cila është edhe aspirata strategjike e qeverisë serbe"*[173], sikundër e thekson Batakoviç, strategji që u vjen në ndihmë edhe Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë; dhe që është përifrazuar ende më qartë nga Ibrahim Rugova: "*Kosova të jetë një shtet i pavarur, neutral dhe i hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë*". Mirëpo një "shtet ndërkufitar" shumë i vogël si Kosova, nuk mund ta ketë të sigurtë për të vazhduar ekzistencën e vet, pasi pa Shqipërinë ajo nuk mund ta siguroi pavarësinë ekonomike.

Dhe atë qëllim Milloshi e arriti: u tërhoq nga Kosova pa dorëzuar as edhe një fishek, gjë që tregoi se nuk ishte humbës, dhe Kosovën e shpalli ashtu siç deshi ai vetë, shtet ndërkufitar multietnik[174], edhe pse nuk është e tillë.

EPILOGU

---

[172] Ismail Kadare "Shqiptarët në kërkim të një fati të ri", Onufri, Tiranë, 2001, f. 31

[173] Dushan T.Batakoviç "Qeveria serbe dhe Esat Pashë Toptani", IDK Tiranë, 2014, f. 64-65.

[174] Medlin Ollbrajt: "Diktatori më siguroi se dëshironte të arrihej paqja, si dhe u zotua për një Kosovë multietnike, shumëkombëshe dhe shumë fetare.". Vepër e cituar, f. 466

Rallë e tek, fatit i pëlqen të bëjë ca ironira. Një ndërmarrje diplomatike e nisur keq dhe e dënuar që më parë me disfatë, ndodh që çuditërishtë kthehet e mbaron mirë nga një rrethanë e papritur prej faktorësh të favorshëm. Prandaj dhe Faik Konica, duke i ditur këto lodra të fatit, ka thënë: *"Në qoftë se Shqipëria do të vdiste ndonjëherë, atëherë në epitafin e saj duhet të shkruhet: "Lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, vdiq nga politikanët*." Dhe kjo u vërtetua edhe në Rambuje, ku Kosovën desh e vdiqën politikanët e saj, por e shpëtoi RASTËSIA, që do të thotë fati. Cila rastësi? Ajo që Millosheviçi urdhëroi delegacionin e vet në Rambuje, që të mos e nënshkruante atë Marrëveshje edhe nëse e nënshkruanin shqiptarët.

Sytë e gjithë shqiptarëve atë ditë të 18 Marsit 1999 ishin drejtuar në Rambuje.

Të gjithë ata shqiptarë që besonin në shpjegimet e Demaçit për pasojat e pranimit nga pala shqiptare në Rambuje të asaj Marrëveshjeje, lusnin Zotin që pala shqiptare të mos e nënshkruante atë Marrëveshje.

Shqiptarët entusiastë mbështetës të Drejtorisë Politike me në krye Thaçin, si dhe ata të Rugovës, uronin nënshkrimin e marrëveshjes nga të dy palët kundërshtare!

E gjithë përfaqësia kosovare në Rambuje, ngaqë ishte mikluar me Qeverinë e Përkohëshme, as që i shkonte ndër mend të kërkonte: Le ta nënshkruajnë serbët të parët.

Momentet pas nënshkrimit të marrëveshjes prej shqiptarëve dhe deri në largimin e delegatëve serbë nga Kështjella e Rambujesë, ishin momente ankthi për ata që u besonin argumentave të Demaçit. Pse? Sepse, nëse në ato momente delegatët e Serbisë nënshkruanin marrëveshjen e Rambujesë, Kosova, me pëlqimin e vetë përfaqësisë kosovare mbetej pjesë integrale e Serbisë.

Dhe ku qëndron fati i rastësishëm për Kosovën? Tek urdhëri i Milloshit që delegacioni serb në Rambuje të mos nënshkruante atë document ku nënshkruan shqiptarët e Kosovës. Mosnënshkrimi i

marrëveshjes prej delegacionit serb donte të thoshte: edhe pse ju shqiptarët doni që Kosova të jetë Serbi, nuk duam ne serbët që Kosova të jetë pjesë e Serbisë. Është ky mosnënshkrim i asaj marrëveshjeje nga Serbia që e bën të paqëndrueshme Rezolutën 1244 të OKB, edhe pse në atë rezolutë Kosova rezulton pjesë e Serbisë. Dhe këtë mosnënshkrim tëMarrëveshjes së Rambujesë nga Serbia e shfrytëzuan SHBA për të marrë nismën për njohjen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Ishte ky moment, kur delegatët serbë u larguan nga Kështjella, që partizanët e Demaçit thirrën me zë të lartë: Urra! Shpëtoi Kosova!

Mosnënshkrimi i marrëveshjes nga serbët, mund të themi pa druajtje se ishte një veprim absurd i tyre, gjë që shkaktoi reagimin antiserb edhe të Francës, e cili as që mund ta parashikonte një veprim të tillë prej tyre. Ai mosnënshkrim duhet të ketë qenë një qorrollisje e vet Millosheviçit, nga etja për të qëndruar sa më gjat në pushtet, sikundër e shpjegonte në letrën e saj edhe Kisha Ortodokse Serbe dorëzuar zonjës Ollbrajt dhe që e bën të qartë As.Pr. Batakoviç.

Mosnënshkrimi i marrëveshjes nga Serbia, "*bëri që kjo të ndikoi në kuptimin e mprehjes së zhgënjimit të Francës. Dështimi i një negociate të kërkuar me aq vendosmëri nga Parisi, jep ndihmesën e vet për të shpjeguar vendosmërinë me të cilën francezët morën pjesë në operacionet ushtarake*"**175)** – na e përforcon mendimin ish-kryeministri Italian i asaj kohe, Massimo D'Alema. Ai reagim jonormal për Francën nga vetë Franca, tregoi prapaskenën pse u thirr me aq urgjencë Konferenca e Rambujesë. Megjithatë Franca, edhe pse e zemëruar nga ai qëndrim I Serbisë në Rambuje, përsëri i qëndroi besnike Serbisë, duke menduar se mund të laheshin hesapet më UÇK-në edhe me ndërhyrjen e NATO-s, prandaj shpesh here aviacioni frances "gabonte" në shënjestrimin e objektivave në Kosovë, duke goditur formacionet e UÇK-së. Por besnikërinë më të madhe Franca e tregoi kur urdhëroi forcat e saj të vendoseshin me

---

175) Massimo D'Alema: "Kosova, Italianët dhe lufta", f. 19

urgjencë tek Ura e Ibrit, duke e përcaktuar atë si pikën ndarëse kufitare midis Serbisë dhe Kosovës. Apo nuk është kështu?

Reagimin nervoz të Francës na e tregon me pak fjalë edhe zonja Medlin Ollbrajt, ish-sekretarja e SHBA, e cila ishte prezente në ato momente: "*Qëndrimi frances nuk na ndihmoi; pa dhënë asnjë shpjegim, ata nuk pranuan t'i lejonin oficerët e NATO-s të hynin në kështjellë për t'iu shpjeguar shqiptarëve hollësitë e planit tonë ushtarak. Në vend të tyre, këto shpjegime i dha një avokat i Grupit të Kontaktit, i shoqëruar nga një kolonel i Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara, i cili kishte mundur ta fuste vjedhurazi uniformën e tij brenda kështjllës*"[176)].

Jo më kot thonë se nga ferra e vogël del lepuri i madh. Natyrshëm lind pyetja: Koloneli anonim amerikan pse duhej të ishte në atë konferencë si diplomat dhe pse duhej të fuste vjedhurazi edhe uniformën e tij brenda në Kështjellë? Pse e bënë këtë gjë amerikanët? Kjo të bind se, amerikanët e prisnin një reagim të tillë nervoz nga francezët, ndaj dhe zonja Ollbrajt vjen në Rambuje një javë më vonë, në 14 Shkurt, e shoqëruar me nëe Kolonel i maskuar si diplomat. Gjë që vërtetohen fjalët e ambasadorit Hill, se amerikanët nuk ishin për atë Konferencë urgjente, pa u mbledhur më parë Asamblea Qytetare në Kosovë, por, sikundër e qartësuam më lartë, amerikanët nuk mund t'i kundërshtonin haptas europianët. Ai qëndrim serb u krijoi amerikanëve kushtet për t'i qëndruar besnik Doktrinës Monro[177)], ngaqë përpjekja e Serbisë për shpopullimin e Kosovës ishte një akt agresioni që kërkonte ndërhyrjen e SHBA.

Nëse serbët do të kishin nënshkruar marrëveshjen menjëherë pasi e kishin nënshkruan shqiptarët, Kosova sot zor se do të ishte shpllur e pavarur, ajo do të ishte pjesë e Serbisë. Do të përsëritej Kuvendi i

---

176) Madeleine Albright "Zonja Sekretare", f. 469

177) Doktrina Monro është përcaktuese në politikën e jashte të SHBA, e paraqitur më 2 Dhjetor 1823 nga presidenti Xhejms Monro, është një nga parimet më të vjetra që do të thirret në të nga shumë presidentë amerikanë, përfshi edhe Bill Klinton.

Prizërenit i vitit 1945, por tashti edhe shumë më keq, pasi pranohej përpara gjithë Fuqive të Mëdha Botërore se: Kosova është Serbi, gjë që objektivi i popullit shqiptar në Kosovë për të fituar të drejtën për vetëvendosje me çdo çmim e me çdo sakrificë do të ishte shumë më i vështirë për t'u realizuar**.** Nëse ajo marrëveshje do qe nënshkruar edhe nga serbët, tjetër këngë do këndonte sot Rusia, por edhe Kina e Hindia, miqtë tradicionalë të Serbisë. Është ai nënshkrim i delegacionit kosovar në Rambuje që pesë shtete të BE-së vijojnë ende të mos e njohin pavarësinë e Kosovës.

E vetmia anë pozitive e Konferncës së Rambujesë ishte se e bëri legjitime ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë: "*Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar i Hetimit mbi luftën në Kosovë, i udhëhequr nga juristi jugafrikan Richard Goldstone, ngriti kritikat më të ashpra kudo, në vigjilie të bombardimeve të NATO-s mbi Serbi, në 1999 dhe konkludoi se ajo ishte luftë "ilegale por legjitime": Ajo ishte ilegale për arsye se nuk morën aprovimin e Këshillit të Sigurimit të OKB, por ishte legjitime sepse të gjitha përpjekjet diplomatike u konsumuan dhe nuk mbeti asnjë rrugë tjetër për të ndaluar vrasjet dhe masakrat në Kosovë*".[178)]

Ndërsa z.Ramë Buja na thotë të kundërtën: "Konfrenca e Rambujesë dështoi.", i cili ka mbrojtur edhe doktoraturën me këtë temë, tre vjet pasi zonja Ollbrajt pohon se "*Ajo (marrëveshja) do të çarmatoste UÇK-në, do ta mbante Kosovën brenda Jugosllavisë dhe do t'i jepte mundësi ushtrisë së saj të vazhdonte të patrullonte kufirin"*[179)]. Natyrshëm na lind e drejta të shtrojmë pyetjen për z. Ramë Buja: Pse ai ka bindjen se Konferenca e Rambujesë dështoi, kur dihet se nënshkrimi vetëm nga një palë nuk përbën marrëveshje? Dhe ai përgjigjet: "*Dështoi sepse nuk u nënshkrua nga të dyja palët pjemarrëse në Rambuje.*"[180)](!!!). Por, sikundër e shpjeguam më lartë,

---

178) Noam Chomsky "Failed States", Pinguin Books, London, England, 2006, f. 95

179) Madelein Albright, "Zonja Sekretare", f. 464

180) Ramë Buja: "Konferenca e Rambujesë", Prishtinë, 2006, f. 139

nëse do ta nënshkruante edhe pala serbe, Kosova do të mbetej ashtu sikundër na e thotë zonja Ollbrajt. Nënshkrimi i marrëveshjes vetëm nga pala kosovare u interesonte vetëm nismëtarëve ndërkombëtarë të Rambujesë, pasi një prej qëllimeve kryesore të tyre ishte që UÇK-ja të mos ekzistonte.

Ja ku dolëm përsëri tek argumenti që e shtruam qysh në fillim të këtij libri, se: e vërteta, edhe pse është një e vetme, ajo ka tri e ndoshta edhe më shumë pamje e përmasa. Po të bëjmë avokatin e nismëtarëve të asaj Konference, Francës, Anglisë, Italisë, Rusisë dhe Serbisë, detyrimisht që do të dalim në përfundimin: "Konferenca e Rambujesë dështoi". Dështoi për ata diplomatë, sepse nuk u realizua qëllimi i tyre, që Kosova të qëndronte pjesë integrale e Serbisë, por nuk dështoi për SHBA dhe Kosovën.

E, megjithatë, nismëtarët e Rambujesë nuk dolën plotësishtë të humbur, pasi u realizua një nga dy objektivat e tyre: UÇK-ja eleminohej. Kjo vdekje e UÇK-së i kënaqi deri diku nismëtarët e Konferencës së Rambujesë, ndaj dhe pranuan bombardimet e NATO-s, sikundër shprehet edhe Massimo D'Alema. Bazuar në këtë fakt, dikush edhe mund të na thotë se Evropa ndihmoi në çlirimin e Kosovës. Po, na ndihmoi, por, ama, e imponuar nga SHBA. Por duhet ta kemi të qartë se, atë "ndihmë" Evropa nuk na e dha badiava. Shpërblimin e asaj "ndihme", Evropa po e merr me atë që po ndodh në Mitrovicën e Veriut; në kantonizimin e Kosovës dhe me dërgimin e pjestarëve të UÇK-së në Tribunalin e Hagës, ndërsa këtë vit vendosi të rrisi interesin e kredisë për "huan" që na dha, duke hapur Tribunalin e posaçëm kundër UÇK-së.

Përfundimisht mund të themi: Të gjithë ne, që mbështetëm apriori vendimin e Drejtorisë Politike të UÇK-së për shkuarjen në Rambuje me ato kushte të panegociueshme, ndoshta gabuam, ngaqë i konsideronim antarët delegatë të saj, kandidatë idealë për udhëheqjen e luftës. Por, për fat të keq, gabimin e kuptuam shumë më vonë, atëherë kur ata i dhanë popullit një liri që s'e ka plotësishtë të vetën, duke i ndëruar atij edhe simbolet kombëtare dhe po

mundohen t'i ndërojnë edhe gjuhën edhe kombësinë, duke i quajtur komb kosovar e gjuhë kosovare. Por zoti Adem Demaçi thotë: "*Këta, edhe pse janë të vetëdijshëm, unë nuk u them tradhëtarë. Këta janë fëmijë të vegjël. Nuk u them tradhëtarë, sepse fjala vret njësoj sikur plumbi*"[181]. Por, ngaqë ata besojnë se kanë vepruar drejtë; ngaqë asnjëri prej tyre nuk ka pandehur se mund të jetë e padrejtë nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë edhe me ato cënime të të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, ndaj dhe e ndjejnë veten të panjollosur.

* * *

Marrja pjesë në konferenca ndërkombëtare të rëndësishme, në lidhje me çështjen kombëtare, si kryetarë e sekretarë, apo antarë të thjeshtë delegacioni, sikundër ishte edhe rasti i delegatëve tanë në Konferencën e Rambujesë, janë një lloj shkallësh që çojnë drejt lavdisë. Ky fenomen moral i shkëlqyer përbëhet nga shumë ngjarje të paparashikuara, që ndryshojnë me një shpejtësi aq të madhe, sa nuk ka shembull që të tregojë se dikush e ka arritur lavdinë dhe e ka gëzuar tërë jetën me këtë lloj rruge. Kjo lloj lavdie, të cilën e dëshirojnë të gjithë ata që nuk sakrifikojnë, është një lloj lavdie prej ambiciozi, që i ngjan një fodullëku të pështyrë, të cilët kanë prirjen që gjithçka të mirë t'ia veshin vetes, duke e ndjerë rrugën të sheshtë, ndaj dhe i ngjajnë Luigjit të XIV, duke thenë: "UÇK-ja jam unë!", "Lirinë ua solla unë!"

Tiranë, 4 Shtator 2014

SHTOJCË

Që gjykatësi lexues të jetë i qartë për atë vendim të Drejtorisë Politike të UÇK-së, për pranimin e asaj Marrëveshjeje të Rambujesë, po japim pjesë të asaj Marrëveshje, që e sanksiononin Kosovën pjesë integrale të Serbisë dhe që i kundërshtoi vetëm Adem Demaçi:

---

[181] Shkëlzen Gashi: "Marrëveshja për paqe të përkohëshme", f. 29

Marrëveshja Ndërkombëtare e Rambujesë

"Kapitullit 1, Neni 1, Pikat 3, 4, 6:
1. ……..
2. ……
3. Republika Federale e Jugosllavisë është përgjegjëse në Kosovë për këto fusha vijuese, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë marrëveshje: a) integriteti territorial, b) ruajtja e tregut të përbashkët brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, pushteti i të cilës do të ushtrohet në mënyrë të tillë që të mos bëjë diskriminimin ndaj Kosovës, c) politika monetare, ç) mbrojtja, d) politika e jashtme, dh) shërbimet doganore, e) tatimet federale, ë) zgjedhjet federale dhe f) fushat e tjera të përcaktuara në këtë marrëveshje.
4. Republika e Serbisë do të ketë pushtet në Kosovë, ashtu si është përcaktuar në këtë marrëveshje, duke përfshitë edhe çështjen e zgjedhjeve republikane.
5……
6. Sa i përket Kosovës:
a) Nuk do të ketë ndryshime të kufijve të Kosovës;
b) Vendosja dhe përdorimi i policisë dhe i forcave të sigurisë do të qeveriset sipas kapitujve 2 dhe 7 të kësaj marrëveshjeje; dhe
c) Kosova do të ket pushtet të realizojë marrëdhënie me jashtë në kuadër të pushtetit të saj të barazvlefshme me pushtetin e paraparë për republikat sipas Nenit 7 të Kushtetutës të Republikës Federale të Jugosllavisë.
Kapitulli 2, **Neni 2**, Pika 2. **Numri dhe përbërja e policisë komunale**
Numri i gjithmbarshëm i policisë komunale të themeluar me këtë marrëveshje, që vepron në Kosovë nuk do të tejkalojë 3.000 policë aktivë për zbatimin e ligjit.
Pika 6. c) Çdo komunë mund të mbajë, në kryeqëndrat komunale apo stacionet komunale, jo më shumë se 4 (katër) armë me tytë të gjatë, tyta e së cilës nuk guxon të jetë kalibër më i madh se 7.62mm, për

çdo 15 oficerë policorë të caktuar për komunë.

Neni 6: **Sigurimi i kufijve ndërkombëtarë.**

1. Qeveria e RFJ-së do të mbajë pikat kalimtare zyrtare në kufirin e saj ndërkombëtar (me Shqipërinë dhe FYROM-in).
2. (a). I) Policia kufitare do të vazhdojë të ushtrojë autoritetin e vet në kufirin ndërkombëtar të Kosovës dhe në lidhje me zbatimin e ligjeve të RFJ-së për imigracion. Numri i përgjithshëm i policëve kufitarë do të zvogëlohet në 75.
3. **Kapitulli 4A**, Neni I, Pika 4. Republika Federale e Jugosllavisë do të jetë përgjegjëse për grumbullimin e të gjitha mjeteve nga doganat në kufijtë ndërkombëtarë të Kosovës.
4. **Kapitulli 7**, **Neni 1**, Pika 2.a. Të arrihet ndërprerja e qëndrueshme e armiqësive. Përveç forcave të parapara në këtë kapitull, asnjë forcë tjetër ushtarake, në asnjë rrethanë, nuk do të hyjë, apo të mbesë në territorin e Kosovës pa pëlqimin paraprak të Komandantit të KFOR-it.
5. **Neni 4**, Pika 2. **Forcat e AJ-së roje të kufirit**. A) Forcat e AJ-së roje të kufirit të lejohen të kufizuara në numrin prej 1.500 antarësh, si para muajit Shkurt të vitit 1998, të Batalionit të Rojes së Kufirit, në objektet e lokalizuara në Gjakovë, në Prizëren dhe në Ferizaj dhe në ndërtesat plotësuese brenda zonës kufitare…. Një numër shtesë i personelit të Armatës Jugosllave (AJ), që nuk mund të kalojë numërin e gjithëmbarshëm 1.000 dhe forcat e logjistikës do të lejohen të mbeteten në objektet e kazermave.

b) Elementët e AJ-së në Kosovë do të kenë kufizime në armë prej 82 mm e mëposhtë.

Neni 5: **Forcat e tjera**, Pika 3. Deri më datën K+5 ditë, forcat e tjera duhet të heqin dorë dhe t'i mbyllin pozicionet luftarake, strehimoret dhe postblloqet.

Pika 5. E) Deri në datën K-120 ditë çmilitarizimi i të gjitha forcave të

tjera do të jetë i përfunduar"[182]. (*Kapitulli 7, Neni 1 dhe Neni 5 janë për UÇK-në. D.G.)*

BIBLIOGRAFIA

1. Adem Demaçi "Liria dhe joliria", Prishtinë, Tetor, 2002
2. Ramë Buja "Konferenca e Rambujesë", Prishtinë, 2006
3. Shkëlzën Gashi "Adem Demaçi", biografi, Prishtinë 2010
4. Shkëlzen Gashi "Marrëveshja për paqe të përkohëshme", Prishtinë, 2004
5. Jakup Krasniqi "Kthesa e madhe", Prishtinë 2006
6. Ukshin Hoti"Filozofia politike e çështjes shqiptare", Prishtinë, 1997
7. Henri Kissinger "Diplomacia", Tiranë, 1999
8. Henry Kissinger ""A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme?", Tiranë, 2004
9. Madelein Albright "Zonja Sekretare", Dudaj, 2003
10. Marc Weller "The Ramboulliet Conference in Kosovo", 2000
11. Massimo D'Alema "Kosova, Italianët dhe lufta", Tiranë, 2004
12. Paskal Milo "Ditari i një ministri të jashtëm", Tiranë, 2009
13. Bernard Kushner "Luftëtarët e paqes", Mësonjëtroria", 2004
14. Ylli Polovina "Ditari i Romës" , Mësonjëtorja, 2000
15. Noam Chomsky "Failed States", Pinguin Books, London, England, 2006
16. Bill Klinton "Ne luftën, ju paqen", Tiranë, 2000
17. Wesli K. Clark: "Të bësh luftë moderne", Prishtinë, 2003
18. Pr.Dr.John G. Stoessinger "Përse kombet shkojnë në luftë", Tiranë 2009
19. James Petiffer & Miranda Vickers: "Çështja shqiptare", Tiranë-New York, 2007
20. Henry H.Perritt Jr. "Rrëfim prej brenda për një kryengritje", Koha, Prishtinë, 2008
21. George Friedman "America's Secret Wars", USA, 2007
22. Lidëll Hart "Strategjia", SHBU, Tiranë 1997
23. Dushan T.Batakoviç "Qeveria serbe dhe Esat Pashë Toptani", IDK

[182] Mr.sc. Ramë Buja: "Konferenca e Rambujesë", Prishtinë, 2006, f. 173-271.

Tiranë
24. Dushan T.Batakoviç "The Serbs in Kosovo-Metohia"
25. Muhamet Kelmendi "Pse nuk u ndërtua Fronti për çlirimin e Kosovës", Tiranë, 1999
26. Shukri Klinaku "Vendimi fatal", Çlirimi, Prishtinë 2000
27. Blerim Shala "Vitet e Kosovës 1998-1999", Prishtinë, 2000
28. Blerim Shala "Lufta diplomatike për Kosovën", Zëri, Prishtinë 2003
29. Ismail Kadare "Ra ky mort e u pamë", Onufri, 1999, f.29
30. Ismail Kadare "Shqiptarët në kërkim të një fati të ri", Onufri, Tiranë, 2001
31. Mehmet Kraja "Mirupafshim në një luftë tjetër", Pristine, 2003
32. Xhemail Mustafa "Një lutje për Prishtinën", Prishtinë, 2000
33. Bedri Islami "I vërteti", Tetovë, 2011
34. Bedri Islami "Lëvizja-lindje e përgjakur", Tetovë, 2012
35. Bardh Hamzaj "Rrëfimi për luftën dhe lirinë", Prishtinë, 1999
36. Naim Maloku "Dëshmi për rrugën e lirisë", Prishtinë, 2000
37. Edward Luttwak "Coup d'Etat",USA, N.Y., October 1969
38. Arkivi i Radio Kosova e Lirë, v.1, Prishtinë, 2004
39. Ahmet Qeriqi "Ikanakët gjatë luftës, matrapaqzë e profiterë pas lufte" www.radiokosovaelire.com, *23.10.2013*
40. Behxhet Shala: www.pashtriku.org
41. Gazeta "Express", 05 Shkurt 2014
42. Gazeta "Rilindja", botimi në Tiranë, 1998-1999
43. Dokumentet Britanike për Çështjen Shqiptare 1912-1913, Tiranë, 2012
44. "Global Conversation', e transmetuar në Euronews
45. "Dr. Rugova në Hagë", Prizëren, 2002
46. Zekeria Cana "Ditari i Robërisë", vëll. 2, Prishtinë, 2000
47. Historia e SHBA, Tiranë, 2010
48. Fehmi Baftiu "Kosova krizë ndërkombëtare. Ditar", Prishtinë, 2004
49. Dilaver Goxhaj "Rruga që më çoi në radhët e UÇK", Tiranë, 2000
50. Dilaver Goxhaj "UÇK-ja dhe Kadareja", Prishtinë, 2004
51. Dilaver Goxhaj "Romantika e luftës së UÇK", Tiranë-Prishtinë,2012
52. Naim Balidemaj "Tragjedia kosovare", Prishtinë, 2001
53. Safet Zejnullahu "Lufta për Kosovën", Prishtinë, 2000
54. Fazlli Veliu "LPK dhe UÇK, një emblem një qëllim", Tiranë, 2000
55. TV "Vizion Plus", Tiranë, emisioni "Zonë e ndaluar", 10 Tetor 2011
56. Revista "Diaspora shqiptare", nr.1, Shtator, 1998
57. "Global Conversation', 14 Shkurt 2014

58. Rexhep Qosja “Ditari”, vëll.1, Tiranë, 2014
59. Servet Tartari “Labëria në kuvende”, Tiranë, 2014
60. Franc Fanoni “Të mallkuarit e botës”, Prishtinë, 1984
61. Stephen Schwatz “Prejardhja e një lufte-Kosova”, Prishtinë, 2005
62. Hajrudin S. Muja “Lufta e Kosovës në shtypin amerikan”, Prishtinë, 2012
63. Veton Surroi “Këmbët e gjarpërit”, Prishtinë, Qershor 2014

Pasqyra e Lëndës

1. Prolog …….
2. Hyrje…….
3. Kundërshtitë dhe pranimi i Konferencës së Rambujesë
4. Epilogu……
5. Shtojcë……
6. Bibliografia……

٢٢٢٢٢٢٢٢٢٢٢٢٢

© Pashtriku.org, Nëntor'2014